Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI VI (XX) 2018, NR. 22 (175)

Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji, histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare

www.zaninalte.al

Tiranë, 2018

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI VI (XX), janar, shkurt, mars 2018 nr. 22 (175)

Nën kujdesin e: H. Skender Bruçaj

Drejtor: Dorian Demetja

Bordi editorial:
Prof. Dr. Ferdinand Gjana, rektor, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, dekan, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, dekan, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, dekan, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Njazi Kazazi, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Agron Tufa, Universiteti Bedër
Dr. Atakan Derelioglu, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, UET
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
Dr. Matilda Likaj, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, drejtor, Medreseja e Tiranës
MS/MA Fatos Kopliku, Washington, DC, SHBA
MA. Ramadan Shkodra - Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë

Kryeredaktor: Dr. Genti Kruja

Redaktor: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi / Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: **Kongresi I-rë Mysliman Shqiptar, 1923.**

Adresa: **Komuniteti Mysliman i Shqipërisë**
Rr. "George W. Bush", Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al
www.zaninalte.al

Përmbajtja

Studime
1. Petk' i Trupit, Petk' i Shpirtit,
Fatos A. Kopliku, Washington D.C., SHBA 5
2. E vërteta shkencore mbi "të vërtetën" islamofobe,
Prof. dr. Fadil Maloku, Universiteti i Prishtinës - Kosovë 17
3. Ilo Mitko Qafëzezi dhe përkthimi i parë i pjesshëm
i Kur'anit në gjuhën shqipe,
Azmir Jusufi (PHDc), Prizren - Kosovë 23

Edukim
4. Rëndësia e edukimit fetar,
Dr. Adil Kutlu, Departamenti i Shkencave Islame, Universiteti Bedër 38

Sociologji
5. Rëndësia e dialogut ndërfetar në marrëdhëniet ndëretnike
të shoqërisë së Maqedonisë,
Msc. Sadije Gafuri, Tetovë, Maqedoni 46

Filozofi
6. Pikëpamjet filozofike të Vexhi Demirajt
(Filozofia e fesë dhe Filozofia Islame),
Msc. Ana Gjeci, Zvicër 68

Personalitet
7. Në kuadrin e dy përvjetorëve 160 vjetori i lindjes dhe 100 vjetori i ndërrimit jetë (1847-1917) Hoxhë Voka i Tetovës, teolog, mësues, pedagog, mendimtar dhe atdhetar i shquar shqiptar,
(Prof. Dr. Musa Kraja) 89

Retrospektivë

8. 95 vjet nga Kongresi I-rë Mysliman Shqiptar (24 shkurt-12 mars 1923),
(Ali M. Basha) 97
9. Parathanë e qellim **.....112**
Hytbeja e parë,
(H.Vehbi Dibra) 114

بسم الله الرحمن الرحيم

Petk' i Trupit, Petk' i Shpirtit

Fatos Kopliku
Washington D.C., SHBA

Gjithmonë të nënshtruarit kërkojnë t'imitojnë fitimtarin në tiparet e tij dalluese, veshjen, profesionin, e të gjitha cilësitë e zakonet e tij.[1]

Abstrakt

Është e vështirë të imagjinohen njerëz e engjëj të veshur me kostum me kollare apo me xhins në parajsë; ka diçka që nuk shkon, që nuk puqet mes rrobave të tilla e parajsës. Nga ana tjetër duket krejt e natyrshme kur në parajsë ata paraqiten me veshje tradicionale, pavarësisht nga qytetërimi apo raca. Në miniaturat perse, indiane, e osmane, që ilustrojnë rrugëtimin e Natës së Mir'axhit të Profetit Muhamed, profetët e hershëm e engjëjt që ai takon paraqiten me petka tradicionale, doemos plot larmi falë gjenisë së artistëve e origjinës së tyre etnike, por krejt natyrshëm e pa asnjë stonim me sferat çelestiale ku ndodhen. Gravurat e mozaikët bizantinë, gjithashtu, ilustrojnë me mjeshtëri çaste nga jeta e Krishtit, Virgjëreshës, apo profetëve të Dhiatës së Vjetër, qoftë në tokë qoftë në parajsë, e nëse u kushtojmë vëmendje petkave, ato prapë janë në harmoni të plotë me temën e sfondin. Me përjashtimin e veshjes moderne, mund të sillen shembuj të ngjashëm të përputhjes së veshjeve tradicionale me parajsën, profetët, e shenjtorët edhe nga Hinduizmi e Budizmi, apo edhe në religjione që nuk janë më operative, si ato të qytetërimeve të lashtësisë, Egjiptit, Mesopotamisë, apo Persisë. Në këtë shkrim argumentojmë se arsyet e kësaj harmonie lidhen ngushtë me rolin e njeriut, si e sheh ai veten, e si rrjedhojë, si vishet në përputhje me atë rol.

1. Ibn Khaldūn, *The Muqadimmah: An Introduction to History*, trans. Franz Rosenthal, kreu II. 22.

Është e vështirë të imagjinohen njerëz e engjëj të veshur me kostum me kollare apo me xhinsa në parajsë; ka diçka që nuk shkon, që nuk puqet mes rrobave të tilla e parajsës. Nga ana tjetër duket krejt e natyrshme kur në parajsë ata paraqiten me veshje tradicionale, pavarësisht nga qytetërimi apo raca. Në miniaturat perse, indiane, e osmane që ilustrojnë rrugëtimin e Natës së Mir'axhit të Profetit Muhamed[2] profetët e hershëm e engjëjt që ai takon paraqiten me petka tradicionale, doemos plot larmi falë gjenisë të artistëve e origjinës së tyre etnike, por krejt natyrshëm e pa asnjë stonim me sferat çelestiale[3] ku ndodhen. Gravurat e mozaikët bizantinë, gjithashtu, ilustrojnë me mjeshtëri çaste nga jeta e Krishtit, Virgjëreshës, apo profetëve të Dhiatës së Vjetër, qoftë në tokë qoftë në parajsë, e nëse u kushtojmë vëmendje petkave ato prapë janë në harmoni të plotë me temën e sfondin. Me përjashtimin e asaj moderne, mund të sillen shembuj të ngjashëm të përputhjes së veshjeve tradicionale me parajsën, profetët, e shenjtorët edhe nga Hinduizmi e Budizmi, apo edhe në religjione që nuk janë më operative, si ato të qytetërimeve të lashtësisë, Egjiptit, Mesopotamisë, apo Persisë. Në këtë shkrim argumentojmë se arsyet e kësaj harmonie lidhen ngushtë me rolin e njeriut, si e sheh ai veten, e si rrjedhojë, si vishet në përputhje me atë rol.

Në vetvete një petk e një cohë nuk mund të na ulë apo lartësojë dhe anekdota "ha qyrk, pi qyrk" e Nastradinit e thumbon prirjen për të vlerësuar veshjen e paraqitjen ndërsa neglizhojnë njeriun vetë.[4] Por, nga ana tjetër, do të nguteshim nëse do ta nënvlerësonim rëndësinë e veshjes, qoftë mbi ne qoftë mbi të tjerët. Natyrshëm, me apo pavetëdije, e

2. Shih p.sh. *Mirâj Nâmeh: The Miraculous Journey of Mahomet.* Introduction and commentaries by Marie-Rose Séguy (NY: George Brazilier, 1977), një nga riprodhimet më cilësore të dorëshkrimit me të njëjtin emër krijuar në shek. XV-të me urdhër të Shah Rukhut, një nga bijtë e Timur Lengut. Dorëshkrimi përfshin edhe mbi gjashtëdhjetë miniatura që ilustrojnë këtë ngjarje madhore në historinë e Islamit.

3 Ky term nënkupton një hierarki të universit, i cili është një parim kryesor në kozmologjinë islame, e jo vetëm. Shih psh. kreun II, 'Kozmosi dhe Hierarkia e Universit' në librin *An Introduction to Islamic Cosmological Doctrines,* rev. ed. (NY: State University of New York Press, 1993), nga Seyyed Hossain Nasr.

4. Nastradini shkon në një gosti me rroba të thjeshta por askush s'e respekton, madje e lënë në një qoshe të dhomës. Pas disa kohësh, kur ai shkon prapë në të njëjtën gosti, këtë radhë me veshur me një qyrk të shtrenjtë njerëzit e respektojnë dhe e vendosin në krye të vendit. Në atë çast ai fillon të ushqejë qyrkun duke i thënë "ha qyrk, pi qyrk", dhe kur të tjerët e pyetën të shastisur u thotë se respekti i tyre ishte ndaj qyrkut që kishte veshur, jo ndaj tij, prandaj qyrku është i ftuari në gosti, jo ai, e kësisoj qyrkut i takon të hajë e pijë.

identifikojmë veten me atë çka veshim pasi ajo na tregon rolin që pritet të luajmë; mjafton të vëzhgojmë se si njerëzit ndihen e sillen kur veshin kostume të ndryshme. Jo rastësisht shumë profesione apo sporte të ndryshme kanë uniformën përkatëse në përputhje me rolin që duhet të përmbushet. Mund të imagjinojmë ushtarë të veshur si infermierë, apo në pantallona të shkurtra e me shapka, por me shumë gjasë çdo gjeneral do të na thoshte se në mungesë të uniformës përkatëse ata do të ishin vetëm gjysmë ushtarë. Po ashtu çdo aktor do ta pohonte se është më kollaj të flasësh e sillesh si lypës kur ke rrecka sesa me kurorë në kokë e petka mëndafshi në shtat. Shkuarja në një dasmë, ballo, apo mbledhje me veshjen jo të duhur krijon një siklet që shumëkush në një mënyrë apo tjetër e ka provuar. Veshja nënkupton rolin që marrim përsipër, e kur nuk përkon me atë që pritet prej nesh kjo na ndikon jo pak. D.m.th., ashtu siç petku përkatës e ndihmon, ai i papërshtatshmi e pengon njeriun në përmbushjen e një roli të caktuar. Shtojmë se larmia e veshjeve nuk bie doemos në kundërshtim me përshtatësinë e tyre; p.sh., veshja e një kalorësi teuton, e një spahiu, dhe e një samuraji edhe pse ndryshojnë qartë nga njëra tjetra, ato kanë të përbashkët përputhjen e plotë me rolin e tyre marcial; kuptohet, kjo vlen jo vetëm për veshjet ushtarake.[5]

Në një shoqëri tradicionale[6] njeriu ka një rol që është përtej çdo profesioni e zanati; atë të qenët njëherësh rob dhe mëkëmbës i Zotit në tokë. Për ta ndihmuar njeriun ta përmbushë këtë rol çdo shoqëri ka gjetur "gjuhën" për petkun e vet, qoftë në shkretëtirat e Hixhazit, në qytetet shekullore të Mesdheut e Lindjes së Largët, apo në rrafshnajat e Amerikës. Veshja është një art, në krahasim me të cilin asnjë tjetër nuk i rri më afër njeriut, qoftë fizikisht, qoftë psikologjikisht. Nga një anë petku na mbulon shtatin, e njëkohësisht nga ana tjetër zbulon diçka nga vetja jonë: çfarë përbën për ne një veshje me dinjitet, si e shohim veten e çfarë atributesh duam të manifestojmë, e mendimi që të tjerët kanë për të, diçka e lidhur ngushtë me kushtin pararendës.[7]

Veshja shpërfaq rolin shpirtëror ose shoqëror, ose vetë shpirtin tonë. Ndikimi ndër ne e ndër të tjerë nuk duhet të na çudisë shumë pasi në thelb veshja riprodhon, në rrafshin

5. Shembuj ka shumë, por po përmendim edhe një në këtë rast: veshjet tradicionale të nuseve edhe pse mrekullisht të larmishme nga njëra kulturë në tjetrën, prapë përputhen në rol e qëllim.

6. Fjala "traditë" përkon me terma si *din* në Islam, *dao* në Daoizëm, apo *dharma* në Hinduizëm e Budizëm. Tradita, në kuptimin e mirëfilltë është një tejzgjatje e një shpalljeje të caktuar, jo një zakon që trashëgohet për inerci. Shih kreun me titull 'Çfarë është Tradita?' te Seyyed Hossain Nasr, *Knowledge and the Sacred* (NY: State university of New York Press, 1989), ff. 62-86.

7. Shih Marco Pallis, *The Way and the Mountain* (IN: World Wisdom, 2008), f. 156.

njerëzor, një proces me përmasa kozmike, atë të manifestimit të Hakkut, të Vërtetit, Fytyra (*Wexhh*) e të Cilit fshihet pas "shtatëdhjetë mijë perdeve".[8] Çdo manifestim (*texheli*) është një petk nëpërmjet të cilit Zoti shpalos Cilësitë e Veta dhe qëndrimet tona varen prej petkut nëpërmjet të cilit ato shfaqen. Ndryshe reagojmë kur shfaqen Cilësitë e Madhështisë nëpërmjet një vullkani apo rrufeje, e ndryshe reagojmë kur përballemi me Cilësitë e Mëshirës kur manifestohen nga kafshët në përkujdesen për të vegjlit e tyre... Përderisa Zoti e krijoi njeriun në shëmbëlltyrën e Tij – *'ala suratiHi* ose *Imago Dei* – ai i dha edhe lirinë e zgjedhjes. Kjo e fundit i jep mundësinë atij të marrë përsipër çdo virtyt e cilësi – jetën, inteligjencën, drejtësinë, pushtetin, bujarinë, trimërinë – si hua që doemos i kthehen të Zotit të Vërtetë; fundja "çdo gjë mbi tokë i nënshtrohet vdirjes, dhe mbetet veç Fytyra e Zotit Tuaj, Zotërues i Madhështisë e Bujarisë" [55:26-27]. Kësisoj, me këtë qasje, njeriu pranon njëherësh rolin e shërbëtorisë dhe mëkëmbësisë; kur dikujt i jepet p.sh., inteligjencë apo pushtet, ai ose ajo i sheh këto cilësi si dhunti e amanete Hyjnore, e kërkon t'i përdorë ato në përputhje me Vullnetin Hyjnor. Në fakt as mirësia nuk na përket neve përfundimisht, siç thotë Krishti "Përse më quani të mirë? Askush s'është i mirë, përveç një Hyji të vetëm."[9] Në të kundërt, kur njeriu zgjedh ta shohë çdo cilësi si të vetën, përfshirë virtytet, si rrjedhojë ai ose ajo ndihet i lirë t'i përdorë ato sipas dëshirës e interesit të vet. Sipas doktrinës islame, e jo vetëm, kjo është mungesë kthjelltësie, që çon në rebelim dhe mosmirënjohje, pasi është përvetësim i diçkaje që është dhënë hua. Secila zgjedhje kërkon përmbushjen e një roli: rob i Zotit e mëkëmbës i Tij, ose rebel e mosmirënjohës ndaj Tij. Në përputhje me rolin, me ose pa vetëdije, do të zgjedhim edhe petkun përkatës.

Disku i artë që stoliste gjoksin e kryepriftit të Dhiatës së Vjetër simbolizonte diellin, xhevahiret në petk yjet, e kurora ngjante me "brirët" e një hëne të re; ndërsa tek indianët e Amerikës, në veçanti petku i kryeplakut ishte diçka që tejçonte madhështinë e rolit të njeriut si njeri, jo thjesht si kafshë racionale. Kurora me pupla shqiponje mbi krye ishte një simbol i diellit në shkëlqim, i cili në vetvete simbolizon Shpirtin Universal[10] që, siç dielli, i

8. Hadith: Muslim, *Iman*, 293; Ibn Maxha, *Mukaddime*, 13; c.n. William C. Chittick, *The Sufi Path of Knowledge: Ibn 'Arabi's Methaphysics of Imagination* (NY: State University of New York Press, 1989), f. 217, sh. 9.

9. Luka 18:19.

10. *'Akl-i kuli* në terminologjinë islame. Shih p.sh., Rumi, Mesnevi, III, 2527-30; kreu 6 ,'Çështje epistemologjike: raportet mes intelektit, arsyes dhe intuitës në perspektivat e ndryshme të filozofisë islame' në Sejjid Husein Nasr, *Filozofia Islame nga Zanafilla e Saj Deri me Sot: Filozofia në tokën e profetësisë*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Fondacioni Rumi, 2011), ff. 115-126.

jep jetë gjithçkaje. Puplat s'mund të ishin prej ndonjë zogu tjetër, pasi shqiponja shihej si ngadhënjyese mbi zvarranikët, simbol i fitores së natyrës engjëllore mbi atë demoniake, e jo kushdo kishte të drejtë të vinte një kurorë të tillë. Ndërsa brirët e bizonit ishin "brirët" e hënës së re, e cila ngjason me një enë që pret mbushjen me hirin hyjnor, e thakët e mëngëve simbolizonin shiun e mëshirës.[11]

Panorama të tilla kozmike në veshje tregojnë për një rol thelbësor të njeriut si pasqyrë e gjithësisë, makrokozmos në mikrokozmos, e njëkohësisht urë lidhjeje mes qiellit[12] e tokës. Petku i monarkëve të Lindjes së Largët – perandorë të Kinës, Japonisë, Siamit, etj. – pritej me një jakë rrethore, ndërsa kindi i petkut pritej në mënyrë katrore. Rrethi është simbol i qiellit e katrori i tokës, çka tregon se, në parim, roli i një sunduesi ishte të shërbente si urë e zëdhënës mes qiellit e tokës. Ideja e sundimtarit si urë ishte e pranishme edhe në Romën e Lashtë, e haset akoma sot në Katolicizëm pasi një nga titujt e papës është *Summus Pontifex*, që do të thotë "urë-ndërtuesi suprem".[13] Njëkohësisht parimi vlen për çdo njeri, jo veç për klerikun apo sundimtarin, të cilët thjesht shprehin edhe aspiratën e bashkësisë në fjalë, atë të njeriut si mëkëmbës i Zotit, term që në Islam njihet si *khalifetullah*. Vetë termi *khalif* nënkupton rolin e postit, e si rrjedhojë të gjithë shtetit (*khalifatit*), si mëkëmbës që përpiqet të përmbushë Vullnetin Hyjnor. Duhet të thuhet se shkarjet nga norma të sundimtarëve të ndryshëm nuk e cenuan parimin e idealin e rolit pavarësisht rrymës së ngjarjeve për shekuj me radhë. Pretendimet e kohëve të fundit për ringjallje të khalifatit, për fat të keq, janë parodi e karikatura të kuptimit origjinal. Gjithashtu, titulli *khalif* u është dhënë nga bashkësia myslimane edhe dijetarëve e dinjitarëve, urtarëve, e udhëheqësve shpirtërorë: shehlerë, dedelerë, baballarë… Në fakt, më shumë se sundimtarët, ata shiheshin si trupëzimi i vërtetë i këtij titulli fisnik.

Duhet të themi diçka edhe mbi lakuriqësinë që haset akoma në disa fise nëpër botë, e cila simbolizon gjendjen e qëmotshme kur njeriu dhe bota ishin pjesë e pandarë, kur njeriu jetonte veç në hapësirë e jo në kohë. P.sh., për disa lloj asketësh hindu (*nanga sannyasin*) ose disa fise aborigjenë të Australisë, petku i tyre është vetë hapësira e cila tejzgjatet deri në kulmet e paana qiellore.[14]

11. Shih Titus Burckhardt, *Sacred Art of East and West: Its Principles and Methods* (Middlesex: Perennial Books LTD, 1967), ff. 113-116.

12. Këtu fjala "qiell" konsideron sferat hyjnore, e jo fizikisht trupat qiellorë.

13. Titulli *Pontifex Maximus* fillimisht i përkiste kryepriftit të Kolegjit të Pontiffëve të Romës, e më vonë pas Augustit iu dha perandorit. Termi *pontiff* përdoret akoma sot për peshkopët.

14. Fise të tilla, edhe pse të vogla në numër, sjellin një jehonë prej agimeve të hershme të lindjes së njerëzisë, kësisoj edhe atë të feve prehistorike. Sipas historianit amerikan

Lakuriqësia është gjithashtu e lidhur ngushtë me pafajësinë (lakuriqësia e fëmijëve të vegjël na duket normale) dhe humbja e saj, d.m.th. lindja e ndjenjës së "turpit", kërkon petk.

Ndërsa veshjet me simbole qiellore e kozmike theksojnë rolin aktiv të njeriut si përfaqësues e mëkëmbës të Zotit në tokë, veshja e thjeshtë e murgut konfirmon shfaqosjen, pra rolin pasiv të njeriut karshi Vullnetit të Tij. Në rastin e Islamit kemi një veshje që pasqyron ndërthurjen e këtyre dy roleve pasi petku hieratik i popujve semitë, trashëguar providencialisht nga Islami, kombinon veshjen murgërore me turbanin, kurorën ose diademën e Islamit, vulën e përshpirtmërisë te njeriu.[15] Kjo veshje mund të shihet si një koment estetik i rolit drejt të cilit Profeti Muhamed, njëherësh shërbëtor (*'abd*) dhe i dërguar (*resul*) i Zotit, fton e udhëzon umetin, bashkësinë e vet. Nuk është e rastësishme që kur një bashkësi myslimane fillon e dobësohet shpirtërisht, duke u larguar prej parimeve, e para ndalesë ose braktisje është ajo e turbanit. Nga ana simbolike mund të thuhet se me heqjen e turbanit myslimani heq dorë nga roli si mëkëmbës i Zotit, e me heqjen e petkut të lëshuar alla-murgëror ai nuk është më rob i Zotit por kthehet në rebel ndaj Vullnetit të Tij.

Nëse shqyrtojmë diktaturat e regjimet sekulare shohim se ato kanë diçka thelbësisht të përbashkët; sabotimin sistematik të autoritetit shpirtëror si hap paraprak për kthimin e popullit në një masë uniforme, në fillim me veshje, e pastaj me mendime. Sabotimi i një roli u shoqërua natyrisht me krijimin e një tjetri, atë të "njeriut të ri", një dukuri që e shohim në rrafshin teorik[16] fillimisht, e më pas në atë praktik. "Njeriu ynë i ri, vepra më e ndritur e Partisë", një nga parullat më të njohura në Shqipërinë komuniste, është një nga dëshmitë dhe shembujt më të qartë të finalizimit të zhvendosjes së rolit tradicional të njeriut. Pavarësisht larmisë në intensitet, metoda, e data historike, kudo nëpër botë ndryshimet në emër të progresit apo modernizimit filluan me imponimin e veshjes moderne e ndalimin e asaj tradicionale. Ky ishte hapi i parë në institucionet shtetërore

---

të religjionit, Huston Smith, "gjithçka që gjejmë në lulëzim në fetë historike – p.sh., monoteizmin – është e kumtuar në ato të qëmotshme përgjatë linjave të zbehta por të dallueshme." *The World Religions: Our Great Wisdom Traditions* (HarperCollins, 1991), f. 368.

15. Ekzistojnë hadithe që theksojnë rëndësinë e veshjes së turbanit: "turbani është kufiri mes besimit e mosbesimit", "vishni turban pasi do të përftoni vetëpërmbajtje", "umeti im nuk do të dobësohet për sa kohë që vë turbanin", "Ditën e Gjykimit do të merrni një dritë për çdo rrath të turbanit"… c.n. Titus Burckhardt, *Arti i Islamit: Gjuha dhe Kuptimet*, shqip. Vehap Kola (Shkup: Logos-A, 2012), ff. 102-103.

16. Shih Gregory Claeys (ed.), *The Cambridge Companion to Utopian Literature* (Cambridge, UK: Cambridge University Press, 2010), ff. 11-14.

të Japonisë që në vitin 1864, po ashtu në Rusinë bolshevike[17], në Turqinë moderne, në Kinën e Maos, e pothuajse në tërë Evropën Lindore, përfshirë Shqipërinë. Këta reformistë e diktatorë e nuhatën në mënyrë intuitive papajtueshmërinë e veshjes tradicionale[18] me frymën e revolucioneve e ndryshimeve që donin të zbatonin. Reformat e shtetet moderniste janë të përqendruara ekskluzivisht në këtë botë pasi, drejtpërdrejtë apo jo, ato e mohojnë praninë e botës tjetër. Ndërsa petku tradicional, e në veçanti ai hieratik, nënkupton praninë e botës tjetër, praninë e një botëkuptimi të caktuar që udhëzon e i tregon njeriut se ku janë përparësitë e aspiratat e rolit të tij si njeri.

Natyrisht, në përputhje me rolin e ri u krijuan edhe veshje të reja për "njeriun e ri": "këmishëzinjtë" e Italisë së Mussolinit, "këmishëkafët" e Gjermanisë së Hitlerit, uniformat partizane e proletare në vendet ku u hap komunizmi qoftë në Europë e përtej. Nuk është rastësi që këto uniforma janë gjithmonë kopje ose imitime veshjesh moderne perëndimore, e asnjëherë të bazuara në modelet folklorike e tradicionale të vendeve përkatëse. Veshja moderne perëndimore nuk u sajua për një ditë, por është finalizim i zhvillimeve disashekullore që transformuan konceptin e njeriut dhe nevojave të tij, pasojë e një shthurjeje shpirtërore e ngurtësimi intelektual[19] në Perëndim, të cilat e kanë zanafillën që në Mesjetën e vonshme e fillimet e Rilindjes Europiane.[20] Nëse krahasojmë, nga

17. Në fakt që më përpara, Cari i Rusisë, Pjetri i Madh (v. 1725), në emër të modernizimit të Rusisë fillimisht imponoi mbi aristokracinë ruse veshjen perëndimore në vend të petkut moskovit dhe ndërhyri në kushtetutën e Kishës Ortodokse për të lehtësuar instrumentalizimin e saj.

18. Veshja tradicionale nuk reduktohet si thjesht "folklorike", pasi veshja e një zyrtari shtetëror, e një dijetari, apo një ushtaraku në një qytetërim tradicional është tejzgjatje e kryerolit të njeriut. D.m.th., njeriu kërkon t'i shërbejë Vullnetit Hyjnor si dijetar, ushtarak, apo zejtar, dhe petku e pasqyron këtë veçanti.

19. Intelekti është më tepër se thjesht arsyeja (*ratio*) e cila për nga natyra është fragmentare, siç është e qartë edhe nga vetë kuptimi i emrit të saj qoftë në shqip, qoftë në latinisht. Arsyeja ndan, fragmenton, (nd) arëson në racione (ratio) ose pjesë, dhe një nga lëmet e saj janë analizat racionale te fakteve. Arsyeja ofron njohuri, doemos, por jo të llojit që çliron e shpëton shpirtin. Doktorët e kampeve naziste, p.sh., ishin të aftë në metodën e analizat shkencore, por ato njohuri s'mund t'i ndihmonin si të ishin njerëz më të mirë, e përfundimisht, si të shpëtonin shpirtrat e tyre. Intelekti, nga ana tjetër, rrok drejtpërdrejt natyrën e gjërave, thelbin e tyre, jo në mënyrë diskursive, pasi ai është "shpirti që ka arritur ta njohë dhe realizojë potencialin e tij të plotë", siç shprehet studjuesi William C. Chittick në librin e tij *Shkencë e Kozmosit, Shkencë e Shpirtit: Përshtatsia e kozmologjisë islame në botën moderne*, shqip., parath. & shën. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2011), f. 60. Në këtë libër, mes të tjerash, bëhet dallimi mes qasjes së mirëfilltë "intelektuale" si mënyrë njohjeje dhe asaj të transmetuarës, ku hyjnë shumica e shkencave e disiplinave.

20. Shih p.sh., Frithjof Schuon, *Art from the*

portretet e gravurat, petkun e mbretit të Francës Luigjit të IX-të (v. 1270) me atë të Luigjit të XVI-të (v. 1715), petku i të parit është ai i një monarku *të krishterë* perëndimor, ndërsa ai i të dytit i një monarku të "civilizuar" në mos ekstravagant. Me një fjalë, veshja moderne perëndimore nuk është veshje tradicionale e krishterë. Sipas autorit Titus Burckhardt ajo është dëshmi e një "largimi nga një jetëstil i mbrujtur tërësisht nga vlera soditëse me synim të ngulitur drejt jetës së përtejme…"[21] Meqë ishte pasojë e shpërfaqje graduale e një gjendjeje të brendshme ajo nuk u imponua me dekrete, ligje, e ndryshime të menjëhershme drastike siç ndodhi në shumë vende jo-perëndimore.

Mirëpo këto vëzhgime nuk janë keqardhje nga pikëpamja e një etnografi; bëhet fjalë për psikologji njerëzore e për ligje shpirtërore, nëse mund të shprehemi kështu. Nuk është çështje idealizmi apo malli për një të kaluar romantike e piktoreske por e diçkaje më të thellë. Siç thotë mendimtari Frithjof Schuon në librin e tij "*Të Kuptosh Islamin*": "...urrejtja ndaj turbanit, si ajo ndaj romantikes, piktoreskes, apo çdo gjëje që i përket folklorit, shpjegohet nga fakti se janë pikërisht botët romantike ato ku Zoti është i besueshëm. Kur njerëzit duan të anulojnë Parajsën, është e natyrshme të fillohet nga krijimi i një ambienti ku gjërat shpirtërore duken të papërshtatshme; për të deklaruar me sukses se Zoti është joreal duhet të krijojnë rreth njeriut një realitet të rremë, që është në mënyrë të pashmangshme jonjerëzor pasi vetëm jonjerëzorja mund ta përjashtojë Zotin."[22]

Arkitektura e muzika janë në një mënyrë tejzgjatje e petkut, pasi të dyja përbëjnë ambientin që na rrethon; e para ritëm në hapësirë, e dyta ritëm në kohë. Ndërsa petku tradicional tregon rolin, arkitektura e muzika tradicionale shërben si konteksti përkatës i përmbushjes së këtij roli. Si petku, po ashtu edhe arkitektura, bashkë me muzikën, kanë pësuar transformime e shthurje të ngjashme, qoftë në Lindje apo Perëndim, duke bërë përditë e më jonjerëzore qytetet, lagjet, e rrugët ku jetojmë.[23] Si rrjedhojë, përpjekja për besimtarin e thjeshtë që Zoti të mos kthehet në një abstraksion, rritet dita ditës. Jemi dakord me këdo

Sacred to the Profane East and West, Catherine Schuon (ed.), (IN: World Wisdom, 2007), ff. 119-123.

21. Burckhardt, *Arti i Islamit*, ff. 104-105.

22. Frithjof Schuon, *Understanding Islam*, trans. D. M. Matheson (London: Allen & Unwin, 1963), f. 31.

23. Kjo është temë që kërkon trajtim në vete, që shpresojmë ta bëjmë në të ardhmen. Arkitektura e muzika tradicionale kanë qenë e mbeten mbështetje shumë të rëndësishme psikologjike për çdo besimtar. Në veçanti për Islamin shih kreun XII, XIII dhe XIV mbi artin e arkitekturën në librin Sejjid Husein Nasr, *Islami në Botën Moderne: I sfiduar nga Perëndimi, i kërrënuar nga fundamentalizmi, besnik ndaj traditës* (Shkup: Logos-A, 2017), dhe Jean-Louis Michon, *Introduction to Traditional Islam: Foundations, Arts and Spirituality* (IN: World Wisdom, 2008).

që thotë se e rëndësishme është çfarë bartim në zemër, por do të shtojmë se ajo çfarë kemi në zemër ndikohet e ndryshohet nga ambienti me të cilin e rrethojmë veten: vendi ku banojmë, muzika që dëgjojmë, e petku që veshim. Ia vlen të përmendet teoria e "dritares së thyer"[24], sipas së cilës, cilësia e hapësirës urbane ndikon në rritjen ose pakësimin e vandalizmit dhe sjelljeve kriminale, ose mund të krahasohet sjellja e një audience pas një koncerti metal me atë pas një koncerti të muzikës klasike. D.m.th., zemrat, mendjet, e sjelljet e njerëzve nuk janë indiferente ndaj formave e tingujve që i rrethojnë, e petkave që veshin… në fakt krejt e kundërta.

Imponimi ose imitimi, sipas rastit, i veshjes moderne perëndimore – pa u zgjatur në aspekte të tjera – anembanë botës, është simptomë e një zvenitjeje të përshpirtmërisë, që pasohet natyrisht nga një pakësim i dinjitetit njerëzor, çoroditje të rendit të përparësive, e humbje e ndjesisë ndaj së bukurës. Kjo simptomë është përshpejtuar pjesërisht edhe falë prirjes që i referohet Ibn Khalduni, sipas të cilës të nënshtruarit në përgjithësi, me ose pa vetëdije, imitojnë fitimtarët. Edhe pse të gjitha vendet, që ishin të kolonizuara, janë çliruar e kanë fituar pavarësinë ato vazhdojnë të kopjojnë modelet e ish-kolonizatorëve evropianë të veshjes. Kjo doemos ka ndodhur në dëm të kostumeve tradicionale, duke çuar në një varfërim të larmisë në shkallë globale[25]; njerëzit tashmë vishen njëlloj si në Tiranë, Tokio, apo Londër. Kuptohet imitimi nuk u kufizua te veshjet, por mund të thuhet se ajo ishte pikënisja e imitimeve të tjera, që si në rastin e petkut ka si pasojë varfërimin ose edhe rrafshimin e larmisë, qoftë muzikore, arkitekturore, gjuhësore, e me radhë.[26] Sipas eruditit të shekullit të kaluar Ananda K. Coomaraswamy kjo është një simptomë e shkëputjes nga arketipet hyjnore që shpaloseshin në forma e ngjyra të panumërta në popuj e etni të ndryshme.[27] Nuk

24. Kelling, George L.; Wilson, James Q. Broken windows: the police and neighborhood safety. *Atlantic Monthly*. 1982 Mar; 249(3):29–38. Eksperimenti i psikologut të njohur amerikan Philip Zimbardo në Bronks (New York) dhe në Palto Alto (Kaliforni) përbën një nga shembujt klasikë të kësaj teorie.

25. Lidhja mes industrializimit të vendeve të "zhvilluara" dhe venitjes apo edhe zhdukjes së folklorit nuk është aksidentale. Vendet me folklor më të pasur janë zakonisht ato më pak të "zhvilluarat".

26. Hapësirat urbane të qyteteve moderne nuk kanë ndonjë dallim cilësor mes njëra tjetrës, një godinë 10 katëshe në Tiranë s'ka tipare dalluese nga një e tillë në Lima të Perusë ose në Kajron moderne. Por arkitektura e Beratit bart tipare dalluese nga ajo e Benaresit në Indi, Sienës në Itali, ose Sana'asë në Jemen – qytete që ruajnë akoma trajtat tradicionale të arkitekturës – pasi providencialisht shpalos një Ide Hyjnore në një vend dhe popull, në këtë rast me gjuhën e Islamit. Vëzhgime analoge mund të bëhen edhe për artet zanore ose plastike, për gjuhën, poezinë, etj.

27. Shih esenë 'Natyra e Folklorit dhe Artit Popullor' në *The Essential Ananda K. Coomaraswamy*, R. P. Coomaraswamy (ed.),

është gjithashtu ndonjë lëvizje e njerëzimit drejt unitetit, siç mund të kujtojnë disa, por drejt uniformitetit monokrom, që është thelbësisht krejt tjetër, diçka e cila çon përfundimisht në apoptozë, në vetëflijim.[28]

Argumenti që duhet të ecim me kohën e të ndryshojmë me të bart një presupozim që jo rrallë nuk shqyrtohet ; koha absolutizohet e bëhet etalon i gjithçkaje. Atëherë biem në një situatë jo shumë të lakmueshme, pasi tradicionalisht termi *absolut* i është dhënë vetëm Zotit dhe mveshja me këtë cilësi kohës apo çdo gjëje tjetër do të thotë krijim zotash.[29] Shqetësimi dhe përparësia kryesore e çdo religjioni tradicional është njohuria e saktë mbi natyrën e Realitetit (*Hakk*) dhe rruga e qasjes drejt Tij, jo *ecja me kohën* apo ndonjë tjetër arsye. Fundja nëse duhet të ecim me kohën, po koha vetë në bazë të çfarë kriteri duhet të gjykohet, cilat janë standardet, janë të përhershme e eterale apo vendosin njerëzit për to? Nëse po, kush e ka këtë privilegj e përgjegjësi që gjykon se ka ardhur koha për një veshje të caktuar, muzikë të caktuar, arkitekturë të caktuar, mentalitet të caktuar? Edhe pse dëgjohet herë pas here kjo shprehje, *ecja me kohën*, një gjë duket e sigurt: askush s'e ka të qartë se ç'duhet të kuptojmë me të por gjithsesi kërkohet doemos t'i përgjigjemi këtij kushtrimi.

Sidoqoftë, veshja moderne sekulare është tipike e njeriut që ka harruar Qiellin, që është përqendruar këtu në tokë e kërkon ta sundojë atë, dhe përhapja e imponimi i saj anembanë globit, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo, nuk është aksident. Nga pikëpamja tradicionale kjo do të thotë përfundimisht humbje, e ilustrohet mjaft mirë nga thënia e Krishtit, "ç'dobi ka njeriu nëse fiton botën mbarë por humb shpirtin e vet?!"[30] Duhet ta kemi të qartë se nuk po sugjerojmë adoptimin e turbanit, apo çdo veshjeje tradicionale, qoftë individualisht qoftë në masë. Në kushtet e sotme diçka e tillë, qoftë në ambientet e punës, qoftë në hapësirat moderne urbane është shumë e vështirë, me raste e pamundur, pasi një veshje tradicionale në një

(IN: World Wisdom, 2004) ff. 215-223.

28. Humbja e larmisë – qoftë në ekologji, muzikë, sport, arte marciale, dinamika sociale, etj – logjikisht ndiqet nga pasoja serioze. Një orkestër që ka veç një instrument humb interesin e audiencës së vet, një skuadër futbolli që ka vetëm sulmues do të humbë, një pyll që ka veç një lloj peme bie shumë kollaj pré e parazitëve… D.m.th., një qytetërim uniform, nga natyra, është tejet i brishtë. Përhapja e veshjes moderne është simptomë e një njerëzimi që çdo ditë e më shumë mendon e vepron njëlloj, si rrjedhojë popujt kthehen në masa, njerëzit në individë, e këta të fundit në statistika praktikisht të manipulueshme për vota e pushtet, ose fundja, për sondazhe komerciale. Në fakt, sipas doktrinave eskatologjike të religjioneve të ndryshme kjo tendencë është tipike e ciklit të fundit njerëzor, ditëve të fundit, ose *ahiri zemanit*.

29. Shih 'Zotat e Modernitetit' në Chittick, *Shkencë e Kozmosit*, ff. 48-51.

30. Mateu 16:26.

ambient modern është pothuajse krejtësisht e pavend ose jashtë kontekstit. Sidoqoftë, ndalesa (apo braktisja) për të cilën flasim është parimore. Nëse në një shoqëri veshja hieratike e një dinjitari të fesë ndalohet, ose edhe kur s'ndalohet me ligj përballet me qesëndi apo edhe përqeshje, kjo d.m.th. se parimi është eklipsuar e bashkë me të edhe rol-modeli e aspirata e njeriut dhe bashkësisë për të qenë shërbëtor dhe mëkëmbës i Zotit. Petkat që duhet të veshim përditë a na ndihmojnë ta përmbushim këtë rol? Nëse përgjigjja nuk është pohuese atëherë ndërgjegjësimi se përballemi me një dukuri jo të rëndomtë, lehtëson shmangien e kësaj vorbulle shterpësie që na heq të drejtën të manifestojmë larminë e Emrave të Bukur (*esma ul-husna), nëpërmjet së cilës mund të njohim Zotin e shpëtojmë shpirtin.*

Gjenerali i famshëm kinez Sun Tzu (v. 496 p.e.s) në traktatin e tij klasik *Arti i Luftës* thotë se rregulla e parë para çdo beteje është "njih armikun tënd" dhe njohja e natyrës së botës moderne, një nga manifestimet e së cilës është veshja moderne, është parakusht për mbrojtjen e traditave të religjionit, pasi është në antagonizëm të plotë me to. Masat mund të jenë krejt të vogla, pasi edhe mundësitë janë të kufizuara. Sidoqoftë, veçanërisht në ambientet private shtëpiake, njeriu ka mundësinë të rrethojë veten me orendi, qilima e punime tradicionale, të zgjedhë muzikën e melodinë që dëgjon, e sidomos gjatë ritualeve, *të zgjedhë një petk tradicional. Ndryshime të tilla kanë një efekt të pallogaritshëm mbi shpirtin e njeriut*, pasi shërbejnë si kanale të hirit hyjnor e përkujtimit të Emrave të Tij, falë origjinës jo njerëzore të arteve tradicionale.[31] Ia vlen të përmendet dhe janë dukuri që japin shpresë e ngrohtësi, se shpesh në dasma, raste, koncerte, e jo vetëm në Shqipëri, njerëzit akoma veshin petka kombëtare, të cilat falë fuqisë së tyre për t'i rikujtuar njeriut arketipet hyjnore ato dhurojnë dinjitet. Ndërsa kur veshjet kombëtare integrohen në rituale si ato të faljeve të Bajramit është e vështirë të mos ndihet prania e shumëfishuar e një nuri e hiri hyjnor. Kemi ndërmend disa foto të vjetra të Namazgjasë së Tiranës para komunizmit ku të gjithë burrat janë me xhamadanë në shtat e secili me qeleshe mbi krye si pika që bashkë formojnë një det bardhësie, duke trupëzuar kështu një manifestim të *teuhidit* – kryeparimit islam – me gjuhën e petkut tonë kombëtar.[32]

Përfundimisht, ashtu siç veshja e një uniforme a petku të caktuar nuk e kthen një person në kolonel apo

31. P.sh., Hazreti Nuhu (Noah) ishte edhe kujdestari shpirtëror i marangozëve, Hazreti Ibrahim i muratorëve, Hazreti Jusuf i orëndreqësve, etj. Po ashtu në Krishterim, Shën Krispini ishte kujdestari shpirtëror i këpucarëve, Shën Bartolomeu i lëkurëpunuesve, Shën Rafaeli i mjekëve, etj.

32. Pa dyshim çdo veshje kombëtare ka efekt të ngjashëm edhe në rituale të religjioneve të tjera.

kirurg, asnjë petk, gunë a kaftan nuk do të shndërrojë kënd si me shkop magjik në njeri të përsosur (*insan kamil*),[33] në vatër të manifestimit (*texheli*) të Emrave të Bukur, në mëkëmbës (*khalif*), në *pontiff,* urë mes Qiellit e tokës, por është e qartë se, parimisht, lloji i petkut që zgjedhim mbetet hapi i parë drejt kësaj përsosurie, ose i largimit prej saj.

33. Shih veprën klasike me të njëjtin titull nga Abdul Kerīm Xhīlī (v. 1424) *Universal Man (Insān-i Kāmil),* (Beshara, 1995) përkthyer pjesërisht nga origjinali në frëngjisht nga Titus Burckhardt, e më pas në anglisht nga Angela Culme-Seymour. Terma analogë të përsosurisë njerëzore gjinden edhe në religjione të tjera: shih 'Vizioni Antropokozmik' në Chittick, *Shkenca e Kozmosit*, ff. 126-144.

E vërteta shkencore mbi "të vërtetën" islamofobe

Prof. dr. Fadil Maloku
Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Abstrakt

Mosnjohja apo mosdija e religjioneve për njëri-tjetrin s'është përparësi, por, pengesë që ka prodhuar, po prodhon dhe do të prodhojë pasoja negative në njerëz dhe të mira materiale, si edhe një frustrim deri në nivel kontinental e global. Kjo, tanimë prodhon padyshim edhe fenomenin tjetër aktual, e me përmasa globale, të shquar dhe të identifikuar si terrorizëm. "Terrorizmi; nuk ka as komb, as shtet, as ... e as fe...! Bota në të cilën po jetojmë ne shquhet si botë e rrezikshmërisë (Risikogesellschaft) së shkallës së lartë!" (Ulrich Beck, Risk Society).

Është një thënie e njohur diku që thotë se: "Urrejtja ndaj Islamit po bëhet gjithnjë e më e madhe se sa dashuria ndaj demokracisë(!), ose, dashuria ndaj demokracisë, po bëhet gjithnjë më e vogël, se sa urrejtja ndaj Islamit"! Gjithashtu, edhe një tjetër që thotë; "Largohuni nga ekstremizmi në fe, sepse ekstremizmi dhe pamaturia në fe i kanë shkatërruar ata që kanë qenë para jush." Qytetarët shqiptarë nuk kanë ndonjë arsye të theksuar që t'i frikësohen Islamit burimor, ose, nuk kanë arsye ta urrejnë Islamin si fe me parime dhe fondamente monoteiste, paqësore. Kjo sepse, çështja e cilitdo besim mbrohet, garantohet dhe kategorizohet me legjislacion, me kushtetutë dhe me ligje. Ata, kanë arsye shumë më tepër që t'u frikësohen interpretuesve injorantë, mediave dhe rrjeteve islamofobe, e sidomos mercenarëve të frustruar myslimanë e jomyslimanë.

Në kushtet dhe rrethanat e disa proceseve dhe zhvillimeve globale, paragjykimi i Islamit si fe monoteiste (së bashku me krishterimin dhe judaizmin), sot në mediat globale dhe rrjetet sociale, është në rritje e sipër! Ajo çka shqetëson më tepër është fakti që interpretimet nuk po bëhen nga ekspertët profesionalë dhe njerëzit kompetentë të fushave dhe lëmive përkatëse, por nga mediokrët mediatikë, pastaj islamofobët dhe grupet e ndryshme dogmatike të proveniencës islame dhe joislame.

Natyrisht, interpretime të tilla jokompetente, sjellin edhe stigmatizim e stereotipizim që e vështirësojnë depërtimin e vizionit paqësor të Islamit të vërtetë. Dhe si pasojë i gjithë këtij "mobiliteti" dosido antiislam, paraqiten edhe tendenca monopoliste mbi të "vërtetën" e vërtetë islame! Thënë me thjesht, paraqiten devijime apo ekstremizma të të gjitha llojeve dhe ngjyrave. Së këndejmi, këtyre tendencave nuk mund t'u ikin as shqiptarët e Ballkanit, e as boshnjakët, që rastësisht apo jo rastësisht, mbeten myslimanë me përkatësi fetare. Tani, koha e globalizimit (si më tha një mik një ditë: "na çoroditi" krejt!?) është e vërtetë se ka prodhuar shumë armiq dhe shumë mundësi të keqinterpretimeve, për këto religjione monoteiste, e në veçanti për Islamin. Shqiptarët, s'ka shans që të përfshihen në këto "lojëra" morbide dhe të qëllimshme globale, për një arsye shumë të thjeshtë: ndjenja kombëtare gjithnjë ka qenë shumë më e fortë se ndjenja fetare. Por, ata, në fakt, do atakohen edhe për një kohë me stigmatizime e paragjykime nga më të ndryshmet, si nga "qendrat" islamofobe, ashtu edhe nga mediokritetet mediatike, të cilat, të frymëzuara nga trendet globale, përpiqen t'i konfrontojnë gjoja "dallimet" fundamentale midis religjioneve monoteiste. Midis këtyre qendrave "islamofobe dhe jo islamofobe", padyshim që sot më të "afirmuarit" dhe më të zëshmit në sferën e sigurisë politike e sociale, e sidomos kulturore, janë ata që ndërlidhen me termat e ekstremizmit dhe terrorizmit. Ekstremizmi, si një platformë sociopolitike dhe padyshim edhe fetare, në fakt ka të bëjë me grupe të tilla sociale, politike e edhe fetare, të cilat kanë probleme serioze me identitetin e tyre të luhatur, kontestuar, apo edhe të humbur për shkaqe të ndryshmet sociale, politike, kulturore, e civilizuese.

Në fakt ideja apo synimi i njeriut, që nga fillimet e hershme sociopolitike, ishte dhe mbetet ai i "vetëkërkimit", për origjinën e tij, se kush është ai, prej nga vjen dhe ku shkon? Një synim identik i "vetëkërkimit", duket se ka të bëjë edhe me grupet, komunitetet, kombet, madje edhe religjionet e shtetet (sidomos ato të reja). Pra, imitimi apo identifikimi i shteteve (veçanërisht atyre të reja dhe të vogla), me shtetet e mëdha

dhe me influencë globale, është pothuajse normal dhe i dukshëm edhe në kohën tonë. Kjo vlen posaçërisht për SHBA-në, Rusinë, Kinën dhe Indinë. Në këtë proces "vetëkërkimi" identitar, pësojnë më së shumti vendet dhe shtetet e ndara (padrejtësisht e historikisht), shtetet e varfra, ato me territor të vogël, e sidomos vendet dhe shtetet që kanë pozitë strategjike në këmbimet, tregtare, sociale e kulturore.

Andaj, pakënaqësitë, mospajtimet lidhur me mënyrat e krijimit të raporteve (lexo; varësive të reja; ekonomike, politike, civilizuese dhe kulturore) është e natyrshme të sjellin edhe mendime e gjykime "laramane" në (mos)kyçjet e reja me hegjemonët e kohës. Si pasojë, lindin dhe pozicionohen grupe të pakënaqura me këto procese e rrjedha; lokale, rajonale, kontinentale e globale. Për të kuptuar më mirë këto trende globale, mendoj që është e udhës të shohim se çka po (nën)kuptohet p.sh. me termin apo konceptin e shpërndarë dhe të njohur gjithandej në glob "Çka është fundamentalizmi islam"? Nëse, dëshirojmë t'i japim një përgjigje tipike shkencore sociologjike, atëherë patjetër që: fundamentalizmi islam duhet shpjeguar edhe si reagim ndaj krizës së identitetit të krijuar nga (post)modernizmi, ndaj tepricës së shoqërive konsumatorizmit, ndaj pafuqisë së imponuar nga padrejtësitë strukturore dhe liberalizimit global të tregut. Faktikisht dhe fatkeqësisht, këtë lloj fundamentalizmi (se janë prezent ne skenën globale edhe të tjerë) po e "ushqejnë" ekspansioni marramendës i tregut (që rezultoi me kolapsin e komunizmit dhe rënien e Murit të Berlinit) dhe interpretimi i fragmentarizuar që i bëhet Islamit të sotëm.

Duke u parë nga ky këndvështrim, islami burimor po bëhet, apo të paktën pretendohet të imponohet, jo më si kundërshti ndaj perëndimit, por si alternativë globale sociale e politike. Ndërkaq, duhet ditur dhe kuptuar që diskursi mbi fundamentalizmin islamik, në fakt në tregun global, është vetëm një katërpërcishi i asaj që është në të vërtetë. Këtu, para së gjithash s'duhet harruar joshja që mund të krijohet në të ardhmen rreth temave mbi: egalitarizmin, përgjegjësinë rreth diversitetit (social, ekonomik, etnik, racor, etj.); konsultimin dhe konsensusin; etj., që realisht i bie një ngatërrim (herë e qëllimshëm, e herë i paqëllimshëm?!) midis asaj që shquhet si edukim fetar dhe histori fetare e religjioneve!

A janë të njëjtë edukimi fetar me historinë fetare dhe pse po ndodh terrorizmi? Duhet kuptuar digresioni se edukimi mbi etnopsikologjinë fetare dhe çështjet e fakteve rreth historive fetare, nuk janë e njëjta gjë. Ngatërrimi i këtyre dy kategorive, përveç keqkuptimit social, sjell edhe trauma në sferën shpirtërore (diversitet dhe ndarje kompleksive) dhe pasoja në sferën politike

(paragjykime dhe stereotipizime absurde). Ato do ndikojnë edhe më tej në formimin, brumosjen dhe kalitjen e secilit individ, edhe për faktin se njeriu, në të vërtetë, akoma mbetet një "zoom politikom", social që vulos të tashmen dhe të ardhmen e vet..., pandalur! Terrorizmin nuk e provokon aq shumë feja, sa e bën atë ekspansioni i grykësisë së kapitalizmit grabitqar dhe shërbimet militante të grupeve mercenare, që janë në shërbim të dominimit (kaosit!) global. Pra, kur kërkohen terroristët, thjesht, duhet të kërkohen njerëzit që blejnë armatim të dyshimtë terrorist, e jo sish që i luten me sinqeritet Krijuesit... Ky term, si dukuri dhe fenomen sociologjik, është edhe një forme tejet e komplikuar e "trajnimit"të dhunës politike. Për të thuhet që është edhe një lloj ekstremizmi me doza politike. Ndërsa ekstremizmi, më saktë, mund të përkufizohet si një lloj sjelljeje e atillë sociale që "vegjeton" gjithnjë midis asaj që është e lejuar dhe asaj që është e sanksionuar. Pra, ai përngjason me një lloj "parakalimi" mbi një zonë të "minuar". Për nga numri, ekstremistët asnjëherë nuk janë shumë, por, janë zhurmues dhe fanatikë në qëllimet dhe synimet e tyre. Çfarëdo lloji qofshin dhe prej kujtdo qofshin. Në politikë, ekstremizmi zakonisht manifestohet si "një lloj animimi" i qëllimeve të kornizuara ekstreme, që pretendon gjithnjë të fuqizohet përmes metodologjive normale. Në fakt, ekstremizmi mund të quhet dhe përkufizohet edhe si një lloj devijimi i skajshëm, edhe për shkak se "vullnetarisht" ikën dhe sistemohet në normat sociale, sportive, politike, e sidomos ato fetare.

Çka i japin "shpirt" dhe karakter fenomenit, apo "dosjes" së ekstremizmit, janë kryesisht motivet dhe qëllimet politike, motive dhe qëllime këto, që me karakterin e tyre politik, ekstremizmin e katapultojnë drejtpërdrejt në fushëbeteja dhe ngjyrime; fetare (monoteiste) e ideologjike (djathtiste e majtiste). Ekstremizmi ideologjik shihet si një rrezik për religjionet monoteiste. Tani, ekstremizmi ideologjik djathtist (ai fetar), e kundërshton globalizimin shkaku ruajtjes dhe konservimit të fondamenteve fetare; kurse, ekstremizmi majtist (ai social komunist), globalizimin e projekton si gogol, edhe shkaku i rrezikut nga varfëria...! Kështu që procesi i "vetëkërkimit", është mjaft kompleks dhe shumëdimensional. Kompleks, për shkak se problemet identitare shpërfaqen tani si probleme akute, që kërkojnë urgjenca definimi dhe qartësimi, ndërsa shumëdimensional, për shkak se dilemat ekzistuese civilizuese, në këto vende e shtete të vogla e të varfra, bëhet shpeshherë problematik dhe i rëndësishëm si për "sponsorët e arkitektët" e pavarësimeve dhe shteteve që u jepet peshë e rendësi, qoftë rajonale (Ballkani) apo kontinentale (Azia). Kështu që "krizat" identitare të stilit;

"kush jemi ne, prej nga vijmë, dhe ku shkojmë", edhe si shtet, vend e komb, sot janë përditshmëri.

Sipas Samuel Huntigtonit, kjo gjendje dhe "krizë" identitare, mund të tejkalohet përmes disa mënyrave. Përmes ndihmës së institucioneve shtetërore, elitave (politike, ekonomike, e kulturore) dhe natyrisht popullsisë, e cila duhet të informohet për nevojat, detyrimet dhe kahet e ndryshimeve eventuale, si edhe ndihmës nga perëndimi (aludimi është; Amerika dhe Evropa). Duhet kuptuar që integrimet evropiane korrespondojnë me proceset globalizuese. Nevoja për një epistemologji sociale të religjioneve monoteiste Nëpër shkolla publike, sot në botën postmoderne, s'duhet të mbetet më një cilësim paragjykues dhe tentim stigmatizimi për religjionet monoteiste, ashtu siç ishte, apo edhe është aktualisht, në pothuajse shumicën e vendeve të tranzicionit, por, është një nevojë imediate e kohës në mënyrë që t'i shmangemi fundamentalizmave, ekstremizmave dhe terrorizmave të të gjitha llojeve dhe niveleve.

Përvoja evropiane na dëshmon se njohjet shkencore (e jo ato pseudo-shkencore) të historive të religjioneve monoteiste (një sferë goxha komplekse dhe e ngarkuar shpesh edhe me klishe pseudo-ekumenike) janë treguar si të shëndetshme edhe për faktin se, mes të tjerash, a) kanë zbutur mendjet paragjykuese, b) kanë shëruar patologjitë sociale, dhe c) kanë reduktuar frustrimet e individëve, grupeve, komuniteteve, por edhe të popujve dhe shteteve të ndryshme evropiane. Pra, kjo iniciativë assesi s'duhet kuptuar dhe interpretuar si tentim për të futur "mësim besimin fetar" nëpër shkolla publike, por si një koherencë kulturore, pra si një njohje ndërfetare midis religjioneve dhe si përvojë e qëndrueshme, ku përmes njohjeve reciproke ndërtohen urat mes feve, konfesioneve, racave, civilizimeve dhe kulturave.

Mosnjohja apo mosdija e religjioneve për njëri-tjetrin s'është përparësi, por, pengesë që ka prodhuar, po prodhon dhe do të prodhojë pasoja negative në njerëz dhe të mira materiale, si edhe një frustrim deri në nivel kontinental e global. Kjo, tanimë prodhon padyshim edhe fenomenin tjetër aktual, e me përmasa globale, të shquar dhe të identifikuar si terrorizëm. "Terrorizmi; nuk ka as komb, as shtet, as ... e as fe...! Bota në të cilën po jetojmë ne shquhet si botë e rrezikshmërisë (*Risikogesellschaft) së shkallës së lartë!" (Ulrich Beck, Risk Society, 325.2009*) 22. Dilema "hamletiane" për mendimin tim qëndron në atë se: a duhet ne nga pragu ynë lokal ta refuzojmë dhe ta kundërshtojmë këtë të keqe (gjë për të cilën jam tërësisht dakord), që ka marrë përmasa të paparashikuara, apo, duhet të mësohemi të "bashkëjetojmë"me të? Përgjigjen (lidhur me terrorizmin)...

e ka problem e gjithë bota ta gjejë. Problemi, (te shumica e sociologëve bashkëkohorë, të paktën me aq sa kam pasur mundësi të shoh) qëndron te shkaqet. E ato, mund të gjenden gjithandej: edhe në tendencën e dominimit, eksploatimit, ndryshimit, imponimit, subordinimit... të kombeve, shteteve, vendeve, rajoneve, kontinenteve... Por, edhe në synimet vetëpërjashtuese të shteteve në rënie, kulturave dhe agjentëve të tjerë dominues sot në botë.

Tek e fundit, kjo është natyra e njeriut, shoqërive, shteteve... etj., por, gjithsesi, jo edhe e civilizimeve, për të vetmin shkak, se civilizimi (qytetërimi) është term shumë më gjithëpërfshirës më vetëcaktues, më vetëkërkues dhe shumë më vetëemancipues.

Ilo Mitko Qafëzezi dhe përkthimi i parë i pjesshëm i Kur'anit në Gjuhën Shqipe

Azmir Jusufi (PHDc)
Prizren, Kosovë

Abstrakt

Kur'ani është bazë themelore e fesë, kulturës e qytetërimit islam dhe, si i tillë, është faktor themelor që bashkon Botën Islame në të gjitha fushat e jetës, andaj nuk është e rastësishme pse popuj të ndryshëm interesoheshin ta përkthenin në gjuhët e tyre.

Kur'ani deri më tani është përkthyer në mbi 100 gjuhë të ndryshme dhe krahas Biblës, Kur'ani është libri më i përkthyer në botë.

Ndërkohë që te popujt e tjerë të Evropës Kur'ani ishte përkthyer nga të krishterët, shumica e të cilëve ishin orientalistë specialistë për gjuhën e kulturën orientale në përgjithësi e atë arabe në veçanti, dhe përkthimit të Kur'anit i ishin qasur për çështje misionare dhe qëllime anti islame, Ilo Mitko Qafëzezi përkthimit të Kur'anit i hyri që t'ua ofronte atë vëllezërve të tij të gjakut, të cilët i përkisnin fesë islame.

Fjalët kyçe: *Kur'ani Kerim, Përkthimi i Kur'anit, përkthimi i parë i pjesshëm i Kur'anit në gjuhën shqipe, Ilo M. Qafëzezi, Miqo Lubibratiq*

Hyrje

Kur'ani është Libër i Allahut xh.sh., i shpallur, nëpërmjet engjëllit Xhibril, të Dërguarit të fundit të Allahut xh.sh., Muhamedit a.s., si mëshirë dhe udhëzim për gjithë njerëzimin. Duke pasur parasysh këtë fakt, nga njëra anë dhe se myslimanët, të cilët janë të përhapur në të gjithë globin nuk e flasin të gjithë gjuhën arabe, por edhe

njerëzit e tjerë, që duan të mësojnë mesazhet kur'anore, sigurisht që është një qëndrim i justifikuar dhe se ishte e nevojshme përkthimi i Kur'anit. Krahas kësaj citohet edhe rregulli i artë se, "Kur'ani nuk mund të përkthehet, por ai duhet të përkthehet."

Kështu që, në këtë punim, në radhë të parë, do të bëhet fjalë për nevojën e përkthimit të Kur'anit, para së gjithash në gjuhën shqipe, kontaktet e para të popullsinë shqiptare me mesazhet e Shenjta të Kur'anit dhe përpjekjet e para të përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe.

Shqiptarët kanë pasur kontakte me Kur'anin shumë herët, po ashtu edhe me vetë përhapjen e Islamit në këto troje, megjithatë, me përkthimet e Kur'anit kanë kontakte shumë më vonë.

Për shkak të arsyeve të njohura, Kur'ani nuk është përkthyer në gjuhën shqipe deri në fund të shek. XIX. dhe nga fillimi i shekullit XX. Hapat e parë në këtë rrugë kanë krijuar përkthyesit e disa pjesëve dhe të sureve nga Kur'ani, duke filluar nga Naim Frashëri (1846-1900), Ilo M. Qafëzezi (1882-1964), Hafiz Ibrahim Dalliu (1878-1952), Hafiz Ali Korça (1873-1956), etj.

Ky punim do të diskutojë rreth përkthyesit të parë të Kur'anit në gjuhën shqipe, Ilo M. Qafëzezi dhe ndërmarrjes së tij në fushën e përkthimit të Kur'anit në shqip.

Në fund të punimit, do të bëhet fjalë për disa krahasime ndërmjet përkthimit të Kur'anit nga Ilo M. Qafëzezi në gjuhën shqipe dhe Miqo Lubibratiq, i cili ishte po ashtu, përkthyesi i parë i Kur'anit në gjuhën serbo-kroate.

Fillimet e përkthimit të Kur'anit te shqiptarët

Interesimi për përkthim, si dhe transferim të kuptimit nga një gjuhë në një tjetër, ka pasur që nga kohërat e lashta, në forma të ndryshme ...[1] Për teorinë e përkthimit, deri në mesin e shekullit të XX-të, lirisht mund të thuhet se rezultoi me diskutimet e pafrytshme rreth tre llojeve të interpretimit: *letrar (fjalë për fjalë), të lirë dhe të besueshëm.*[2]

Edmond Tupja, rreth çështjes së aftësive dhe fillesave në përkthim, thotë: "Me sa di unë, një nga dëshmitë më të vjetra të veprimtarisë së përkthimit, sipas gjasës, është kthimi i Biblës (pjesa e Dhjatës së vjetër)[3] nga hebraishtja e lashtë në greqishten e vjetër. Kjo ka ndodhur në shekullin III dhe II para Jezu Krishtit (Isait a.s.), gjatë kohës së Ptolemeut të II të Filadelfias."[4]

1. Kico, Mehmed, "Povezanost prevođenja s drugim disciplinama", Glasnik, nr. 11-12, Sarajevë, nëntor - dhjetor, 2006:1113.
2. Kico, Mehmed, "Historijski pogled u teorije prevođenja", Glasnik, nr. 7-8, Sarajevë, korrik - gusht, 2006:745.
3 Shënim i redaksisë.
4. Tupja, Edmond, *Kështilla një përkthyesi të ri*,

Sot në botën e qytetëruar ekziston një shkencë e përkthimit që quhet "*traduktologji*"[5] (nga frëngjishtja - *traductologie*), themeluar nga Danica Seleskovitch dhe Marianne Lederer, në vitin 1957 në Paris.[6]

Prof. dr. Jusuf Ramiq, rreth përkthimit të "Librave të shenjtë", thotë: "Përkthimi i Librave të shenjtë, është puna më e vështirë për të cilën hezituan edhe përkthyesit më të shquar. Ata hezituan për hir të asaj, që me përkthimet e tyre të mos lënë diçka që nuk duhet të lihet, e që kjo do të çonte në falsifikimin e tekstit të Librit të Shenjtë."[7]

Sa i përket përkthimit të Kur'anit, kjo është një temë delikate dhe e rëndësishme, sepse jo vetëm që bart në mënyrën më të mirë të mundshme kuptimet, mrekullitë dhe konceptet kur'anore te myslimanët joarab, por është edhe e rrezikshme, sepse nëpërmjet përkthimit të gabuar dhe jo të saktë deformohet e vërteta kur'anore dhe njerëzit mund ta keqkuptojnë Islamin. Shumë njerëz e kanë pranuar Islamin të ndikuar nga leximi i përkthimeve të Kur'anit, shumë të tjerëve u është shtuar besimi dhe dituria rreth Islamit, duke medituar rreth kuptimeve të Kur'anit sipas përkthimeve të bëra në gjuhët e tyre, ndërsa disa të tjerë janë larguar nga e vërteta, si shkak i përkthimeve jo të duhura të citateve kur'anore. Shkaqet dhe arsyet e një përkthimi të gabuar janë të shumta. Ka mundësi që përkthyesi të jetë qëllimmirë, mirëpo nga ana tjetër mund të ndodhë që nuk njeh në mënyrë të shkëlqyer gjuhën arabe, ose gjuhën e tij amtare. Gjithashtu, ekziston mundësia, që përkthyesi të jetë edhe qëllimkeq, jo objektiv dhe jo i drejtë në bartjen e kuptimeve kur'anore.[8]

Kur'ani është libri më fisnik, më i lexuar dhe më i përkthyer në botë, fakt ky, i cili është i njohur për të gjithë ne, megjithatë në bazë të gjithë asaj që është përmendur, shqiptarët deri para pak kohësh nuk kishin një përkthim të kompletuar në duart e tyre.[9] Është e rëndësishme që në fillim të theksohen disa arsye pse shqiptarët janë vonuar në përkthimin e Kur'anit:

(Botimi i dytë), Tiranë, 2000:8.

5. *Traduktologji* – përkthim, transferim në ndonjë gjuhë tjetër. Shih: Marijan Filipović, *Rječnik stranih riječi*, Medicinska knjiga Zagreb, Zagreb, 1995:399.

6. Tupja, *vep. cit.*, f. 12.

7. Selhanović, Selman, "Svaki slijedeći prijevod Kur'ana trebalo bi da bude korak naprijed", Novi Horizonti, f. 65. Shkarkuar nga ueb - faqja: http://www.iltizam.org/tekstovi/read/2472, (shkarkuar më: 15.11.2014).

8. Kazazi, Gilman,"Rreth përkthimeve të Kur'anit", nga ueb-faqja: http://www.progresibotime.com/artikuj/120-rreth-perkthimeve-te-Kur'anit.html, (shkarkuar më: 15.08.2014).

9. Hondozi, Jahja, "Jehona e përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe në shtypin e huaj", Edukata Islame, nr. 93, Prishtinë, 2010:165.

a) Shqipëria në vitin 1967 u shpall shteti i parë ateist në botë,[10] kështu që u ndalua çfarëdo pune në fushën fetare;[11]

b) Komunizmi - nuk ka asnjë dyshim se gjysmëshekulli i regjimit komunist në Shqipëri, e ka dëmtuar kryesisht çështjen fetare;[12]

c) përkthimi i Kur'anit te shqiptarët ka qenë një temë tabu;[13]

d) mungesa e traditës së përkthimit dhe qëndrimi se nuk duhet përkthyer Kur'ani;[14]

e) mungesa e një alfabeti të përbashkët;

f) mungesa e institucioneve profesionale (arsimore, shkencore dhe fetare) në trojet shqiptare për të zhvilluar aktivitetin e vetë në gjuhën shqipe, deri në kohën e ringjalljes kombëtare.[15]

Përkthimi i parë i pjesshëm i Kur'anit në gjuhën shqipe daton nga mesi i viteve '20 të shekullit të kaluar. Mund të duket e çuditshme, por e vërteta është se përkthyesi i parë i Kur'anit në gjuhën shqipe ishte shqiptari ortodoks i krishterë nga Korça, Ilo Mitko Qafëzezi.[16]

Fakti që përkthyesi i parë i fjalës kur'anore në shqip nuk është një mysliman ka shpjegimin e vet. Sigurisht që mendimi jo i drejtë i disa klerikëve fanatikë, se fjala hyjnore mund të transmetohej

10. Yvejsi, Mexhid, *vep. cit.,* f. 71-75. Po ashtu: Akademik dr. Feti Mehdiu, "Më shumë kujdes për botimin e përkthimit dhe interpretimit të Kur'anit në gjuhën shqipe", Edukata Islame, nr. 90., Prishtinë, 2009:77.

11. Hajrullah Hoxha pajtohet me fjalët e Mexhid Yvejsit dhe të Akademikut Feti Mehdiu, kur është fjala për Shqipërinë, mirëpo, ai thotë se ateizmi zyrtar nuk pengoi përkthimin e Kur'anit në Kosovë. Për më shumë shih: Hajrullah Hoxha, "Një vështrim kritik punimit me titull: 'Më shumë kujdes për botimin e përkthimit dhe interpretimit të Kur'anit në gjuhën shqipe", Edukata Islame, nr. 92, Prishtinë, 2010:244.

12. Morina, Qemajl, "Identiteti fetar i shqiptarëve" në: *Shtresimet e identitetit kulturor shqiptar*, Shoqata Kulturore "Zëri Ynë", Zëri Ynë, Prishtinë, 2003, f. 25-31.

13. Ky është mendim i Akademikut Feti Mehdiut të cilin e përmend në punimin e tij me titull: "Më shumë kujdes për botimin e përkthimit dhe interpretimit të Kur'anit në gjuhën shqipe", *vep. cit.,* f. 77. Rreth kësaj, Hajrullah Hoxha nuk pajtohet me mendimin e Feti Mehdiut dhe thotë se përkthimi i Kuranit nuk ishte temë tabu tek shqiptarët, sepse kishte prej atyre që e përkthenin Kuranin. Shih: Hajrullah Hoxha, "Një vështrim kritik punimit me titull: 'Më shumë kujdes për botimin e përkthimit dhe interpretimit të Kur'anit në gjuhën shqipe", *vep. cit.* , f. 244.
Po ashtu, edhe prof. Nexhat Ibrahimi nuk pajtohet me mendimin se përkthimi i Kuranit ishte temë tabu tek shqiptarët dhe thotë: *"Për disa arsye ishte vonuar përkthimi i Kuranit. Por nuk ishte temë tabu..."*.

14. Po aty, f. 244. Këtu mendohet për përkthimin tekstual të Kuranit e jo për ndalimin e përkthimit të tij në përgjithësi.

15. Shih: Ramadan Shkodra, "Përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe". Shkarkuar nga ueb-faqja: http://shkodrar.wordpress.com/16/04/2009/perkthimet-e-Kur'anit-ne-gjuhen-shqipe/, (shkarkuar më: 16.11.2014).

16. Mehdiu, Feti, "O albanskim prevodima Kur'ana", Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, Libri V-VI, Sarajevë, 1978, f. 238.

vetëm në gjuhën e Pejgamberit, nuk ka ndikuar për mirë në këtë drejtim. Porse, siç dihet nuk kanë munguar edhe klerikët atdhetarë, të cilët u angazhuan vetë në drejtimin e punës për sigurimin e një përkthimi sa më të mirë të librit të shenjtë për besimtarët e tyre.[17]

Në kulmin e përpjekjeve rreth përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe ballafaqohemi me dy dijetarë të njohur myslimanë dhe hafizë te shqiptarët në Shqipëri: Hafiz Ali Korça dhe Hafiz Ibrahim Dalliu. I pari kishte botuar përkthimin e 37 ajeteve dhe dy sureve të Kur'anit në Shkodër në vitin 1926, kurse i dyti nga viti 1929 deri në vitin 1944, në tre vëllime botoi përkthimin e 7 sureve (El-Bekare-El-A'raf) me titull: "Ajka e kuptimeve të Kur'anit Qerimit". Ky përkthim është shoqëruar me një koment nga autori. Përpjekje për përkthimin e Kur'anit janë bërë edhe nga Ali Asllani, Ferit Vokopola, Abdullah Zëmblaku, Beqir Maloku nga Gjakova, por me shërbim në Romë, Itali, Mehdi Frashëri, i cili sipas dëshmive të bijve të tij Vehbiut dhe Ragibit, kishte përkthyer Kur'anin, por nuk arriti ta botonte.[18]

Ndryshe nga Ilo Mitkë Qafëzezi specialistët e mirëfilltë si Hafiz Ali Korça e sidomos Hafiz Ibrahim Dalliu i kanë hyrë kësaj pune me një ndjenjë të lartë përgjegjësie, të vetëdijshëm për vështirësitë, që do të ndeshnin në këtë rrugë.[19]

Kush ishte Ilo M. Qafëzezi?

Ilo Mitkë Qafëzezi (1882-1964). Gjurmues dhe studiues në fushën e kulturës dhe të historisë. Jetoi një kohë të gjatë në mërgim. Pasi u kthye më 1924 në atdhe, punoi si mësues. Përktheu, përshtati, përpunoi e hartoi në një gjuhë popullore vepra të ndryshme historike, letrare, folklorike etj. dhe broshura popullarizuese shkencore. Mund të përmendet "Historia e Ali Pashë Tepelenës". Zhvilloi gjurmime sistematike për dokumente, shkrime, figura të historisë e të kulturës shqiptare të shek. XVIII, sidomos të qendrave si Voskopoja, Berati, Vithkuqi, Korça; zbuloi kopje të veprave dorëshkrime të Th. Kavaliotit etj. Hartoi studimin "Kontribut në historinë e arsimit dhe të kulturës në Shqipëri në shekujt XVII-XIX (1617-1902)", që u botua (1926) bashkë me komedinë "Dhaskal Gjoka". Hartoi një monografi të gjerë mbetur në dorëshkrim "Protopapë Theodhor Nastas Kavalioti, Skoliarku i Akademisë së Voskopojës 1748-1789".[20]

17. Shpuza, Gazmend, "Kurani në gjuhën shqipe", shih në ueb-faqe: http://kuranifisnik.com/KuraniFisnik/Artikuj/default.asp?NrArtikull=273
18. Po aty, f. 71-75.
19. Shpuza, Gazmend, "Kurani në gjuhën shqipe", shih në ueb-faqe: http://kuranifisnik.com/KuraniFisnik/Artikuj/default.asp?NrArtikull=273
20. *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë,

Përkthimi i parë i pjesshëm i Kur'anit në gjuhën shqipe

Interesimi i masës së shqiptarëve për t'u njohur drejtpërsëdrejti me fjalën e shenjtë të Kur'anit ka qenë i hershëm. Po ashtu të kahershme kanë qenë edhe përpjekjet e mjaft intelektualëve myslimanë për ta mundësuar një gjë të tillë. Një ndërmarrjeje të tillë i pat hyrë edhe Shemsedin Sami Frashëri për ta përkthyer atë në gjuhën turke, por botimi i këtij përkthimi u ndalua nga qeveria osmane dhe pjesët e përkthyera u asgjësuan.[21]

Me sa dimë, deri tani, përkthimi i mirëfilltë i Kur'anit në shqipe zë fill në vitet '20 të shekullit të kaluar. Mund të duket si e çuditshme, por është e vërtetë se përkthyesi i parë i këtij libri të shenjtë, i njohur deri më sot, është një bashkatdhetar i yni i besimit të krishterë, ortodoks, e pikërisht atdhetari korçar dhe studiuesi i mirënjohur i historisë sonë mesjetare, e më gjerë, Ilo Mitkë Qafëzezi. Ai bëri përkthimin e parë, kuptohet të pjesshëm, të këtij libri në gjuhën shqipe, duke u mbështetur në përkthimin anglisht të bërë nga George Sale. Nga gjithë libri ai arriti të botonte pjesën e parë në Rumani më 1921. Këtë botim autori ua dedikon, siç shprehet vetë, "Bashkatdhetarëve kombëtarë të Shteteve të Bashkuara t'Amerikës". Ndërsa fashikullin e dytë të këtij botimi ai arriti ta shtypë në Korçë, pas gjashtë vjetësh, më 1927. I. M. Qafëzezi nuk qe specialist i Kur'anit dhe as mysliman.[22]

Pra, sipas mendimit të shumicës së studiuesve shqiptarë, përmendet emri i Ilo M. Qafëzezit si përkthyes i parë i Kur'anit, i mesit të viteve '20 të shek. XX, i cili në mënyrë serioze iu përvesh punës për përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe edhe pse vetë nuk i përkiste fesë islame. Në fakt, ka mendime se Naim Frashëri[23] ishte përkthyesi i parë i përkthimit selektiv të pjesëve të Kur'anit, me titull *Thelb i Kur'anit*.[24]

1985:886.

21. Shpuza, Gazmend, "Kurani në gjuhën shqipe", shih në ueb-faqe: http://kuranifisnik.com/KuraniFisnik/Artikuj/default.asp?NrArtikull=273

22. Shih: G. Shpuza, *Përkthyesi i parë i Kur'anit* në gjuhën shqipe, në "Drita islame", dhjetor 1995:4.

23. Ismaili, Elez, "Disa tema dhe dilema rreth përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe", shih në ueb-faqe: http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=3185

24. Thelb i Kuranit, pjesë përbërëse e

Disa fjalë rreth përkthimit të Kur'anit nga Ilo M. Qafëzezi

Ndërmarrja e I. M. Qafëzezit është sigurisht qëllimmirë e besëmirë. Për shqiptarët e cilitdo besimi qofshin, ai u jep në dorë një libër të madh, librin epokëbërës.

Jomyslimanë e kanë përkthyer Kur'anin edhe në gjuhë të tjera evropiane. Por ka pasur nga ata, si Maracci, që dha më 1689 një version të Kur'anit me tekstin arab e me komente të mbledhura qëllimisht andej-këtej, për të përcjellë përshtypjen më të keqe të mundshme për Islamin në Evropë. Përkthimi i George Sale në anglisht, më 1737 u mbështet në versionin e Maraçit, madje edhe në shënimet e komentet e tij.[25]

Për përkthimin e tij të Kur'anit, Ilo M. Qafëzezi thotë: "Afërmêntsh, përkthimi im do të ketë disa të meta, mbassi nuk' është bërë drejt-për-drejt prej origjinálit Arabisht. Po Shqipëtarët e mirë, atdhetarët që s'janë veshur trashë me fanatizm fetár, e-do-puna të m'i falin. Përkthimi im dëshëronj të jetë një fillésë e atí që do të bênet i sosur paskëndáj. Të jetë një ndihmë, sado e pakët për atë teollog që do të ketë fatbardhësinë të përkthenjë Kur'anin nga Arabishtja. I shpërhódha ato që thonë disa se *të përkthyerit e Kur'anit ndê gjuhë tjatër është gjynah i math.* Qysh mundim t'u vêmë-vesh të tillavet fjalë që-s'kanë-vënt, kur sot-për-sot *Kur'ani* gjëndet i përkthyer afëro ndë një dyzinë gjuhë të tjera, edhe posa që ná kemi aqë të madhe nevojë t'a kemi të përkthyer ndë gjuhën âmtare."[26]



Faksimile e pjesës së parë të përkthimit të Kur'anit nga Ilo M. Qafëzezi, Rumani, 1921

veprës Mësime në botimin e kompletit të veprave të Naimit, si në Tiranë po ashtu edhe në Prishtinë, nuk përmendet fare. Botimin e parë të kësaj vepre e ka bërë vetë Naimi në Bukuresht më 1894. Studimin më të plotë të këtij kontributi e ka bërë dr. Mahmud Hysa. Më gjerësisht shih studimin me titull Naim Frashëri si përkthyes i një varianti të Kuranit të këtij autori në veprën: *Alamiada shqiptare II,* Logos-A, Shkup 2000:39-79.

25. Shehu, Hajri, *"Një përkthim i Kuranit i vitit 1921 në gjuhën shqipe",* PERLA – Revistë shkencore – Kulturore tremujore, Viti XI , Nr. 2 (41), Botuesi: Fondacioni Kulturor "Saadi Shirazi", Tiranë, 2006:85-92.

26. Po aty, f. 85-92.



Faksimile e pjesës së dytë të përkthimit të Kur'anit nga Ilo M. Qafëzezi, Korçë, 1929

Ai nuk përkthen sa për t'u treguar shqiptarëve një libër që quhet Kur'an. Përkthimi i tij është i kujdesshëm. Ai është i kujdesshëm edhe në drejtshkrimin e fjalëve. Ai nuk e paraqit të vështirë Kur'anin. Stili i tij është i përpunuar e i krehur. Natyrisht, po të kishte pasur përkthimi shpjegime e komentime për ajete a çështje të veçanta, do të kishim pasur edhe mendjen e tij dhe besoj edhe vlerësimin e tij midis shumë mendjeve e vlerësimeve të tjera në botë për Kur'anin. Megjithatë, mjafton edhe përkthimi, sepse Kur'ani është vetë komentimi i tij më i mirë... Merita e tij e madhe është: ai është ndër të parët që i njohu mirëfilli shqiptarët me Kur'anin.

Kur'ani është përkthyer nga gjuha angleze, siç e thotë vetë I. M. Qafëzezi në parathënien e tij.[27] Ai i përktheu gjashtë suret e para të Kur'anit, nga *El-Fatihaja* deri te *El-En'am*.[28]

Përkthimi i Kur'anit në gjuhën shqipe fillon në faqen 5, me përkthimin e sures së parë Fatiha. Ky përkthim nuk është i komentuar e as i shoqëruar me tekst origjinal, ndërsa çdo ajet fillon me kryerresht të ri, pasi, paraprakisht, ajetet janë të numëruara sipas versionit në frëngjisht të M. Savaryt, siç e ka shpjeguar përkthyesi në parathënie.

Qafëzezi, në fillim të sureve ka dhënë shënime të përgjithshme të sures, si p.sh: *Kaptinë I (Sura), Ndërhyrje (Fatihat), Shpërfaqur ndë Meqe*[29], apo: Kaptinë VI, Shtazët, *Shpërfaqur ndë Meqe*. Përkthimi i I. M. Qafëzezit nuk është i fjalëpërfjalshëm. Po të kishte qenë i tillë, nuk do t'i përçonte dot te lexuesi përmbajtjen dhe idetë e përmbajtjes së përkthimit të tij. Shih p.sh. *Fatihanë*:

27. Po aty.
28. Shkodra, Ramadan, "Kontributi i qarkut fetar islam të Kosovës pas luftës së dytë botërore në shqipërimin e Kuranit", *Kurani te shqiptarët,* Botues: Bashkësia islame e Kosovës, Prishtinë, 2016:113.
29. Shih: Kurani (Këndimi), pjesa e parë, përkthyer në shqip prej: I. M. Q, Shtypur në Rumani, Ploeshti, 1921, f. 5. Ose shih në ueb-faqe: https://shkodrar.wordpress.com/2009/04/16/80-vjet-te-perkthimit-te-kur%E2%80%99anit-ne-gjuhen-shqipe-1921-2001/.

KAPTINË I. (Sura) NDËRHYRJE (Fâtihat)

Shpërfaqur ndë Meqé

NDË EMËR TË FORT MËSHIRËPLOTIT PERËNDI

1. Lavdi i kjoftë Perëndisë; Zoti i gjithë Krijatyravet.
2. Fort mëshirëploti;
3. Mbreti i ditës së gjyqit.
4. Ty të adhurojmë, edhe prej teje lypim ndihmë.
5. Udhë-hiqna ndë rrugën e drejtë.
6. Ndë rrugën e atyre mbë të cilët ke qenë hirëplot;
7. Jo ndë (rrugën) të atyre kundër të cilëvet ke marë mërí, as ndë të atyre që écëjn jashtë-udhës.[30]

Qëllimi kryesor i përkthyesit ka qenë t'ia bënte të qartë lexuesit kuptimin e saktë të ajetit a të fjalisë. Për këtë arsye, kur përdor një krijim të tij a një fjalë të huaj, jep me poshtëshënim një fjalë tjetër, një perifrazim a një shpjegim qartësues.[31]

Shkaqet për një ndërmarrje të tillë

Shkaqet të cilat e shtynë njeriun e letrave të ndërmerrte përkthimin dhe botimin e Kur'anit, përmenden në parathënien e botimit të tij: "I shtyjtur prej dëshirës që, tani pak-sëpaku, është koha të dihet se cila është ajo '*cipë qèpe*' misterióze që i ndan fetarisht Shqipëtarët Muhamedanë nga vëllézërit e tyre të Krështerë, po jap të përkthyer Shqip *Kuránin,* nga gjuha Inglize."[32]

Në faqen e brendshme të kopertinës është dhënë përkushtimi i përkthyesit: "*Bashkatdhetarëve kombëtarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës u dedikohet*"[33], ndërsa përkthimit i paraprin shënimi i Qafëzezit, i dhënë në formë të parathënies, ku ai lexuesit i jep disa informacione me rëndësi për historikun e përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe. Shënimi mban titullin: "*Shqipëtarëvet*".

Po ashtu: "Le të bëjmë nga librat fetarë, çështje të kulluar kombëtare. S'është nevoja të dobëtojmë ndjenja të shpirtit. Nga këjo nuk e gjen fare dem Shqipërin' e sotme. Vetëm fanatizmi fetar duhet ndjekur edhe luftuar, gjer të shduket nga zemrat e Shqiptarëve që e duan Shqipërinë'e lirë ndë radhë qytetërimi. Tjetrazi jemi të humbur".[34]

30. Shehu, Hajri, *"Një përkthim i Kuranit i vitit 1921 në gjuhën shqipe",* vep. cit., f. 85-92.
31. Po aty, 85-92.
32. Po aty, 85-92.
33. Shih: Kurani (Këndimi), pjesa e parë, përkthyer në shqip prej: I. M. Q., Shtypur në Rumani, Ploeshti, 1921, f. 3. Ose shih në ueb-faqe : https://shkodrar.wordpress.com/2009/04/16/80-vjet-te-perkthimit-te-kur%E2%80%99anit-ne-gjuhen-shqipe-1921-2001/
34. Shpuza, Gazmend, *Përkthyesi i parë i Kur'anit* në gjuhën shqipe, në: "Drita islame", dhjetor 1995:4.

Ilo M. Qafëzezi nuk është mysliman, por nuk është antimysliman. Po të kishte qenë antimysliman e siguristh edhe jo atdhetar (ai nuk i ndan shqiptarët dhe shqipen), do ta kishte përkthyer Kur'anin në një gjuhë bisedore, a thjesht, në idiolektin e tij e kështu do të humbiste madhështia e stilit të arabishtes klasike.[35]

Jo vetëm në fushën e mendimit, por edhe në fushën e zbatimit të tyre praktik, Ilo Mitkë Qafëzezi ka dhënë prova të një koncepti të gjerë dhe përparimtar për bashkëjetesën dhe mirëkuptimin midis besimtarëve të feve të ndryshme në atdheun e tij. Duke pasur parasysh përpjekjet e armiqve të vendit tonë dhe të agjenturave të tyre për t'i përdorur besimet e ndryshme fetare, që ekzistojnë në Shqipëri, si mjete për përçarjen e popullit tonë, për ta penguar atë të ecë në rrugën e lirisë dhe të përparimit, Ilo Mitkë Qafëzezi i hyn me shumë guxim dhe pa komplekse një pune të tillë jo të lehtë.[36]

Reagimet ndaj përkthimit të Kur'anit nga Ilo M. Qafëzezi

Qafëzezi ka meritat e veta, sepse, siç konstaton edhe studiuesi Gazmend Shpuza, deshi të bëjë një "çështje të kulluar kombëtare"[37] dhe të paraqesë prova të një koncepti të gjerë dhe përparimtar për bashkëjetesën dhe mirëkuptimin midis besimtarëve të feve të ndryshme në atdheun e përbashkët. Është i kuptueshëm edhe karakteri i tij iluminist. Por, kur bëhet fjalë për Kur'anin, çfarë meritash i takojnë një përkthyesi, që merr guximin të përkthejë Kur'anin, ose cilindo libër të shenjtë, nga një gjuhë që s'ka as afërsinë më të vogël me gjuhën në të cilën është shpallur? Megjithatë tashmë janë të njohura reagimet për përkthimet e Kur'anit, ose çfarëdo vepre tjetër, jo drejtpërdrejtë nga origjinali arabisht, madje ato përkthime kanë dalë të dyshimta dhe jo qëllimmira.

Për përkthimin e Ilo M. Qafëzezit do të mjaftonte edhe reagimi i H. Vehbi Dibrës në revistën "Zani i Naltë", nr. 12 të vitit 1924, f. 384, që është i njëjtë me reagimin e ulemave boshnjakë rreth përkthimit të Kur'anit nga përkthyesi Miqo Lubibratiq.

Qafëzezi ishte i vetëdijshëm se përkthimi i tij nuk është në nivel të kënaqshëm e të dëshirueshëm, aq më tepër kur nuk është bërë nga origjinali, por nga anglishtja. Madje ai nga shqiptarët e mirë, që nuk janë të ndikuar nga fanatizmi fetar, kërkon mirëkuptim për lëshime eventuale në përkthimin e tij: "…..*Po Shqipëtarët e mirë, atdhetarët që s'janë veshur trashë me fanatizm fetar, e-do-puna të m'i falin. Përkthimi im dëshironj të jetë një fillesë e ati që e do të benet i sosur paskëndaj. Të jetë një ndihmë, sado e pakët për atë teollog që do të*

35. Samara, M., *Histori e gjuhës letrare shqipe,* Tiranë, 2005:104.

36. Shpuza, *Përkthyesi i parë i Kur'anit* në gjuhën shqipe, vep. cit., f. 4.

37. Po aty., f. 4.

ketë fatbardhësinë të përkthejë Kur'anin nga Arabishtja".[38]

Ky përkthim, duke përjashtuar format e vjetra të gjuhës shqipe, që nuk përdoren tani, ka qenë shumë i suksesshëm. Përkthyesi, në fund të fjalës hyrëse, përmend se çdo vërejtje mbi këtë përkthim do të jetë e dobishme për të dhe: "Unë do ta pranoj atë me gëzim dhe zemër të hapur", shton ai.[39]

Në kopertinën e fundit gjithashtu përmenden të dhënat se ky përkthim i Kur'anit u botua në shtypshkronjën "Konkurrenca" të z. V. Dumitresku në Ploesht, Bukuresht.[40]

Disa konstatime rreth këtij përkthimi të Kur'anit

Është fakt se me çështjen e përkthimit të Kur'anit janë marrë dijetarët më eminentë të proveniencës islame dhe të gjithë kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me të. Duke i analizuar mendimet e tyre, mund të konstatojmë se përkthyesit e të gjitha kohërave nuk kanë qenë kategorikë që të mos përkthehet Kur'ani, por janë pajtuar në pikën se, ky thesar hyjnor t'iu ofrohet popujve të mbarë botës. Dhe së fundi duhet të pajtohemi me këto dy konstatime, që mund t'i përdorim si moto. E para e H. Vehbi Dibrës, që del nga deklarata e tij me rastin e botimit të disa pjesëve të Kur'anit në turqisht dhe shqip. Ai thotë: "Si kur qi dihet Kur-ani asht fjala e madhnueshme e krijuesit të Gjithsis, prandaj lypset me u përkthye madhnisht e nuk asht punë qi mbarohet me pendën e meftshme të mend shkurtënve". Kurse, për përkthimet me gabime thotë: "me këndue ksi soj librash se gabimet qi duken sheshit në përkthimet e përmendura mund t'u ngatrrojn besimin e prandaj i porosisim qi të mos u napin randsië dhe mos t'i këndojnë fare."[41] Po ashtu, maksima tjetër me rrëndësi është edhe ajo e akademikut boshnjak, prof. dr. Enes Kariç, i cili në librin e tij "Si të komentohet Kur'ani" thotë: "*Kur'ani nuk mund të përkthehet, por Kur'ani duhet të përkthehet (komentohet)!*"[42]

Përkthimet e Kur'anit nga Ilo M. Qafëzezi (shqip) dhe Miqo Lubibratiq (serbo/kroatisht) - Krahasime

Për ne ka rëndësi të vëmë një paralele ndërmjet përkthimit të Lubibratiqit[43] dhe të Ilo M.

38. Shih: Kurani (Këndimi), pjesa e parë, përkthyer në shqip prej: I. M. Q., Shtypur në Rumani, Ploeshti, 1921, f. 3. Ose shih në ueb-faqe: https://shkodrar.wordpress.com/2009/04/16/80-vjet-te-perkthimit-te-kur%E2%80%99anit-ne-gjuhen-shqipe-1921-2001/

39. Kurani (Këndimi), *vep. cit.,* f. 4 (fusnota nr. 15).

40. Mehdiu, Feti, "O albanskim prevodima Kur'ana", Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, LibriV-VI, Sarajevë, 1978:240.

41. Deklaratë e Krye Muftiut, Zani i Naltë, nr. 12, Shtator 1924, f. 384.

42. Enes Karić, *Kako tumačiti Kur'an*, Tugra, 2005, f. 50.

43. Më shumë informacione për Miqo Lubibratiqin dhe përkthimin e tij të

Qafëzezit, sepse duke e njohur sa më afër punën e Lubibratiqit, do të kuptojmë edhe qëllimin e Qafëzezit.[44] Në veprën e tij "*Tefsir-hyrje në shkencën e tefsirit*", botim i "Bosanska knjiga", Sarajevë 1995, faqe 264, në kapitullin mbi përkthimet e Kur'anit, që nga Miqo Lubobratiqi, deri te Besim Korkuti, autori na jep profilin e vërtetë të përkthyesit Lubobratiq, i cili e ka përkthyer Kur'anin nga frëngjishtja[45] ose nga rusishtja[46] dhe atë për t'i pajtuar serbët "me muhamedanët e kombësisë serbe". Ai njihej si udhëheqës i kryengritësve hercegovianë dhe person që proklamonte "bashkëpunimin vëllazëror të serbëve dhe myslimanëve boshnjakë". Ky gjest i Lubobratiqit u trajtua si hap antiislam *par exellence* nga ana e ulemave të kohës.[47]

Akademiku Dr. Feti Mehdiu, thotë se është shumë interesant fakti se dy përkthimet e para, në dy gjuhët e dy etniteteve të ndryshme në Ballkan, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën sllave jugore, janë nga dy përkthyes, të cilët nuk i përkasin fesë islame. Ai që e përktheu i pari në gjuhën serbokroate M. Lubibratiq ishte një person politik publik, ndërsa ai që e përktheu, megjithëse jo në tërësi, Kur'anin në gjuhën shqipe, Ilo Mitko Qafëzezi, ishte një punëtor kulturor publik. Arsyet përse ka ndodhur kështu mund të jenë të ndryshme. Kjo nuk është objekt shqyrtimi me këtë rast, por kjo mund të jetë një dëshmi më tepër se librat e shenjtë në Ballkan janë respektuar edhe nga ithtarët e librit tjetër. Në rastin konkret dy ithtarë të Ungjillit i rreken dhe përkthejnë Kur'anin në gjuhën e tyre amtare, njëri serbisht e tjetri shqip, siç thoshte Qafëzezi për vëllezërit e tij të një gjuhe.[48]

Duke marrë parasysh faktet historike dhe fatin e përjetuar nga popujt e Ballkanit; duke përfshirë edhe shqiptarët, që fituan pavarësinë në vitin 1912, konsiderojmë se konstatimi gojor është se Kur'ani

Kuranit në gjuhën serbo-kroate shih në: Enes Karić, „Koran – prijevod Kur'ana Miće Ljubibratića Hercegovca", Preporod, nr. 8/1066, 15. Prill 2016, f. 32. Po ashtu shih: Sinan Gudžević, „Koja riječ o dvojici prevodilaca", Godišnjak 2012, BZK Preporod, Viti XII, Sarajevë, 2012, f. 222-230. Po ashtu: Dr. Muhamed Hadžijahić, „Bibliografske bilješke o prijevodima Kur'ana kod nas", Bibliotekarstvo (Časopis društva bibliotekara Bosne i Hercegovine), Viti XIII, nr. 3., Sarajevë, 1967, f. 43-44.

44. Shih në ueb-faqet: http://islampress.info/2016/03/03/disa-tema-dhe-dilema-rreth-perkthimit-te-kuranit-ne-gjuhen-shqipe/, ose shih në: http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=3185.

45. Siç pretendon Dragutin Iliqi në librin e tij „Poslenji prorok", u fusnotën në f. 91. Shih: Prof. dr. Enes Karić, *Tefsir – Uvod u tefsirske znanosti,* Bosanska knjiga, Sarajevë, 1995, f. 266.

46. Shih: Dr. Muhamed Hadžijahić, „Bibliografske bilješke o prijevodima Kur'ana kod nas", *vep. cit.,* f. 44.

47. Shih në ueb-faqe: http://www.foltash.com/disa-tema-dhe-dilema-rreth-perkthimit-te-kuranit-ne-gjuhen-shqipe/.

48. Mehdiu, Feti, "Koegzistenca e tre librave të shenjtë dhe ardhmëria e tyre në Ballkan", URA, nr. 1, Vjeshtë-Dimër 2008, Tiranë.

është përkthyer më herët në gjuhët e njerëzve, të cilët fituan më vonë pavarësinë dhe duke filluar lirshëm zhvillimin shkencor e kulturor në të gjitha fushat.[49]

Fati i përkthimit të parë shqiptar të Kur'anit në shumë aspekte është i ngjashëm me përkthimin serbo-kroat të Kur'anit:

- Duhet të theksohet menjëherë se përkthimi i parë i Kur'anit në gjuhën shqipe dhe serbo-kroate është realizuar nga jomyslimanët, pra nga të krishterët ortodoksë. Kjo është shumë e rëndësishme për t'u përmendur kur bëhet fjalë për mjedisin mysliman, siç është shembulli i Bosnje e Hercegovinës dhe Shqipërisë. Është një rast tjetër me zona gjuhësore angleze dhe franceze; [50]

- Një ngjashmëri tjetër është në qëllimin me të cilin përkthyesit iu afruan punës së përkthimit të Kur'anit. Ljubibratiq me qëllim të "pajtimin me muhamedanët e kombësisë serbe", kurse Qafëzezi "vëllezërve të mi, vëllezërve muhamedanë... të kombësisë shqiptare".

- Ngjashmëria e tretë është në aspektin e pajisjeve teknike dhe esencës thelbësore, pasi që të dy, gjatë përkthimit të Kur'anit, ishin të disponueshëm kombtaro-politikisht kur iu përveshën kësaj pune;[51]

- Karakteristika e katërt është se Qafëzezi Kur'anin nuk e përktheu nga origjinali (gjuha arabe), por e përktheu nga anglishtja (George Sale); ndërsa Ljubibratiq e bëri atë nga gjuha frënge (Kazimirski). [52]

- Si përkthyesi i parë ashtu edhe përkthyesi i dytë e kishin shkelur rregullin midis Ulemasë myslimane lidhur me përkthimin e Kur'anit, i cili ishte: "përkthimi i Kur'anit në gjuhë të tjera është një mëkat i madh ...".

Konkluzione

Nga sa u paraqit më parë në këtë punim, mund të konkludojmë si në vijim:

- Përkthimi i Kur'anit nga origjinali në gjuhët e botës është një nga nevojat më të rëndësishme të njerëzve - kryesisht myslimanë;

- pas të gjitha diskutimeve në lidhje me problematikën e përkthimit të Kur'anin është sjell rregulli i artë në këtë çështje, i cili thotë: "Kur'ani nuk mund të përkthehet, por ai duhet të përkthehet";

- shqiptarët, sikurse edhe kombet e tjera të botës, kanë pasur një nevojë të ngutshme për përkthimin e Kur'anit në gjuhën e tyre amtare edhe pse një shtresë e shoqërisë veç i kishte përdorur përkthimet e Kur'anit në gjuhën angleze ose turke;

- përkthimi i Kur'anit në gjuhën shqipe u bë shumë vonë, d.m.th. në fund të shek. XIX edhe pse jo

49. Mehdiu, Feti, "O albanskim prevodima Kur'ana", Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, vep. cit., f. 238.
50. Po aty, f. 239.
51. Shehu, Hajri, *"Një përkthim i Kuranit i vitit 1921 në gjuhën shqipe"*, f. 239.
52. Po aty, f. 239.

edhe shumë më vonë se përkthimi i Kur'anit në gjuhët sllave;

- Ilo M. Qafëzezi dha përpjekjen e parë paksa më serioze në fushën e përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe, një përpjekje që duhet vlerësuar dhe dhënë rëndësinë e vlerën e duhur në shoqëri;

- ky përkthim i Kur'anit edhe pse jo i tërë, me një gjuhë të veçantë vizuale dhe mangësitë teknike, duke pasur parasysh se ishte përkthimi i përkthimit të Kur'anit, është një nga kontributet e para dhe më të rëndësishme në fushën e përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe, një ndërmarrje e cila i dha frytet e veta për përkthime të mëvonshme të Kur'anit.

- përkthimi i Kur'anit nga Ilo Mitko Qafëzezi në gjuhën shqipe ndan shumë ngjashmëri me përkthimin e Kur'anit nga Miqo Lubibratiq në gjuhën serbo-kroate, por me gjithë ato që përmendëm, e veçanta, është se këto përkthime janë bërë nga gjuhë të tjera (frëngjisht, anglisht) dhe se atë e bënë pasuesit e besimit të krishterë (ortodoks).

Literatura dhe burimet:

1. Bardhi, Ismail (1998), *Ibrahim Dalliu dhe egzegjeza e tij Kur'anore*, Logos – A, 1998, Shkup.
2. Busuladžić, Mustafa (1945), *Prvi prievodi Kur'ana u svietu i kod nas,* 1945, Sarajevë.
3. Gudžević, Sinan (2012), "Koja riječ o dvojici prevodilaca", Godišnjak 2012, BZK Preporod, Godina XII, 2012, Sarajevë.
4. Hadžijahić, Muhamed (1967), "Bibliografske bilješke o prijevodima Kur'ana kod nas", Bibliotekarstvo (Časopis društva bibliotekara bosne i hercegovine), Viti XIII, nr. 3, 1967, Sarajevë.
5. Hondozi, Jahja (2010), "Jehona e përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe në shtypin e huaj", Edukata Islame, nr. 93, 2010, Prishtinë.
6. Hoxha, Hajrullah (2010), "Një vështrim kritik punimit me titull: 'Më shumë kujdes për botimin e përkthimit dhe interpretimit të Kur'anit në gjuhën shqipe", Edukata Islame, nr. 92, 2010, Prishtinë.
7. Hysa, Mahmud (2000), *Alamiada shqiptare II*, Logos-A, 2000, Shkup
8. Ismaili, Elez (2016), "Disa tema dhe dilema rreth përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe", *Kur'ani te shqiptarët,* Botues: Bashkësia Islame e Kosovës, 2016, Pishtinë.
9. Karić, Enes (1995), *Tefsir – Uvod u tefsirske znanosti*, izdavač: Bosanska knjiga, 1995, Sarajevë.
10. Karić, Enes (2005), *Kako tumačiti Kur'an*, Tugra, 2005, Sarajevë.
11. Karić, Enes (2016), "Koran – prijevod Kur'ana Miće Ljubibratića Hercegovca", Preporod, nr. 8/1066, 15. Prill 2016, Sarajevë.
12. Kico, Mehmed (2006), "Historijski pogled u teorije prevođenja", Glasnik, nr. 7-8., korrik - gusht, 2006., Sarajevë.
13. Kico, Mehmed (2006), "Povezanost prevođenja s drugim disciplinama", Glasnik, nr. 11-12, nëntor - djetor, 2006, Sarajevë.
14. Mehdiu, Feti (1978), "O albanskim prevodima Kur'ana", Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, Knjiga V-VI, 1978, Sarajevë.
15. Mehdiu, Feti (1996), *Përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe*, Logos-A, Shkup.
16. Mehdiu, Feti (2008), "Koegzistenca e tre librave të shenjtë dhe ardhmëria e tyre në Ballkan", URA, nr. 1, Vjeshtë-Dimër, 2008, Tiranë.
17. Mehdiu, Feti (2009), "Më shumë kujdes për botimin e përkthimit dhe interpretimit të Kur'anit në gjuhën shqipe", Edukata Islame, nr. 90, 2009, Prishtinë.
18. Morina, Qemajl (2003), "Identiteti fetar i shqiptarëve" në: *Shtresimet e identitetit kulturor shqiptar*, Shoqata Kulturore "Zëri Ynë", Zëri Ynë, 2003, Prishtinë.
19. Selhanović, Selman, "Svaki slijedeći prijevod Kur'ana trebalo bi da bude korak naprijed", Novi Horizonti, f. 65. Shkarkuar nga ueb-faqja: http://www.iltizam.org/tekstovi/read/2472.
20. Shehu, Hajri (2006), *Një përkthim i Kur'anit i vitit 1921 në gjuhën shqipe,* PERLA, Viti. XI., 2006., No. 2 (41), Botues: Fondacioni Kulturor "Saadi Shirazi" – Tiranë.
21. Shkodra, Ramadan (2016), "Kontributi i qarkut fetar islam të Kosovës pas luftës së dytë botërore në shqipërimin e Kur'anit", *Kur'ani te shqiptarët,* Botues: Bashkësia islame e Kosovës, 2016, Prishtinë.
22. Shkodra, Ramadan, "Përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe": http://shkodrar.wordpress.com/2009/04/16/perkthimet-e-Kur'anit-ne-gjuhen-shqipe/.
23. Shpuza, Gazmend (1995), *Përkthyesi i parë i Kur'anit* në gjuhën shqipe, në: Drita islame, dhjetor 1995, Tiranë.
24. Shpuza, Gazmend, "Kur'ani në gjuhën shqipe": http://Kur'anifisnik.com/Kur'aniFisnik/Artikuj/default.asp?NrArtikull=273.
25. Yvejsi, Mexhid (2010), "Pse u vonuan shqiptarët me përkthimin e Kur'anit", URA, nr. 1, 2010, "Qendra Shqiptare për Studime Orientale", Tiranë.

Rëndësia e edukimit fetar

Dr. Adil Kutlu
Departamenti i Shkencave Islame, Universiteti Bedër

Abstrakt

Arsimi është një organizim i themeluar nga njerëzit me qëllim që t'u përgjigjet nevojave të së sotshmes e të ardhmes dhe i formuar të plotësojë zhvillimin e shoqërisë përkrah vazhdimësisë së saj. Kështu edhe feja, zotëron një hapësirë kulture dhe njohurie që ndikon ç'do njeri, pavarësisht nëse beson ose jo. Feja dhe arsimi, të cilët bashkohen në pikën e edukimit të njeriut dhe formimit të tij në përputhje me objektiva të veçanta, kanë shumë anë të njëjta dhe është e pamundur të mendohet edukimi fetar jashtë edukimit të përgjithshëm. Në fakt, edhe diskutimet e ditëve të sotme nuk janë rreth çështjes a duhet të jetë edukimi fetar pjesë e edukimit të përgjithshëm apo jo, por përqendrohen në "sa"-në dhe "si"-në e kësaj pjesëmarrjeje.

Parashtrimi i kësaj çështjeje duke e trajtuar subjektin në dimensione të ndryshme si nevoja për këtë hapësirë, rëndësia, tema dhe qëllimi i saj, do të jetë i dobishëm në lidhje me edukimin fetar.

1. Subjekti i edukimit fetar

Në ditët e sotme, aktivitetet edukative-arsimore kryhen në fusha të ndryshme. Njëra nga këto fusha është ajo e edukimit fetar. Për sa i përket marrëdhënies së fesë me edukimin, në kontekst pozite, feja, e cila zotëron një fushë të sajën akademike, ka lidhje me shumë shkenca që përbëjnë një fushë të gjerë me në krye edukimin dhe shkencat fetare. Disa nga shkencat e tjera, që mund të përmenden si fusha me të cilat ka lidhje edukimi fetar, janë: psikologjia, psikologjia fetare, sociologjia arsimore dhe biologjia.

Marrëdhënia e edukimit fetar me shkenca të ndryshme tregon qartë se në mësimdhënien e edukimit fetar nuk është e mjaftueshme vetëm njohja e fesë, por edhe se njeriu, i cili do ta marrë këtë edukim, duhet njohur nga afër. Edukimi fetar, ashtu siç mund të vlerësohet si një shkencë e teologjisë, gjithashtu mund të shihet edhe si një nëndisiplinë e shkencave edukative. Cilado që të vlerësohet si pika e fortë e edukimit fetar, arsimi apo teologjia, edukimi fetar zotëron një pozitë të rëndësishme në formimin e një jete paqësore në shoqëri, duke formuar njerëz të shëndetshëm dhe të ekuilibruar.[1]

Megjithëse edukimi fetar e ka marrë përmbajtjen nga feja dhe morali, nuk mund të thuhet se këto dy terma thelbësore përmbajnë subjektin e edukimit fetar. Këtu, kryesore është përcjellja e fesë dhe moralit me anë të edukimit e arsimit dhe zotërimi prej të rinjve i këtyre njohurive. Edukimi fetar nuk e ka të gatshëm subjektin e tij; subjekti, del në pah në përfundim të aktiviteteve dhe kërkimeve të tij, sepse subjekti i një shkence përcaktohet nga fusha ku zhvillon kërkimet ajo shkencë, temat që trajton dhe metodat, që do ta çojnë në arritjen e synimeve.[2]

Edhe subjekti i edukimit fetar mund të nxirret nga aktivitetet e realizuara në këtë fushë. Një qasje më nga afër edukimit fetar do të nxjerrë në pah se subjekti i tij përbëhet nga njëra anë nga edukim-arsimi dhe nga ana tjetër nga analizimi i subjekteve në fushën shkencore të edukimit fetar, si një disiplinë shkencore e pavarur. Kjo gjendje na tregon se edukimi fetar ka dy aspekte: atë teorik dhe atë praktik dhe duket qartë se është e pamundur ndarja e aspektit praktik të edukimit fetar nga ai teorik. Pavarësisht se cilit prej këtyre dy aspekteve të edukimit fetar i jepet përparësi, mund të themi, pa dyshim, se subjekti themelor i tij është përcjellja e çështjeve fetare tek individi. Në këtë rast, duke qenë se qëllimi i edukimit fetar është përgatitja e fëmijëve dhe të rinjve me edukatë fetare dhe etike, deri-diku subjekti i tij është edhe formimi i njeriut të së ardhmes brenda kornizës së përgjegjësive të tij.[3] Si rrjedhojë, edukimi fetar është i detyruar t'i cekë të gjitha çështjet që e interesojnë për realizimin e synimit të tij. Në këtë kontekst, me anë të kërkimeve që do të bëjë, ai duhet t'u ofrojë përgjigje të kënaqshme nevojave të jetës shoqërore, pyetjeve të hulumtuara nga opinioni publik, kërkesave e pritshmërive të shoqërisë dhe t'i zhvillojë ato duke i përditësuar. Gjithashtu nuk duhet harruar se edukimi fetar ka një ndikim të madh në lidhjen e nxënësve me shoqërinë e tyre dhe vlerat e saj gjatë përgatitjes së tyre për jetën.

1. Yavuz, Kerim, Günümüzde Din Eğitimi, *Çukurova Üniversitesi, İlahiyat* Fakültesi Yayınları, Adana, 1998:71.

2. Bartholomaus, Wolfgang, Einführung in die Religionspadagogik, Kösel Verlag, München, 1983:63.

3. Yavuz, 1998: 71,72.

Edukimi fetar, në një kuptim më të gjerë, ka zgjedhur si subjekt të tijin problemet, që kanë lidhje me vendin e fesë midis brezave të rinj e të pjekur dhe me jetesën e saj. Si rrjedhojë, subjekti i edukimit fetar duhet të ketë lidhje të ngushtë me detyrën që do të kryejë. Në bazë të këtyre përcaktimeve kuptohet se burimi i problemeve të vuajtura në zhvillimin fetar dhe etik të brezave të rinj është i lidhur me edukimin fetar dhe etik të tyre. Nga kjo kuptohet qartë se ajo çfarë duhet bërë, është studimi i përvojave të shkuara në lidhje me edukimin fetar dhe zhvillimi i një botëkuptimi që do mbartë të sotmen drejt së ardhmes dhe të ardhmen drejt përjetësisë.[4] E gjithë kjo sepse mësimdhënia dhe edukimi fetar, si një realitet gjatë gjithë procesit historik, ka qenë një fushë veprimtarie e pashmangshme dhe duket qartë se kjo gjendje, ashtu siç është sot, do të vazhdojë të jetë edhe nesër.

2. Qëllimi i edukimit fetar

Është e natyrshme që individi të përballet në jetën e përditshme të mbrujtur nga traditat me disa sjellje të caktuara dhe të ndikohet nga to. Këto sjellje, përkrah të qenët përvojat e para të jetës së tij personale dhe sociale, janë gjithashtu edhe elementet, që ndikojnë në formimin e bazës së jetës që do të jetojë më vonë. Zhvillimi i individit brenda edukimit dhe arsimimit formal duhet të mbështetet edhe me edukimin e dhënë brenda një plani dhe programi të caktuar.[5]

Edukimi fetar, i cili është në harmoni me arsimin e përgjithshëm, ndan të njëjtat qëllime me të, si në mbështetjen e formimit të sjelljeve të kërkuara, duke zhvilluar tek individi aftësitë dhe zotësitë që ai posedon, ashtu si dhe në ndihmesën e individit në harmonizimin me shoqërinë në të cilën jeton. Në këtë kontekst, arsimi dhe edukimi fetar konvergojnë në qëllime të përbashkëta si lëvrimin e individëve të aftë, që do t'i japin drejtim jetës së tyre, tolerantë ndaj besimeve, mendimeve dhe ideve të ndryshme, duke zhvilluar marrëdhëniet njerëzore, besnikë ndaj idealeve demokratike dhe të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre qytetare.

Nga individi pritet që të formojë lidhje midis edukimit fetar dhe jetesës së tij dhe t'i kthejë njohuritë e marra në sjellje në jetën sociale. Kjo është, deri-diku, pritshmëria sesa ka ndikuar arsimimi dhe edukimi fetar në jetën e përditshme. Nëse individi është kthyer në një njeri të aftë që t'u përgjigjet pozitivisht kërkesave të fesë ndaj tij, në rrjedhën e jetës, atëherë tek ai do të vërehen lehtësisht sjellje pozitive në marrëdhëniet e tij

4. Nipkow, Karl Ernst, Grundfragen der Religionspädagogik II, Gütersloher Verlagshaus, 1975:10.

5. Yavuz, 1998: 146.

personale dhe sociale me të tjerët, të ndikuara nga edukimi fetar.[6]

Mësimi i njohurive fetare në ambientet e shkollës synon sigurimin e mësimit drejt të fesë. Formimi i një mendimi fetar të shëndoshë varet nga kuptimi i saktë i fesë, sepse rrokja e saktë e përmbajtjes fetare është e lidhur ngushtë me përftimin e të vërtetave fetare, duke i kaluar nëpërmjet kullores së shkencës.[7] Është e rëndësishme, gjithashtu, që edukimi dhe arsimimi fetar të jenë të një niveli që mund të përballojnë nevojat shpirtërore të të rinjve dhe fëmijëve.

Qëllimi i dhënies së mësimit fetar është që njohuritë fetare të dhëna, si fillim, ta përgatisin individin për jetën, që do jetojë dhe ta ndihmojnë për këtë gjithmonë. Supozohet, që me mbështetjen e edukimit fetar, jeta që të jetohet do të jetë më fetare, etike, e shëndetshme, e lumtur, e qetë, e ekuilibruar dhe njerëzore.[8] Për këtë qëllim, për të siguruar që individi të sillet, ashtu si kërkohet edhe kur gjendet në shoqëri edhe në momentet kur është i vetëm, mund të përfitohet nga ndikimet dobiprurëse dhe frenuese të urdhrave dhe ndalesave të fesë.

6. Nipkow, 1975: II/179.
7. Schilling, Hans, Die Grndfunktion des Religionsunterrichts in der Schule von heute und morgen, in: Religionsunterricht zwischen gestern und morgen, 11-83, Verlag Ludwig Auer, Donauwörth, 1972: 26
8. Yavuz, 1998:149.

3. Nevoja për edukim fetar

Është e rëndësishme të përcaktohet se a janë të nevojshëm apo jo, feja, e si rrjedhojë besimi, si dhe edukimi dhe arsimimi fetar. Në lidhje me këtë shumë psikologë të psikologjisë së fesë dhe antropologë, theksojnë se feja dhe besimi janë një realitet në jetën e njeriut dhe plotësojnë një nevojë të rëndësishme të tij,[9] sepse te njeriu ekziston dëshira për të pranuar një qenie supreme, për t'u shprehur tek ajo dhe për t'u lidhur pas saj. Është vërejtur se ndjenja e besimit ekziston, që te njeriu i parë dhe përbën themelin e besimit fetar, pikërisht për këtë njeriu merr për bazë pikërisht këtë ndjenjë në jetesën e tij fetare.[10]

Një qasje historike ndaj besimit, që është shfaqja konkrete e fesë, do të na tregojë se ai ka qenë një nevojë e pashuar për shpirtin e njeriut dhe do të shihet se pa u plotësuar në një farë mënyre kjo nevojë, është e pamundur të shtypet.[11]

Rritja e numrit të njerëzve, të cilët kërkojnë zgjidhje ose lehtësim duke u mbështetur në fe, gjatë ose pas thatësirave, varfërive dhe fatkeqësive të jetuara në histori, ka lidhje të ngushtë me këtë nevojë.[12]

9. Yavuz, 1998: 127, 128.
10. Hamann, Bruno, Religiöse Erziehung als Unterrichtsprinzip. Lahn-Verlag, Limburg, 1970:21-23
11. Uplegger, Fritz, *Religionsunterricht-Mißerfolg und Wiederherstellung.* Gütersloher Verlagshaus Gerd Monh, Gütersloh, 1971:18.
12. Nipkow, 1975: III/21.

Dëshira e njeriut, i cili në kohë kur është i pafuqishëm e i dobët ndjen nevojë për siguri, për të mbrojtur veten dhe vazhduar ekzistencën e tij, është një nevojë e domosdoshme. Kjo është një gjendje që realizohet jashtë vetëdijes së njeriut dhe është e pamundur të shmanget.[13]

Besimi fetar, i cili ndodhet në çdo fazë të jetës së njeriut dhe është nga nevojat shpirtërore që duhen plotësuar, i ofron njeriut, që ka dëshirën e madhe për përjetësi të bëhet i përjetshëm.[14] Feja, e cila zotëron një pozitë të domosdoshme edhe për individin edhe për shoqërinë, do të vazhdojë ta ruajë rëndësinë e saj si dje ashtu edhe në të ardhmen si një realitet i njerëzimit.

Në botën e globalizuar të ditëve të sotme shoqëritë po marrin një trajtë më heterogjene dhe rëndësia e çështjeve si kultura e bashkëjetesës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dashuria, respekti, vëllazëria etj., është më e madhe në krahasim me të shkuarën. Është një nevojë e madhe trajtimi i këtyre çështjeve në mënyrë të detajuar duke i dhënë përparësi atyre dhe duke marrë parasysh kushtet aktuale.[15]

Është e qartë se zgjidhjet e kërkuara për të parandaluar dhunën dhe për të siguruar paqen e qetësinë, nëse nuk marrin në konsideratë elementin "njeri", nuk do të jenë të vetëmjaftueshme për të arritur rezultatin e synuar. Për sa kohë që njeriu nuk ka arritur të jetojë në harmoni me shoqërinë, probabiliteti i realizimit të sjelljeve të pritura prej tij është shumë i vogël. Themelimi i gjykatave dhe hapja e burgjeve nuk është një rrugë mjaftueshëm efektive për të zgjidhur problematikat që kanë në qendër njeriun. Përvoja njerëzore tregon se përpjekja më e rëndësishme dhe më efikase për sigurimin dhe mbrojtjen e paqes dhe qetësisë është edukimi, sepse edukimi synon ta trajnojë njeriun, i cili mund ta sigurojë paqen e kërkuar dhe mund të marrë nën kontroll tendencat e tij të dhunshme, kësisoj edukimi fetar është ndihmësi më i fuqishëm i edukimit.[16]

Edukimi fetar i cili ushqehet nga feja, është një disiplinë e fuqishme, që zotëron përmbajtjen e mjaftueshme për sigurimin e paqes dhe qetësisë. Në periudhat kur feja studiohej drejt dhe përcillej me mjetet e duhura arrinte të realizonte harmoninë midis njerëzve dhe ishte kthyer në garancinë e paqes shoqërore dhe të unitetit e bashkimit. Përkrah mbrojtjes së të drejtave dhe lirive

13. Yavuz, 1998:130.
14. Yavuz, 1998:129.
15. Aydın, Muhammed Şevki, Açık Toplumda Din Eğitimi (Yeni Paradigma İhtiyacı), Nobel Yayınları. Ankara, 2011: VII.
16. Yılmaz, Hüseyin, ***Örgün*** ve Yaygın Eğitim Kurumlarında Barış Eğitimi. Mustafa Köylü (Ed.), Din Eğitiminde Çağdaş Konular, Dem Yayınları, İstanbul, 2012:226.

themelore, edukimi fetar luan një rol të rëndësishëm edhe në mbizotërimin në shoqëri të vlerave si drejtësia, dialogu dhe toleranca. Përcjellja e këtyre idealeve tek individët me anë të edukimit fetar në mënyrë të drejtë, kontribuon shumë në frenimin e prirjeve negative, që burojnë nga arsye si turbullira sociale, padrejtësia dhe rrënimi moral.[17]

Edukimi fetar nevojitet gjithashtu në përcjelljen e vlerave fetare, që zotëron shoqëria dhe në kulturën që formohet nga këto vlera te brezat e rinj.

4.Rëndësia e edukimit fetar

Përcjellja e besimit fetar, i cili është një realitet historik dhe ka arritur deri në ditët tona me anë të edukimit, është një çështje e rëndësishme. Feja, e cila zotëron një fuqi të madhe informimi dhe drejtimi në përgatitjen e njeriut për jetën, ka qenë në marrëdhënie të ngushtë me jetën e tij. Meqë feja i përfton njeriut njohuri dhe veçori të pasura dhe të shumëllojshme, gjatë gjithë historisë asaj i është dhënë vend në arsim dhe nevoja për mbështetjen e saj është ndjerë kurdoherë.[18] Masat ndëshkimore të fesë kanë një forcë efektive në realizimin e përgjegjësive sociale të individëve që përbëjnë shoqërinë. Ajo që ka rëndësi këtu është që njeriu ta mësojë dhe kuptojë drejt fenë dhe ta zbatojë atë në jetën e tij. Ky rezultat mund të arrihet vetëm me anë të një arsimimi fetar të shëndetshëm dhe të ekuilibruar.

Ndikimet e fesë është e mundur të vërehen në jetën e një njeriu, i cili e praktikon dhe zbaton fenë dhe urdhrat e saj me dëshirën e tij, sepse një besimtar vepron brenda kornizës së përcaktuar nga besimi dhe përpiqet ta rregullojë jetesën e tij sipas rregullave fetare dhe etike. Vlerat fetare, të cilat nuk e braktisin individin, sido që të jenë kushtet, do ta shoqërojnë atë kurdoherë, në gëzim dhe në hidhërim.[19] Individi, i cili fillon të ndjejë zërin e besimit në ndërgjegjen e tij, mundohet t'u shmanget veprave, që nuk përputhen me shpirtin e fesë. Feja, e cila zotëron një vend të rëndësishëm në jetën e individit, ngrihet me kalimin e kohës në një pozicion, që drejton sjelljet e tij. Fakti që të gjitha pikat e radhitura më sipër mund të realizohen me anë të edukimit fetar nxjerr në pah rëndësinë e edukimit fetar.

Një nga qëllimet e veprimtarisë së edukimit është pajisja e individit me një vullnet të fortë, duke i përftuar atij identitet dhe karakter. Edhe feja, gjithashtu, e cila është vlera më e madhe për njeriun, synon formimin e tij si një individ me vullnet të fortë, duke i përftuar atij identitet dhe karakter, duke filluar

17. Yılmaz, 2012:226.
18. Yavuz, 1998:60, 61.
19. Merkert, Rainald & Klassen, Theodor F. Didaktik für praktische Theologen, Benziger Verlag, Zürich-Köln, 1970:22.

që në fëmijërinë e tij. Feja kryen një funksion të rëndësishëm në përftimin e këtyre veçorive të individit. Me anë të edukimit, fëmijët, pavarësisht natyrave të tyre të ndryshme, mund të fitojnë shprehi të dobishme për veten e tyre dhe për shoqërinë në të cilën jetojnë.[20]

Edukimi fetar, i cili është përgjegjës për edukimin e individit në pikëpamjen fetare, gjatë përgatitjes së tij për jetën nis nga bazat fetare dhe nga njohuritë teorike rreth tyre. Edukimi fetar, i cili zotëron një përmbajtje, që zgjerohet gradualisht brenda një plani dhe programi të përcaktuar, zë një vend të rëndësishëm në përgatitjen e fëmijëve dhe të rinjve në aspektin fetar dhe etik.[21] Si rrjedhojë, mësimi i përgjegjësive morale, të cilat janë të dobishme gjatë gjithë jetës, është një çështje, që nuk duhet neglizhuar, sepse "nxitja e së mirës dhe shmangia e së keqes" është një parim i pranuar gjerësisht edhe në aspektin fetar. Duke u nisur nga ky parim, pasi përcaktohen sjelljet etike, që sipas fesë duhen kryer ose duhen shmangur, pritet që personi t'i plotësojë ato. Kështu që, mësimi fëmijëve ç'është e drejta dhe e gabuara në mënyrën më të thjeshtë dhe arritja e dallimit midis tyre, është një detyrë e të rriturve dhe arsimtarëve. Duhet punuar për realizimin e përvetësimin nga ana e fëmijëve të njohjes të së mirës dhe së keqes dhe me ndihmën e ndërgjegjes, kthimit të saj në një dimension të natyrës së tyre.

Gjithashtu, gjendet një raport shumë i ngushtë midis besimit të individit fetar dhe jetesës etike të tij. Kështu që mund të themi se jetesa fetare dhe etike do të ketë pa dyshim ndikim pozitiv për një jetë më të rregullt, të shëndetshme dhe të lumtur personale e shoqërore.[22] Nxitja e edukimit fetar drejt sjelljeve etike mund të konsiderohet si një tregues i rëndësishëm, që feja i jep jetesës së individëve në unitet e harmoni brenda shoqërisë.

20. Yavuz, 1998:62.
21. Yavuz, 1998: 63.
22. Nipkow, 1975: III/131

Bibliografia

Aydın, Muhammed Şevki, *Açık Toplumda Din Eğitimi (Yeni Paradigma* İhtiyacı*)*, Nobel Yayınları. Ankara, 2011.

Bartholomaus, Wolfgang, *Einführung in die Religionspadagogik*, Kösel Verlag, München, 1983 (përkth. A. **Çelebi**).

Hamann, Bruno, *Religiöse Erziehung als Unterrichtsprinzip*, Lahn-Verlag Limburg, 1970, (përkth. A. Çelebi).

Merkert, Rainald. & Klassen, Theodor F., *Didaktik für praktische Theologen*, Benziger

Verlag, Zürich, Köln, 1970, (përkth. A. Çelebi).

Nipkow, Karl Ernst, *Grundfragen der Religionspädagogik* I-II-III, Gütersloher

Verlagshaus, 1975, (përkth. A. Çelebi).

Schilling, Hans, Die Grndfunktion des Religionsunterrichts in der Schule von heute

und morgen, in : *Religionsunterricht zwischen gestern und morgen, 11-83*, Verlag Ludwig Auer, Donauwörth, 1972, (përkth. A. Çelebi).

Uplegger, Fritz, *Religionsunterricht- Mißerfolg und Wiederherstellung*, Gütersloher

Verlagshaus Gerd Monh, Gütersloh, 1971, (përkth. A. Çelebi)

Yavuz, Kerim, *Günümüzde Din Eğitimi*, *Çukurova Üniversitesi*, *İlahiyat* Fakültesi Yayınları, Adana, 1998.

Yılmaz, Hüseyin, **Örgün** *ve Yaygın Eğitim Kurumlarında Barış Eğitimi,* Mustafa Köylü (Ed.), Din Eğitiminde Çağdaş Konular, 225-246, Dem Yayınları, İstanbul, 2012

Rëndësia e dialogut ndërfetar në marrëdhëniet ndëretnike të shoqërisë së Maqedonisë

Msc. Sadije Gafuri, Tetovë, Maqedoni

Abstrakt

Në ditët e sotme po përballemi me probleme që kërcënojnë ekuilibrin e shoqërisë. Sot shumë çështje siç është shkenca, tregtia dhe njeriu, në përgjithësi, janë kthyer në çështje globale. Për këtë arsye edhe dialogu është bërë i domosdoshëm.

Mirëpo një nga arsyet e kësaj situate rrjedhin nga fakti se njerëzit nuk janë mjaftueshëm të vetëdijshëm për vlerat e tyre, sidomos ato fetare, ku sipas një fjale të urtë njeriu është armik i asaj që nuk e di. Veçanërisht, ne kemi neglizhuar disa nga vlerat jetësore siç janë: toleranca, mirëkuptimi i ndërsjellë, marrëdhëniet bashkëpunuese, dialogu ndërfetar dhe ndërkulturor, të cilat kanë një rol jetësor në arritjen e një bashkëjetese afatgjate në shoqëri.

Ky punim është përgatitur për të informuar më gjerë myslimanët në përgjithësi, nxënësit e Medreseve dhe studentët e Departamentit të Shkencave Islame gjithashtu edhe pjesëtarët e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë. Përveç kësaj çdokush që ka interes për informacion rreth kësaj teme mund të përfitojë nga ky punim.

Në pjesën e parë të këtij studimi do të analizohet konteksti konceptual i dialogut. Do të shpjegojmë se çfarë është dialogu ndërfetar dhe cilat janë disa nga spekulimet që janë bërë mbi të. Ndërsa në pjesën e dytë do të flitet më tepër për dialogun dhe bashkëjetesën në Maqedoni dhe se si lindi harmonia ndërfetare në shoqërinë maqedonase.

Së fundmi, do të përpiqemi të sjellim në vëmendje faktin se bashkëjetesa fetare është një vlerë jo vetëm e shqiptarëve të Maqedonisë por përkundrazi është një karakteristikë e shoqërisë në përgjithësi, duke përfshirë edhe ata të diasporës, më konkretisht e shohim edhe duke e ilustruar me përfundimet e një ankete me afro tre qind e pesëdhjetë pjesëmarrës.

Fjalët Kyçe: *Shoqëri, dialog, bashkëjetesë, dialogu ndërfetar, harmoni.*

Hyrja
Tema e studimit

Historia e njerëzimit është dëshmitare se grindjet dhe zënkat mes besimeve të ndryshme nuk kanë sjellë gjë tjetër veçse dhimbje, urrejtje dhe mëri. Arsyeja më e madhe e kësaj mosmarrëveshjeje është fakti se nuk njihen aq sa duhet me njëri-tjetrin. Hapi i parë për sigurimin e bashkëjetesës në paqe dhe harmoni është njohja reciproke. Njerëzit duke komunikuar me njëri-tjetrin i kuptojnë më mirë ndjenjat dhe mendimet e tyre. Dhe, aq sa njihen e kuptohen me njëri-tjetrin ndërtojnë ura paqeje mes tyre për t'i zgjidhur problemet e përbashkëta. Si pasojë, në ditët e sotme, kur marrëdhëniet me njëri-tjetrin janë tepër të shpeshta, edhe komunikimi apo dialogu ndërmjet tyre është një domosdoshmëri.

Dialogu është biseda mes dy apo më shumë personash. Ndërsa, ai fetar është komunikimi apo biseda e njerëzve me besime të ndryshme që bëhet duke synuar zgjidhjen e problematikave të përbashkëta. Dialogu në ditët e sotme është ndër temat më aktuale dhe të përfolura mes njerëzve, sidomos bazat fetare të tij: në Kur'an dhe në Sunnet (në Traditën Profetike). Gjithashtu, një tjetër pikë e rëndësishme është edhe toleranca fetare e shoqërisë së Maqedonisë ndër shekuj. Vlerë kjo tepër e rëndësishme për kombin dhe bashkatdhetarët tanë, të cilët, megjithëse shpeshherë janë shtypur apo diskriminuar, gjithmonë kanë qenë të mendimit se rruga më e drejtë është toleranca dhe dialogu ndërfetar.

Për këtë arsye, pjesën e parë të këtij punimi do të analizohet konteksti konceptual i dialogut në përgjithësi dhe dialogut ndërfetar në veçanti. Pas shpjegimit të dialogut si fjalë dhe si koncept në pjesën e dytë do të analizohet dialogu ndërfetar në Maqedoni. Së fundmi, pas një vështrimi të përgjithshëm të dialogut ndërfetar në popullatën maqedonase do të paraqiten edhe rezultatet e një ankete të realizuar me pjesëmarrjen e afro 350 personave.

Qëllimi i këtij punimi është qartësimi i konceptit dialog ndërfetar, theksimi i domosdoshmërisë së tij për paqen botërore, si dhe kontributi, që ka dhënë shoqëria në Maqedoni për ruajtjen e kësaj vlere.

Konteksti konceptual

Vendi që zënë konceptet në komunikimin dhe në kuptimin e ndërsjellë të njerëzve është tejet i rëndësishëm. Kushti i të kuptuarit drejt njëri-tjetrin është përcaktimi i drejtë i kontekstit kuptimor të koncepteve, arsyeja se përse këta njerëz, të cilët kanë vlera të panumërta të përbashkëta me njëri tjetrin, diskutojnë ose debatojnë

rreth dialogut është sepse ata nuk kanë një konceptim të njëjtë rreth këtij termi. Duke u nisur nga ky fakt, në pjesën e parë do të analizojmë kuptimin e dialogut.

I.2. Shtjellimi i termit dialog në aspektin islam

Sipas fjalorit, fjala dialog ka ardhur nga frëngjishtja, përveç kuptimeve që ka në gjuhët perëndimore; ajo do të thotë, "të kuptohesh me njëri-tjetrin", "të përshtatesh me studimet që janë bërë në këtë rrugë", ndërsa sipas një kufizimi tjetër ai është "dialogu që bëhet mes dy apo më shumë personave mbi tema të caktuara, njohja mes tyre si dhe diskutimi i pikave të përbashkëta". Si një proces komunikimi, dialogu është një përpjekje për t'u kuptuar dhe për t'u sqaruar, si dhe, më tepër se sa të mundësh palën përballë, dialogu është një përpjekje për të mësuar diçka të re dhe për ta ndarë atë me të tjerët. Në një kuptim më të gjerë dialogu është rruga ose mënyra se si të kuptohen ose si të komunikojnë njerëz të racave dhe kulturave të ndryshme sipas disa kritereve të civilizuara. Ndërsa, sipas aspektit, fetar dialogu është bashkëpunimi dhe diskutimi i pjesëtarëve të feve të ndryshme në një atmosferë paqësore pa u përpjekur të imponohet mendimi apo besimi.[1]

Përveç kësaj dialogu ka edhe dimensione të tjera, siç është dialogimi me vetveten dhe me universin. Kjo nënkuptohet nga shprehja filozofike, e cila citon se filozofia është bisedë e shpirtit me vetveten, ose çdo bisedë filozofike është bisedë me vetveten.[2]

Mirëpo, meqenëse kjo është një bisedë e qëllimshme dhe me një detyrë të caktuar, atëherë çdo gjë që diskutohet duhet gradualisht të shfaqet haptazi (si material, si kontekst dhe si pozicion), kështu që, "bota e jashtme" pak nga pak internalizohet apo shndërrohet në botë të brendshme". Kjo arrihet atëherë kur bota e jashtme dhe ajo e brendshme, e cila është në dialogim me të, të fillojë të flasë. Në këtë drejtim, aftësia imanente për dialogimin e universit nuk bën asnjë përjashtim dhe as që pranon ndonjë kategori tabu.[3]

a. Dialogu Ndërfetar në Kur'an

Burimet kryesore të fesë Islame janë dy: Kur'ani dhe Suneti, tradita e profetit Muhamed a.s. Në të dyja këto burime, me normat dhe rregullat e tyre, trajtohet në mënyrë reale çështja e tolerancës dhe lirisë së besimit. Allahu në Kur'an jo vetëm

1. Ayduz, Davut, "Tarih Boyunca Dinlerarasi Diyalog", 3. Basim, Istanbul: Isik Yayinlari, 2005:17.
2. Muhiq, Ferid, "Jazikot na Filozofijata", Kultura, Shkup, 1995:144.
3. Po aty, 143.

që kërkon tolerancë, mirëkuptim, sjellje e qëndrim korrekt ndaj pjesëtarëve të besimeve të tjera, por edhe i njeh pasuesit e Judaizmit dhe Krishterimit si "Ithtarë të librit".[4]

Në lidhje me dialogun ndërnjerëzor, ndërqytetërues apo ndërfetar në Kur'an gjenden ajete të shumta, të cilat i drejtohen problematikës në fjalë nga këndvështrime të ndryshme, por edhe nëse i kthehemi burimit të dytë në Islam, Sunetit të profetit Muhamed a.s. nuk do të hasim diçka të kundërt me atë që u përmend në Kur'an. Për të trajtuar çështjen e dialogut në aspektin islam, le ti hedhim një sy Kur'anit se ç'na thotë në lidhje me këtë:

"Thuaj (o i dërguar): O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij shok, të mos konsiderojmë njëri tjetrin zotër pos Allahut! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë (besuam një Zot)!"[5]

Po ti hedhim një sy komentimit të ajetit, komentuesi i njohur Elmalili M. Hamdi Yazir, thotë se çdo mosmarrëveshje ose kundërshtim zhduket vetëm me anë të marrëveshjes dhe ndërgjegjes së vërtetë në respektimin e vetëm një Zoti, e që është Allahu xh.sh. Kështu që në atë rast nuk mund të mbizotërojë mendimi i asnjërit, përveç fjalës së Allahut. Përveç Allahut të mos pranojmë Zot tjetër siç bënë të krishterët, të cilët Isain a.s e pranojnë si Zot, por ta pranojmë vetëm si rob dhe të dërguar të Allahut. Gjithashtu edhe papët, mbretërit apo udhëheqësit e tjerë t'i pranojmë si të tillë, çdo njërin prej tyre ta pranojmë në bazë të adhurimit të tij ndaj Allahut. Kur "Ehli Kitabët (Ithtarët e librave)" e kanë pyetur Profetin a.s. ai u përgjigj: "A nuk u besoni fjalëve të Papës dhe fjalëve të të tjerëve vetëm se ato fjalë janë të tyre? Ai pranim pra s'është gjë tjetër vetëm se pranimi i tyre si Zot".[6]

Kur'ani pohon se sikur të donte Zoti, do u imponohej njerëzve, që të zgjidhnin një fe të vetme, një besim të vetëm, një ngjyrë dhe një gjuhë të vetme. Por Zoti nuk e ka dashur diçka të tillë. Përkundrazi, Ai deshi dhe i krijoi të ndryshëm në fe, besime, ngjyra dhe gjuhë. Ai ka dashur, që këto dallime të vazhdojnë gjer në ditën e fundit të jetës së universit.[7]

4. Kruja, Genti, "Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar", Prizmi, Tiranë, 2008:91.

5. Kur'an, përkth. Sherif Ahmedi, Al Imran, Medine, 1987:64.

6. Elmalılı M.Hamdi Yazır,Hak Dini Kur'an Dili,v.2,Stamboll,pa vit botimi:348.

7. http://ardhmeriaonline.com/artikull/article/fjala-e-shejhut-te-ezherit-ne-konferencen-me-titull-njohja-e-qyteterimeve-2/#.VËsQltLtmko.

"Sikur të dëshironte Zoti yt, do ti bënte njerëz të një feje (por nuk dëshiroi, Ai e di pse). Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete)"[8]

Një tjetër ajet që mbështet idenë se diversiteti racor, kulturor dhe i ngjyrave nuk është diçka që duhet të luftohet por përkundrazi është një pasuri e madhe që duhet vlerësuar:

"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e Allahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë."[9]

Këtu theksohet edhe arsyeja se përse Allahu na ka krijuar në popuj e raca të ndryshme: Që të njihemi më mirë me njëri-tjetrin. Sikur e gjithë bota të ishte një popull i vetëm njohja mes njerëzve do te ishte shumë e vështirë. Që të mundësohet realizimi i këtij dialogu ndërfetar, ndërkulturor apo ndërmjet racave të ndryshme, ne jemi krijuar në kombe të veçanta. Kur'ani nga myslimanët jo vetëm që kërkon tolerancë, mirëkuptim, sjellje dhe qëndrim korrekt ndaj pjesëtarëve të besimeve të ndryshme, por ai shkon edhe më larg se toleranca sa që kalon shkallën e njohjes, e cila është edhe shkalla më e lartë e tolerancës, garanci për bashkëjetesë.[10]

8. Kur'an, Hud, 11/118.
9. Kur'an, Huxhurat, 49/13
10. Kruja, Genti, 2008:92.

b. Dialogu Ndërfetar në traditën profetike

"*Atij të cilit i mungon butësia i mungojnë të gjitha të mirat*"[11] (Transmeton Muslimi). Në histori ka shumë fjalë të shkruara, qoftë më herët, qoftë më vonë, por qëndrimet tolerante të profetit Muhamed a.s. ndaj myslimanëve të tjerë, kuptohet që këto fjalë bazohen në praktikën e Muhamedit a.s., i cili burim kryesor të tijin e ka pasur Kur'anin dhe Sunetin. Në një hadith të profetit a.s. thuhet:[12]

"Çdo kush që pa të drejtë e mundon një grup jomyslimanësh, unë jam armiku i tij. Ndërsa unë kujt i bëhem armik ai edhe ditën e gjykimit do të jetë armik me mua".[13]

Nëse do hedhim një sy në jetën e Krenarisë së Njerëzimit a.s. do shohim se jeta e tij ishte e tëra e drejtuar në orbitën e tolerancës dhe të mirëkuptimit. Këtë e shohim shumë mirë edhe në qëndrimin e tij, të cilin e kishte mbajtur edhe përpara Ebu Sufjanit, i cili e persekutoi atë gjatë gjithë jetës së tij, megjithëse edhe më tutje ai vazhdonte ta shprehte atë se ende nuk ishte në bindje të plotë në lidhje me Islamin, mirëpo përtej tërë atyre veprimeve ai a.s. vazhdonte të thoshte: "Ata që gjejnë strehë në shtëpinë e Ebu

11. Imam Neveviu, Rijadus-Salihin.Hadithi, 643.
12. Nesimi, Qani, "Dialogu Obligim Hyjnor", Shkup, 2005:48.
13. Hadith, po aty 48.

Sufjanit, janë të sigurt, ashtu siç janë të mbrojtur ata që gjejnë strehë në Qabe." Pavarësisht asaj që në respekt të strehës dhe mbrojtjes së sigurt, shtëpinë e Ebu Sufjanit e përmend përkrah Qabes. Përveçse ishte urdhëruar të mbështetej në tolerancë dhe dialogu të ishte në themel të misionit të tij, Profeti a.s. u ishte drejtuar edhe atyre me të cilët kishte gjëra të përbashkëta siç ishin popujt e librit (hebrenjtë dhe të krishterët):[14]

"Thuaju: O ithtarë të librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: Se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do ti shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!"[…][15]

Toleranca dhe mirëkuptimi kanë qenë hapa të pandashëm të Profetit a.s. Një ndër treguesit më të qartë të një tolerance të pashoq është edhe shembulli i mëposhtëm, i cili njihet edhe si fjalimi i lamtumirës së Profetit:

"O njerëz, dëgjoni ç'do t'ju them, sepse nuk e di se a do të takohemi në këtë vend pas këtij viti"

"Me të vërtetë, gjaku juaj, pasuria dhe nderi juaj janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë, në këtë muaj dhe në këtë vend. Të gjithë jeni pasardhës të Ademit, e Ademi është prej dheut. Nuk është i pranueshëm kurrfarë dallimi mes jush. Nuk ka përparësi arabi ndaj jo arabit, as joarabi ndaj arabit. I ziu nuk është më i mirë se i kuqi, as i kuqi më i mirë se i ziu, përveçse në devotshmëri.

Jini të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit. Ju jeni vëllezër e motra në mes vete. Bëhuni të drejtë dhe ruajeni shpirtin tuaj nga padrejtësia e dhuna."[16]

I.3. Disa keqkuptime mbi dialogun ndërfetar

Dialogu ndërfetar nuk është prodhim i një feje të re. Dialogu ndërfetar nuk është tentativa për të prodhuar një fe të re, duke i bashkuar ato ekzistente, përkundrazi dialogu ndërfetar është një marrëveshje ndërmjet feve të ndryshme për të zgjedhur problemet e përbashkëta.[17]

Aktivitet misionari. Dialogu ndërfetar nuk është një aktivitet misionari, ku ka lloj-lloj mënyrash për të përhapur fenë, mirëpo duke u nisur nga ajo se dialogu ndërfetar nuk është gjë tjetër vetëm se një prezantim, atëherë ky prezantim në vetvete përfshin një kuptim dhe informim të ndërsjellë.

Është e vërtetë që secili person do që t'u tregojë të tjerëve për fenë e tij, t'ju flasë për besimin e tij, ose dëshiron që të tjerët të kthehen në besimin e tij, por, në dialogun ndërfetare, kjo nuk është tematika

14.Gylen, Fethullah, "Dashuri dhe Tolerancë", Prizmi, 2012:104.
15. Kur'an, Ali Imran, 64.
16. Kruja, Genti, 2008:94.
17. Ayduz, f. 25.

kryesore. Njerëzit mund ta bëjnë të njohur fenë e tyre tek të tjerët me anë të veprimeve të cilat ata i kryejnë dhe kjo është e pashmangshme. Megjithatë nuk është ky qëllimi kryesor i dialogut ndërfetare, por, siç e theksuam edhe më lart, është thjesht gjetja e zgjidhjes së problemeve të përbashkëta të cilat shqetësojnë si myslimanët ashtu edhe të krishterët edhe të tjerët.[18]

Nuk është monolog ku flet vetëm njëra palë. Dialogu ndërfetar nuk është një monolog ku flet vetëm njëra palë dhe ku vetëm ajo duhet të dëgjohet, apo vetëm ajo duhet të kuptohet nga ana tjetër, përkundrazi dialogu ndërfetar përfshin shprehjen e ideve dhe mendimeve të të dyja palëve, dëgjimin e secilës prej tyre dhe mirëkuptimin e përbashkët.

Nuk është një polemikë mes njerëzve të besimeve të ndryshme. Dialogu ndërfetar nuk është një polemikë mes pasuesve të feve të ndryshme. T'i hedhim një sy se çfarë është polemika: polemika është mos barazia dhe përjashtimi mes palëve në këtë aspekt.[19]

I.4. Dobitë e dialogut ndërfetar

Dobitë e dialogut ndërfetar janë të shumta, disa prej tyre janë parë në të kaluarën dhe disa prej tyre i shohim edhe në ditët e sotme dhe besojmë se shumë dobi të dialogut ndërfetar do vazhdojnë të shihen edhe në të ardhmen. Disa nga këto dobi do mundohemi t'i radhisim në këtë mënyrë: Një ndër karakteristikat kryesore të dialogut ndërfetar është edhe "takimi i drejtpërdrejtë" i palëve të ndryshme ose arritja e mundësisë për të jetuar bashkë, është shumë e kuptueshme që njerëzit, të cilët kanë dialog të vazhdueshëm, e kanë më të thjeshtë bashkëjetesën, sepse kjo eksperiencë është shumë e vyer për to dhe për bashkëjetesën në mënyrë të paqme.

Një tjetër avantazh, që dialogu ndërfetar ua siguron të dyja palëve, është realizimi i kuptimit të ndërsjellë, sepse ata vetëm me anë të dialogut do të arrinin që t'i kalonin pengesat mes tyre dhe dialogu në këtë aspekt nuk është zbutja e mendimeve të secilit, por thjesht është sjellja e tyre siç janë ata zakonisht pa ndryshuar dhe duke e pranuar palën përballë, statusin e palës përballë.

Dialogu ndërfetar gjithashtu thekson paqen mes të dyja anëve, në rast se mes të dyja palëve nuk do të ekzistonte kjo paqe, atëherë nga vetë fakti del që të mos kishte paqe as mes kombeve, dhe në të njëjtën mënyrë nëse nuk do të kishte dialog mes feve të ndryshme atëherë as paqja nuk do të ekzistonte mes tyre. Dialogu ndërfetar ju siguron të dyja anëve që të jenë më njerëzorë, sepse ata (përfaqësuesit e feve) duhet të kujdesen për pasuesit e fesë së tyre që ata të edukohen me një tolerancë fetare, duke qenë më të kujdesshëm ndaj veprimeve të ndërmarra kundrejt palës tjetër, në mënyrë që të ketë dashuri, paqe dhe drejtësi universale ndaj tyre.

18. Po aty, 26.
19. Po aty, 27/28.

Dialogu gjithashtu ul tensionet edhe përgatit themelet për një shoqëri, e cila do të jetojë në paqe. Me anë të takimeve që bëhen në emër të dialogut ndërfetar shohim sëmundjet e kohës ashtu siç janë: pasuria e tepërt, varfëria e tepërt, luksi, shëndeti, sëmundja si dhe shumë çekuilibrime të tjera mund të zgjidhen vetëm me anë të dialogut, bashkëpunimit dhe me një përpjekje e cila shfaqet nga të dyja palët për gjetjen e zgjidhjes së këtyre problemeve. Me anë të dialogut ndërfetar pajtohen përfaqësuesit e besimeve të ndryshme dhe kjo po arrin deri aty sa të sigurojë paqe jo vetëm te përfaqësuesit e besimeve, por arrihet paqja në mbarë shoqërinë.[20]

II.1. Si lindi harmonia ndërfetare në Maqedoni

"Çdo gjë që është vepruar në emër të njeriut është kundër tij, kurse çdo gjë që është vepruar në emër të Zotit është në të mirë të njeriut."[21]

Bashkëjetesa ndërfetare në Maqedoni është më e pranishme në shoqërinë civile të vendit tonë, se sa bashkëjetesa ndërfetare në institucionet dhe politikën e shtetit.

Me anë të konferencës një ditore të mbajtur me 19 nëntor të vitit 2011, organizuar nga Forumi Rinor Islam, të përkrahur nga Sekretariati për Implementimin e marrëveshjes Kornizë pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me temë "Të rinjtë dhe toleranca ndëretnike dhe ndërfetare në Republikën e Maqedonisë", është deklaruar se, përkundër të gjitha sfidave, problemeve, provokimeve dhe manifestimeve të papëlqyeshme që paraqiten në raste të ndryshme, shkalla e tolerancës në mesin e popullatës në Republikën e Maqedonisë mund të themi se është në nivel të konsiderueshëm.

Shqiptarët për nga vendi ku jetojnë kanë një pozitë gjeostrategjike në aspektin politik, social, kulturor, ideologjik apo fetar. Edhe gjatë historisë, si edhe sot, shqiptarëve detyrimisht u ka rënë në hise që të marrin pjesë në zënkat, mosmarrëveshjet, skizmat apo në luftërat për interesa me fuqive të ndryshme.[22] Kështu ka qenë rasti gjatë sundimit të fuqive të mëdha si Perandoria Romake, Perandoria Bizantine, Perandoria Osmane, Shteti Serb,(;) i njëjtë ka qenë rasti edhe në periudhën e dominimit të ideologjisë komuniste, kështu është rasti edhe sot kur duhet të dominojë, sipas disave lindja, e sipas disave perëndimi, Evropa apo Amerika etj.; i njëjtë është rasti edhe me zënkat skizmatike se dominuese

20. Ayduz, f. 29-30-31.

21. Rešid, Hafizović, "Myslimani u dijalogu s drugima i sa sobom", el-Kalem, Sarajevë, 2002:31.

22. http://jusufzimeri.com/?p=2179/05/2015.

në Ballkan - gjegjësisht në tokat shqiptare - do të jetë Kisha Lindore Ortodokse apo ajo Perëndimore Katolike, ose sipas shprehjeve të sotme, në këto toka do të dominojë feja islame apo Krishterimi - Katolicizmi; sikurse shprehen një numër i caktuar politikanësh dhe intelektualësh shqiptarë se ne kemi qenë të krishterë dhe duhet të kthehemi përsëri te ajo fe perëndimore dhe evropiane, kurse duhet ta lëmë Islamin se ajo është fe lindore aziatike etj. Në fakt, që një njeri të ketë mundësi të thotë se Krishterimi është fe perëndimore, ai, sipas mendimit tim, duhet të shpërngulet në indi, sepse për indianët, Jerusalemi - vendi ku ka vepruar Isai (Jezu Krishti) - është perëndim, kurse nga ky vend ku ne jetojmë Jerusalemi është lindje. Kurse ata që prej këtij vendi ku jetojmë i thonë Krishterimit, e cila është lindore, fe perëndimore e mashtrojnë veten dhe i gënjejnë të tjerët. Pra, duke u nisur nga ky fakt, shqiptarët jetën e tyre shpirtërore dhe veprimet e tyre i kanë bazuar në botëkuptimet fetare dhe metafizike. Ata me anë të kësaj kanë shprehur dhe kanë vënë në dukje, gjegjësisht kanë manifestuar qëndrimet e tyre tolerante.[23]

Shqiptarët, të cilët jetojnë në Shqipëri, Kosovë si shtete shqiptare, në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Greqi si pjesë të ndara të unitetit kombëtar dhe në diasporë si emigrantë dhe kurbetçinj, janë një popull ku zënë vend dy fetë më të mëdha monoteiste, Islami dhe Krishterimi (Katolicizmi dhe Ortodoksizmi).

Në fillim të shekullit XX shqiptarët, ku pjesën dërmuese të tyre në të katër vilajetet, i Shkodrës, Kosovës, i Manastirit dhe i Janinës, e kanë përbërë myslimanët me 1.305.080, katolikët me 109.592 dhe ortodoksët me 232.020. Po ashtu edhe sot shqiptarët përbëhen prej myslimanëve me 70 %, katolikëve me 10 % dhe prej ortodoksëve me 20 %, ku pjesën dërmuese të tyre e përbëjnë të parët. Pra, këto fe bënë që shqiptarët të kenë botëkuptime të ndryshme, po madje edhe të kundërta, por jo edhe armiqësore, në aspektin fetar. Edhe pse nga shumë rryma të ndryshme, me qëllime të caktuara propagandistike, shqiptarët janë quajtur grekë, turq, serbë, latinë, ata përsëri kanë arritur që të mbrojnë unitetin e tyre kombëtar, që deri më tash të mos bëhet pre e luftërave fetare, për të cilën mendoj se rol të madh luan botëkuptimi fetar islam.[24]

Kjo për arsye se shumica e shqiptarëve janë myslimanë dhe detyrimisht përfundojmë ose dalim

23. Nesimi, 2005:224.

24. Muhiq, 1995:19.

në konkluzionin se, në të shumtën e rasteve, shumica është ajo që mund të destabilizojë ose të mbajë të qetë një vend dhe një popull. Meqenëse shumica e shqiptarëve janë myslimanë, atëherë shqiptarët myslimanë janë faktori kryesor paqeruajtës. Kuptohet se, këtu nuk duhet harruar edhe kontributi i komuniteteve të tjera fetare, edhe pse ai është më i vogël në krahasim me të parët. Kjo shihet edhe në shprehjet e intelektualëve shqiptarë të kohës së iluminizmit dhe të fillimit të shek. XX, të cilët janë shprehur kryekëput për një unitet kombëtar, duke dashur që të mbrojnë popullin nga divergjencat fraksionale dhe të grupimeve që mund të dominonin gjatë asaj kohe në popull. Prandaj shprehjet e tyre në disa raste kanë qenë pak më të buta e në disa raste më të ashpra.[25]

Kushtetuta, ligjet e tjera dhe politika e mbrojnë lirinë fetare dhe, në përgjithësi, Qeveria e ka respektuar lirinë fetare në ligj dhe në praktikë. Gjatë periudhës së raportimit nuk ka pasur ndryshim të gjendjes, në aspekt të respektimit të lirive fetare nga ana e Qeverisë. Shteti ka një sipërfaqe prej 25,333 km^2 dhe 2.1 milionë banorë. Dy grupet kryesore fetare në vend i takojnë Krishterimit Ortodoks dhe Islamit. Përafërsisht 65 për qind e popullatës janë ortodoksë maqedonas dhe 32 për qind janë myslimanë. Grupet e tjera i përfshijnë katolikët, anëtarët e besimeve të ndryshme protestante dhe hebreje.

Ekziston një ndërlidhje e përgjithshme mes përkatësisë etnike dhe asaj fetare. Shumica e besimtarëve ortodoksë janë maqedonas etnikë, kurse shumica e besimtarëve myslimanë janë shqiptarë etnikë. Nuk ekziston një besim fetar zyrtar në nivel shtetëror, por me ndryshimet kushtetuese të vitit 2001 ceken në mënyrë konkrete pesë grupe fetare: Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM), Bashkësia Islame e Maqedonisë, Kisha Katolike Romake, Bashkësia Hebreje dhe Kisha Evangjelike Metodiste. Pjesëtarët e grupeve të tjera fetare kanë pohuar se kjo gjë ka shkaktuar trajtim favorizues ndaj pesë grupeve të cekura nga ana e Qeverisë. Ligji parasheh që grupet fetare të regjistrohen, me qëllim të marrjes së statusit të subjektit juridik dhe parasheh që të gjitha grupet (e regjistruara) të jenë të ndara nga shteti dhe të barabarta para ligjit.[26]

Ligji i përcakton materialet e nevojshme për aplikacionet e regjistruesve të rinj, si dhe afatin kohor brenda të cilit gjykata duhet të marrë vendim. Ndonëse emri

25. "Popullsia myslimane shqiptare në Ballkan në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX", Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Prishtinë 1995:161.

26. Ilievski, Petar "Tsrkovno-drzhavnite odnosi i megukonfesionalnata koexistentsia vo Makedonia" Skopje, 1998:162.

dhe shenja zyrtare e grupeve të reja duhet të jetë e ndryshme nga emrat dhe shenjat e grupeve që tashmë janë regjistruar, ligji lejon regjistrimin e më tepër grupeve të të njëjtit besim. Sipas interpretimit të gjykatave ligji parasheh që udhëheqësit e regjistruar të grupeve fetare të jenë shtetas të Maqedonisë.

Në ditët e përhapjes së dhunës dhe mungesës së harmonisë kolektive, që, fatkeqësisht, shpesh herë bëhet edhe në emër të Zotit, e ndjejmë të arsyeshme që edhe më shumë t'i japim shtytje procesit të dialogut. Kjo është koha kur shoqëria i ka mbyllur sytë para realitetit dhe ka shkuar aq larg saqë ka diskualifikuar religjionin në debat publik dhe shanset janë që sistemi të gjendet në materializëm të skajshëm të udhëhequr prej logjikës materialiste. Sot bota gjithnjë edhe më shumë ka nevojë për dialog. Për të arritur një dialog të mirëfilltë që të afron dhe jo të përçan, nuk duhet vetëm përpjekje të mëdha, por atë duhet konsideruar si imperativ kohor.[27]

Edhe pse legjislativi në Republikën e Maqedonisë, si shtet sekular, e respekton lirinë e besimit, ajo ka nevojë për përpjekje më të madhe institucionale që të nxisë edhe më shumë dialog ndërfetar dhe ndërkulturor me qëllim që të ul tensionet shoqërore në këtë vend, pasi dy etnitetet më të mëdha, ata maqedonase dhe shqiptare, përveç se i përkasin etnive të ndryshme ato janë edhe të feve të ndryshme, ortodoks dhe mysliman. Kjo ka bërë që popullata, edhe pse jetojnë pranë njëri-tjetrit, ato ndjehen shumë larg njëri-tjetrit.

Pikënisja e këtij fërkimi të kohëpaskohshëm etnik e fetar, dhe shpesh herë polarizimi ekstrem deri në skajshmërinë e luftës civile, ka filluar me qeverinë komuniste të viteve 1950, e cila pavarësisht faktit se regjimi ishte antifetar në tërë hapësirat ku sundonte ndalonte fenë dhe shkatërronte kultet fetare, në mënyrë paradoksale, në Maqedoni ishte rasti i kundërt, ai e favorizonte tej mase ortodoksizmin madje duke i dhënë edhe një prioritet karshi kishës ortodokse serbe, kjo me qëllim që të shtonte lojalitetin e maqedonasve karshi Jugosllavisë së atëhershme.[28]

Kriza e Kosovës e viteve 98 – 99, bëri që shumë shqiptar në Maqedoni të hapin dyert e strehimit për vëllezërit e tyre kosovarë, por kjo bëri që shumë maqedonas sllavë ta shohin këtë si kërcënim për integritetin dhe sovranitetin e shtetit të tyre, duke u frikësuar për realizimin e "Shqipërisë së Madhe".

Lufta e 2001 ndryshoi rrjedhat e harmonisë ndëretnike dhe ndërfetare në Maqedoni, pasi pala maqedone mendonte se ka plotësuar të gjitha të drejtat e pakicave, por realiteti tregonte se pala shqiptare nuk mund

27. Po aty, 164.

28. Jovanovic, Marija, "Prosvetno-politichkite priliki vo Vardarska Makedonia", Skopje, pa vit botimi, f. 123.

të konsiderohet pakicë. Konflikti mes maqedonasve dhe shqiptarëve dita ditës po rritej. Situata të vend filloi të polarizohej sidomos kur kësaj ju bashkëngjit edhe shkatërrimi i kulteve fetare të dy feve të mëdha.

Rasti më flagrant i politikës de-sekularizuese të qeverisë maqedone është ajo e (ai i) vrasjes së pesë maqedonasve ortodoksë në fshatin Smiljkovec ku qeveria, më konkretisht Ministria e Punëve të Brendshme, akoma pa pasur asnjë provë konkrete e lidhi këtë rast me terrorizmin në emër të fesë islame, duke prangosur si të dyshuar shumë shqiptarë dhe myslimanë dhe duke i akuzuar ata për terrorizëm radikal islamist.

Rast tjetër jo më pak të rëndësishëm është edhe ai i gërmimeve në kalanë e Shkupit me çka rezultoi se aty paska dëshmi të një kishe antike maqedonase, kjo rezultoi me një protestë kundër ndërtimit të kishës në brendësi të Kalasë së Shkupit, por gjithashtu edhe me një kundërprotestë nga pala ortodokse maqedonase, që ngjante me një beteje rrugësh saqë aty u përfshi jo vetëm policia, por edhe krerë të lartë të politikës vendore; kjo gjithsesi ngjalli një reaksion të fuqishëm politik.

Në Republikën e Maqedonisë kemi raste edhe të abuzimeve dhe diskriminimeve në bazë fetare, pasi religjioni është i lidhur me etnitetin, siç është rasti me karnevalin anti-fetar dhe anti-etnik në Vevçan të Strugës, që ngjalli pakënaqësi në vend saqë si rrjedhojë e tij u dogjën dy kisha ortodokse, një në Strugë dhe tjetra në Tetovë.[29]

Njëri ndër parimet kryesore të harmonisë ndërfetare është edhe respektimi i ndërsjellë i simboleve fetare, me theks të veçantë i atyre simboleve që janë të dukshme për anëtarët e secilit grup, siç janë minaret dhe kryqet. Kjo harmoni disa herë është luhatur; një nga arsyet e fundit të kësaj luhatjeje janë edhe simbolet fetare.

Në vitet e fundit qytetarët e Maqedonisë, sidomos ato myslimanë dhe të krishterë, janë bërë jo vetëm dëshmitarë të një ngjarje të rrallë, por domosdoshmërish edhe protagonistë të një gare të pafund, të asaj se kush ndërton më shumë simbole fetare, cili do ti ndërtojë më të larta dhe në vende më strategjike. Kjo garë e arriti kulmin e saj me ndërtimin e kryqeve gjigande në vende malore që mund të shihen edhe prej distancave më të largëta. Ndërtimi i kryqeve dhe simboleve të mëvetësishme pa prezencë të kultit bazë nuk ka qenë traditë e besimtarëve të krishterë deri në vitet e fundit. Rasti i parë është ndërtimi i "kryqit të mileniumit, 66 metra i lartë i vendosur në krye të malit Vodno në qytetin e Shkupit." Ndërtimi i kryqit në malin Vodno është veprimi më i dukshëm i desekularizimit të shtetit pasi ai u vendos në një vend publik të dukshëm për anëtarët e të gjitha komuniteteve.

29. Milosavlevski, Slavko, "Albanians in the Republic of Macedonia", Skopje, 1997:83.

Qeveria është ajo e cila duhet t'i kushtojë më tepër rëndësi zhvillimit të tolerancës ndëretnike dhe ndërfetare përmes realizimit të fushatave të ndryshme që afirmojnë këto vlera. Sikur struktura politike shtetërore të ruante tolerancën ndaj popujve dhe feve, me siguri sot Maqedonia do të kishte një pasqyrë shumë më të mirë se këtë që ka sot.[30]

II.2. Dialogu ndërfetar një domosdoshmëri për shoqërinë në Maqedoni

A mund ta imagjinojmë botën sikur të gjithë njerëzit të ishin të njëjtë, të flisnin njëlloj, të visheshin njëlloj, të besonin njëlloj, e kështu me radhë? Si rrjedhojë e kësaj jete prej roboti njerëzit do kishin një sistem, një parti, një qeveri, një kuvend, një president, një gjyqësor etj.

Në pamje të parë duket diçka shumë e mirë, ashtu siç kanë me vite edhe shqiptarët në Maqedoni, të cilët mendonin se duhet të kenë një parti, sepse kjo sipas tyre do u jepte pozitë më të mirë në raport me maqedonasit, por parashtrohet hipoteza: sikur në këtë sistem monist do ishte paraqitur korrupsioni, shantazhi, vjedhja, padrejtësia, montimi etj., atëherë sado që do dëshironim të ndryshonim situatën nuk do kishim mundësi, sepse njëshi nuk mund të zëvendësohet me asgjë. Diversiteti i religjioneve, popujve dhe gjithçka në lidhje me mbarëvajtjen e shoqërisë, siç është politika, qeverisja, presidenca, gjyqësori etj., është një sprovë nga Zoti se sa jemi të aftë për të menaxhuar ndryshimet mes nesh, por mbi të gjitha është edhe një balancim i fuqive të lartpërmendura përfaqësuese.

"Dhe sikur Allahu të mos i mbronte njerëzit me disa prej disa të tjerëve, do të shkatërrohej toka, po Allahu është bamirës i madh ndaj njerëzimit."[31]

"E sikur Allahu të mos i zmbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat (sinagogat) e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i Allahut".[32]

Sipas këtij verseti kuptojmë se sikur të mos kishte pasur ndryshime mes njerëzve dhe sikur fuqia do ishte në dorën e vetëm një grupi (një populli, një etniteti, një race, një feje etj.) bota do ishte e korruptuar, sepse njerëzit kanë nevojë që të tjerët t'i limitojnë dëshirat e tyre impulsive për ekspansion dhe dominim total.

Kurse verseti i dytë është edhe më specifik pasi Zoti justifikon balancimin e fuqive religjioze dhe fakti që fillimisht përmenden manastiret, kishat dhe havrat (sinagogat) para përmendjes së xhamive është shenjë se Zoti njeh ekzistencën e të gjitha kulteve fetare dhe urdhëron paprekshmërinë e tyre dhe respekt për ata që falen brenda tyre.

30. Konferenca "Të rinjtë dhe toleranca ndëretnike dhe ndërfetare në Republikën e Maqedonisë", 19 Nëntor 2011.

31. Kur'an, 2:251.

32. Kur'an, 22: 40.

E ndjejmë të arsyeshme të theksojmë se në bazë të besimeve monoteiste principi i përgjithshëm i dialogut është se pavarësisht se kemi religjione të ndryshme, të përbashkët kemi besimin në një Zot dhe ky është i njëjti Zot për të gjithë. Jo rastësisht Allahu kur u referohet feve monoteiste i titullon "ithtarë të librave qiellorë". E ndjej se ky paragraf do irritojë disa radikalë të mllefosur por çka tu bëjmë këtyre verseteve kuranore ku Zoti na këshillon që ithtarëve të librit (krishterëve dhe hebrejve) tu themi:

"Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij." (Kur'an, 29: 46), "O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos Allahut"! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë (besuam një Zot)"!" (Kur'an, 3, 64).

Islami nuk thërret vetëm për dialog, por tregon edhe se në çfarë forme duhet të zhvillohet ai. "ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kurrë i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë". (Kur'an, 29, 46) "Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira." [33]

Por si mund ta konsiderojmë dialogun në Islam si diçka universale kur deri tani të gjitha versetet kur'anore u dedikoheshin vetëm pjesëtareve të fesë kristiane dhe hebreje. Si qëndron puna në raport me ata që janë pjesë e besimeve monoteiste? Kur'ani shkon edhe më tej me këshillat paqësore saqë kërkon respekt dhe mirëkuptim reciprok me çdo qenie njerëzore që është paqësore, qofshin këta edhe paganë apo ateistë.

"Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë" (Kur'an, 60:8).[34]

Këtu Zoti qartazi bën thirrje, që të krijohet lidhje drejtësie dhe humanizmi me të gjithë ata që respektojnë lirinë e bashkëjetesës dhe dinjitetin njerëzor.

II.3. Sfidat e dialogut ndërfetar në Maqedoni

Në konferencën e organizuar, e cila zhvillohet në kuadër të agjendës globale të Kombeve të Bashkuara "Migrimi dhe sfida e integrimit përmes dialogut midis religjioneve dhe kulturave" Bashkësia Fetare

33. Kur'an, 16: 125.
34. Kur'an, 60:8.

Islame e Republikës së Maqedonisë me në krye H. Sulejman Rexhepi bojkoton konferencën mirëpo, kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë (BFI), Sulejman Rexhepi tha se institucioni që ai drejton ka marrë pjesë vetëm në konferencën e parë dhe të dytë botërore për dialog ndërfetar. Ai deklaroi për mediat se "BFI nuk do të marrë pjesë në konferenca të tilla", sepse siç tha ai "në Maqedoni nuk ekziston dialogu ndërfetar dhe nuk respektohet komuniteti mysliman sa duhet". Z. Rexhepi përmendi disa arsye për bojkotimin e kësaj konference botërore, me theks të veçantë rinovimin e xhamisë në çarshinë e Prilepit dhe mos lejimi i ndërtimit të xhamisë në fshatin Llazhec të Manastirit, ku numri i banorëve të komunitetit mysliman dhe ortodoks është i barabartë.

Sipas tij, me anë të konferencave të tilla "synojnë të gënjejnë botën se në këtë vend ka harmoni ndërfetare, drejtësi dhe vepron një shtet demokratik, por këtu ushtrohet një padrejtësi e madhe". "Këtu në Maqedoni nuk ka dialog dhe unë nuk mund ta gënjej vetveten, nuk mund ta tradhtoj institucionin dhe interesat e tij, si dhe nuk mund të marrë pjesë në atë konferencë, të bëhem një instrument i rrejshëm dhe të krijojë atmosferë se këtu në Maqedoni vetëm qumësht dhe mjaltë bie nga qielli. Në këtë vend dialogu nuk ekziston, këtu ka qenë dhe ende mbretëron një diktaturë e çuditshme", tha Rexhepi për AA. Rexhepi në vijim theksoi se në Konferencën e dytë botërore për dialog ndërfetar, mori pjesë me kusht që të fillojë rinovimi i xhamisë në Prilep. Mirëpo, siç tha ai, edhe pse është arritur të nënshkruhet marrëveshje me Qeverinë e Maqedonisë për rinovimin e saj, ajo marrëveshje nuk u zbatua.[35]

Vetë shteti i Maqedonisë, krahas sakrificave të shumëllojshme, është fryt edhe i kësaj bashkëjetese dhe harmonie ndërfetare. Ne jemi të bindur dhe të vetëdijshëm se çdo besim fetar dialogun e ka në rrënjët e tij; harmonia, bashkëjetesa dhe respekti ekziston në shpirtin e çdo besimi fetar.

Kjo për arsye se mes përfaqësuesve kryesorë që na dhuruan shtetin shqiptar, ishin edhe prijësit fetarë të besimeve të ndryshme, apo edhe intelektualët e kohës të brumosur me besimet tradicionale fetare. Ne kemi trashëguar nga prijësit tanë fetarë, dashurinë për Zotin e për njeriun, si dhe respektin për çdo qenie njerëzore, pavarësisht ndasive që mund t'i karakterizojnë ata, si edhe detyrimin fundamental që të jemi në komunikim të vazhdueshëm me besimtarët e feve të tjera.

Natyrisht që dialogu kërkon

35. http://www.almakos.com/manastir-fillon-konferenca-boterore-per-dialog-nderfetar-bfi-e-bojkoton (qershor 2017)

përpjekje dhe vullnet, ndërkohë, modeli i harmonisë, tolerancës dhe dialogut ndërfetar në Maqedoni përbën një aspekt pozitiv të vullnetit dhe të kulturës së shoqërisë Maqedonase.

Ne myslimanët shqiptarë jemi në frymë dhe veprim pro vlerave më pozitive të demokracisë perëndimore dhe këtë e provojmë me bashkëjetesën vëllazërore me komunitetet e tjera fetare që në vendin tonë janë minoranca në këtë rast, por ne, me vetëdije dhe si pjesë organike e besimit tonë, asnjëherë nuk jemi sjellë përballë tyre si shumicë.

Besimi fetar në vetvete, qoftë ai islam, kristian apo tjetër, përtej instrumentalizimit dhe keqinterpretimeve, është burim i normave dhe vlerave më të shkëlqyera të bashkëjetesës njerëzore në çdo nivel. Për shembull, në aspektin e tij më themelor, Islami personifikohet me frazën më të përdorur të të gjithë Kur'anit: Bismi'lahirr – Rrahmanirr - Rrahim - "Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit". Zoti e shfaq vetveten nëpërmjet Mëshirës dhe Dhembshurisë së Tij Absolute dhe Islami është themeluar mbi bazën e këtij pohimi. I tillë është thelbi i çdo besimi tradicional fetar që është trashëguar ndër ne shqiptarët, por si përfaqësues i komunitetit mysliman, duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj po i referohem vetëm Kur'anit. Urdhërimi për dialog është në përputhje të plotë edhe me urdhrat e Zotit që përmes shumë të dërguarve të tij, Ai përforcoi vlerën e dialogut. Rasti i Musait a.s. dhe Harunit a.s., ku Zoti i orientoi ata të flisnin me fjalë të buta edhe me një diktator siç ishte Faraoni, tregon rëndësinë që i jep feja dialogut për zgjidhjen e konflikteve dhe problemeve.[36]

Me keqardhje mund të themi se Islami ka qenë fe e keqkuptuar dhe për këtë, përgjithësisht, përgjegjësinë e kemi ne myslimanët. Kjo për arsye se shpesh herë myslimanët kanë rënë pre e interpretimeve të fesë për interesa politike e ideologjike dhe rrjedhimisht kanë qenë të mbyllur ndaj dialogut dhe ndonjëherë përjashtues ndaj kulturave të tjera. Shumë dështime të tyre myslimanët nuk i kanë kërkuar te totalitarizmi dhe mungesa e demokracisë dhe nivelit arsimor në vend, por janë shtyrë të arsyetojnë problemet e mëdha me teori konspirative sikur gjithë bota është bashkuar kundër myslimanëve.

Shembujt e bashkëjetesës dhe dialogut janë të shumtë në shumë vende, por ajo që e bën të veçantë bashkëjetesën bashkë me sfidat e saj është se, bashkëjetesa në Maqedoni fillon që në familje, në fqinjësi dhe shtrihet në të gjithë shoqërinë më pas. Ndonëse sfidat tona janë të mëdha, nuk mund të themi që janë të jashtëzakonshme.

36. http://afalc.org/al/shqip/lajme/3134-DIALOGU-sht-rrnj-feje.html. (qershor 2017)

Sidoqoftë mund të themi apo ta marrim si një shembull të gjallë bashkëjetesën dhe dialogun midis feve dhe etnive të ndryshme në Maqedoni sado që të mohohet përsëri mbetet një e vërtetë e pashmangshme.

III.1. Qasja e shqiptarëve të Maqedonisë ndaj dialogut ndërfetar

"*Udhëheqësia e drejtë dhe e vërtetë nuk është ajo e cila qytetarët i bën që të ndihen të lirë, por ajo e cila qytetarët i bënë të ndihen të nevojshëm, gjegjësisht të domosdoshëm.*"[37]

Barazia e njerëzve është fakt shpirtëror e jo natyror (fizik ose intelektual). Ajo ekziston si vlerë e barabartë morale e njeriut, si dinjitet njerëzor, si vlerë e patjetërsueshme e barabartë e personalitetit njerëzor. Anasjelltas, si qenie fizike, mendore dhe shoqërore, si anëtarë të kolektivit, të popullit, të klasës, të sistemit politik, njerëzit gjithnjë janë tejet të pabarabartë dhe ky është një fakt para të cilit është e kotë t'i mbyllësh sytë.

Maqedonia është një shtet i vogël dhe shumëngjyrësh, qoftë në aspektin kulturor, ideologjik e fetar, qoftë në aspektin ekonomik, shoqëror e politik. Në aspektin kulturor, ideologjik dhe fetar Maqedonia, krahas besimeve dhe ideologjive të tjera, dominohet nga krishterimi (ortodoksizmi) dhe islami. Ndërkaq, në aspektin ekonomik, shoqëror dhe politik ky shtet i vogël është ndërmjet një sistemi monist, të cilin krerët aktualë politikë dhe intelektualë maqedonas e duan dhe përpiqen me mish e me shpirt ta ruajnë, dhe një sistemi demokratik, i cili vjen në Maqedoni mysafir dhe dëshiron të qëndrojë net të tëra me "zor", apo ndoshta edhe të bëhet vendas. Por, krahas kësaj llojllojshmërie, "aga" në këtë vend, sidomos gjatë dhjetë vjetëve të fundit, është (le të themi ishte, gjë të cilën maqedonasit nuk dëshirojnë që ta kuptojnë) populli maqedonas.

Kjo pozitë e detyron këtë popull të vendosë (nëse dëshiron të jetë i shëndoshë) që, në "stinën e dimrit", kur bën shumë ftohtë, të veshë rroba më të trasha, rroba dimërore, e kur bën nxehtë, në "stinën e verës", të veshë rrobat verore, pra të kuptojë se në cilën kohë gjendet dhe se çfarë temperature politike dominon në atë kohë.

Siç edhe duket disa liderë maqedonas, meqë në këtë shtet të vogël kanë ardhur vetëm "verës" (pra këtë vend gjithmonë e kanë paramenduar vetëm të nxehtë si një sistem të përshtatshëm vetëm për ata), e tani, në kohën e "dimrit", mërdhijnë, por nuk e dinë pse.

A thua nuk kujtohen fare se kanë harruar "t'i veshin rrobat e dimrit"? Sa mirë do të ishte të

37. Muhiq, Ferid, "*Logos i Hierarhija*", Logos, Skopje, 2001:38.

shikonin pak veten! Çdo gjë do të ishte e qartë! E megjithatë, kjo nuk më brengos shumë, sepse kjo është një mendësi ballkanike. Njeriu i këtij rajoni ballkanik nuk i thotë mjekut më ndihmo, por më jep këtë ilaç, se më ka bërë mirë, paçka se sëmundjet janë të llojllojshme.[38]

Për fat të keq, këtu, në këtë shtet të vogël, ne kemi të bëjmë me një grup njerëzish, liderë të nacionalitetit maqedonas (them një grup, sepse nuk besoj të gjithë maqedonasit të mendojnë si ata) të cilët, edhe pse të uritur, e hedhin bukën që e kanë për vete, edhe pse mërdhijnë nga të ftohtët, thyejnë dritaret e shtëpisë ku banojnë vetë, edhe pse dinë të ngasin makinën e dëmtojnë çelësin e saj, me një fjalë me njerëz që vrasin veten me dorën e vet. Këtë e bëjnë sepse nuk dëshirojnë ta shohin tjetrin të ngopur me bukë, të ngrohur kur bën ftohtë, ta shohin duke ngarë makinën, por ta shohin në këmbë.

E kështu pra edhe ne, së pari: kemi të bëjmë me një mendësi të Kishës Ortodokse Maqedonase, e cila mban nën sqetullat e saj njerëz klerikë që e deklarojnë veten liderë shpirtërorë të trimave të ashtuquajtur "llavovi" (luanë), "vollci" (ujq) etj., apo bën shenjtërimin e tyre (duke u shpërndarë pllaka), kinse ata kanë qenë mbrojtësit e Maqedonisë. Pra, kanë qenë "mbrojtës" që shtëpitë e shqiptarëve të mos mbeten pa u prishur, që shqiptarët të mos mbeten pa u vrarë, me një fjalë që çdo gjë shqiptare të shkatërrohet dhe të bëhet pastrimi i Maqedonisë nga këta "elementë negativë" të shoqërisë. Së dyti: kemi të bëjmë me një aparaturë udhëheqëse të shtetit, e cila për të prishur një xhami e prish edhe kishën e vet, apo për të vrarë një shqiptar i vret edhe disa njerëz të palës së vet, ose për t'i nxjerrë të tjerët fajtorë e prish shtëpinë, hotelin e vet etj.

Pra, bie në ujdi që edhe vetë të dëmtohet, vetëm e vetëm që tjetri të mos fitojë gjë. Mentalitet ky i ulët, shumë i ulët, një mentalitet që nuk e pranon edhe vet Satani. Po ashtu mentalitet ky me të cilin habitet edhe Faraoni. Këtu nuk mund të kaloj pa e përmendur këndvështrimin e një sociologu për politikën. Sociologu shkruan se një herë një nxënësi mësuesi i kërkon që kur të shkojë në shtëpi të kërkojë prej prindërve të tij t'ia mësojnë se ç'është politika. Kur nxënësi vjen në shtëpi e pyet babanë se ç'është politika dhe ai thotë se nuk kemi aq kohë për të shpjeguar se ç'është politika, por, le të themi se unë (babai) jam kryetari i shtetit, nëna jote është qeveria, ti je shtresa intelektuale, foshnja është e ardhmja jonë, kurse kjo shërbyesja është klasa punëtore.

Dhe këtu babai i thotë se shpjegimin do ta vazhdojë nesër. Bien të flenë. Natën vonë, dëgjohen të qarat e një fëmije. Nxënësi çohet

38. Nesimi, 2005:208.

të shohë se çka ngjarë. Kur sheh foshnjën si qan, vëren se ajo e ka kryer nevojën e madhe dhe i vjen era nga larg. Ndërkaq, babanë e sheh duke fjetur me shërbyesen, nënën e gjen duke gërhitur pandërprerë. Kthehet përsëri te shtrati i vet dhe bie të flejë. Kur çohet në mëngjes, babai e thërret dhe i thotë: "Eja djali im të të tregoj se ç'është politika. Jo, babai im, i thotë djali, politikën e mësova. Po, ç'është politika, pra? - i thotë babai. Djali (nxënësi) thotë: Kryetari (babai) e shtyp klasën punëtore, qeveria (nëna) gjendet në gjumë, intelektualët (nxënësi) shëtisin lart poshtë, kurse e ardhmja (foshnja) është mbuluar nga ndyrësia e i vjen era nga larg. Kjo është politika, baba."

Pra, kur shohim sjelljet dhe qëndrimet e disa liderëve politikë maqedonas dhe të disa prijësve fetarë të kishës, nuk mund të mos i quajmë të vërtetë këta shembuj. Dua të theksoj se me shembujt e lartshënuar nuk dëshiroj të jem pesimist apo të shpreh pesimizëm, as të formoj bindje pesimiste te të tjerët, sepse Zoti, edhe njeriut më të keq nuk ia humb shpresën për të jetuar sipas rregullave të Tij dhe që në botën e ardhshme (ahiret) të jetë fituesi i shpërblimit të Zotit, qoftë edhe t'i ketë bërë gabimet më të mëdha në këtë botë.[39]

Ndërkaq, periudhat e pakënaqësisë sociale, në esencë, janë pakënaqësi ndaj udhëheqjes e jo ndaj institucionit. Edhe kjo që ndodhi në Maqedoni nuk ishte kundër shtetit maqedonas por kundër udhëheqjes dhe udhëheqësve të saj, apo kundër metodologjisë së saj udhëheqëse. Prandaj profesori, Ferid Muhiq, thotë se, muzikantët mund të protestojnë kundër dirigjentit, por kjo nuk do të thotë se ata janë kundër dirigjimit; aktorët mund të jenë kundër regjisorit, por kjo nuk do të thotë se ata duan që shfaqja të bëhet pa regjisor.

Në fakt, njeriu mendon për veten atëherë kur mendon edhe për të tjerët, kështu që, duke menduar për të tjerët, ai mendon edhe për veten e tij. Ndërkaq nëse mendon vetëm për veten e tij e nuk mendon edhe për të tjerët, atëherë, mund të them se, ai nuk mendon as për vetveten.[40]

Nëse s'e pranoni shpirtëroren e njeriut atë fakt të rendit religjioz ju humbisni bazën e vetme reale të barazisë njerëzore; barazia atëbotë bëhet frazë pa mbështetje dhe pa vatër dhe, si e tillë, ajo do të zmbrapset shpejt para fakteve evidente të pabarazisë njerëzore, ose, edhe më tej, para synimit natyror të njeriut të sundojë dhe të nënshtrohet, pra të jetë i pabarabartë.

Sapo të braktiset qasja religjioze, hapësirën boshe sakaq e plotësojnë pabarazitë e ndryshme racore, nacionale, klasore, politike.

39. Po aty, 206.

40. Muhiq, 2001: 9.

Dinjiteti i njeriut s'ka mundur të zbulohet as me biologji, as me psikologji, as me shkencë përgjithësisht. Ai është çështje e rendit shpirtëror. Para barazisë, shkenca me "vëzhgim objektiv" do të vërtetonte pabarazinë e njerëzve, ndaj "racizmi shkencor" është fare i mundshëm dhe logjik.

Konkluzione

Toleranca dhe dialogu mbeten ndër faktorët më të rëndësishëm të sigurimit të paqes, harmonisë dhe mirëkuptimit mes individëve të besimeve, racave, ngjyrave apo kombeve të ndryshme. Toleranca ndërfetare është një vlerë e madhe dhe bazat e saj teologjike mund t'i gjejmë në shumë vargje kuranore si dhe në shumë skena të jetës së profetit Muhamed a.s. Allahu në Kur'an, në suren Huxhurat, thotë: "O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te Allahu, më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (të këqijave) e Allahu është i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë." Këtu vlerësohet devotshmëria dhe jo gjinia apo raca.

Në të njëjtën kohë dialogu dhe toleranca ndërfetare mbeten ndër vlerat më të mëdha të shoqërisë pa dallim vendndodhjeje. Pasi sollëm në vëmendje bazat fetare të këtij lloj dialogu, pra bazat në Kur'an dhe në Traditën Profetike, analizuam tolerancën ndërfetare në shoqëri në përgjithësi dhe së fundmi sollëm disa rezultate të këndvështrimit sociologjik dhe fetar që shoqëria maqedonase kanë rreth dialogut ndërfetar.

Një ndër tendencat që spikati më tepër në këto rezultate ishte edhe qëndrimi pozitiv i Shqiptareve të Maqedonisë ku nga 100% pjesëmarrës 83 % ishin pro dialogut ndërfetar, 80 % i pranojnë dhe respektojnë fetë si dhe ndjejnë keqardhje kur flitet keq për to. Për më tepër, pjesa më e madhe e të dy grupeve, atyre pro dhe kundër dialogut ndërfetar janë plotësisht dakord për një martesë ndërfetare, tregues ky që sqaron se, megjithëse njerëzit mendojnë se janë kundër dialogut ndërfetar ata në praktikë janë pro tij. E gjitha kjo për arsye se martesa është kulmi i dialogut ndërfetar dhe sipas Bogardus Social Distance Scale një person që e pranon lidhjen martesore me dikë të një besimi tjetër atëherë ai person e pranon besimtarin tjetër si bashkështetas, si fqinj, si shok, mik etj.

Si përfundim, dialogu ndërfetar është një fenomen që me të vërtetën ekziston në shoqërinë maqedonase dhe si i tillë dialogu duhet vlerësuar si nga njerëzit e thjeshtë ashtu edhe nga institucionet drejtuese të shtetit.

Bibliografia

"Popullsia myslimane shqiptare në Ballkan në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX", Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët-simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 Tetor 1992.

Ayduz, Davut, "Tarih Boyunca Dinlerarasi Diyalog", 3. Basim, Istanbul: Isik Yayinlari, 2005.

Çupi, Xhemail, "Suksesi i konferencave ndërfetare në Maqedoni prej 2001 deri sot" Tetovë, pa vit botimi.

Daskalovski, Zidas "The macedonian conflict of 2001:between successful diplomacy, rhetoric and terror" Skopje, 2004.

Elmalılı, M. Hamdi Yazır, Hak Dini Kur'an Dili, v. 2, Stamboll, pa vit botimi.

Gylen, Fethullah, "Dashuri dhe Tolerancë", Prizmi, 2012.

Ilievski, Petar "Tsrkovno-drzhavnite odnosi i megukonfesionalnata koexistentsia vo Makedonia" Skopje,1998.

Imam Neveviu, Rijadus-Salihin.

Jovanovic, Marija"Prosvetno-politichkite priliki vo Vardarska Makedonia" Skopje, pa vit botimi.

Katedra za Unesco "Raportimi mediatik mbi çështjet ndëretnike dhe ndërfetare në Republikën e Maqedonisë" MDG Achievement Fund, Skopje, 2012.

Konferenca "Të rinjtë dhe toleranca ndëretnike dhe ndërfetare në Republikën e Maqedonisë", 19 Nëntor 2011.

Kruja, Genti, "Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar", Prizmi, Tiranë, 2008.

Kur'an, përkth. Sherif Ahmedi, Ali Imran, Medine, 1987.

Milosavlevski, Slavko"Albanians in the Republic of Macedonia" Skopje, studentski zbor, 1997.

Mojzes, Paul "Tensions within Religious Communities in the Balkans" Skopje, 2007.

Mojzes, Paul "The Second World Conference on Inter-Religious and Inter-Civilization Dialogue"
Ohrid, 2010.

Muhiq, Ferid, "Jazikot na Filozofijata" Shkup, Kultura, Logos i Hierarhija, 2001.

Nesimi, Qani, "Dialogu Obligim Hyjnor", Shkup, Logos, 2005.

Petar "Tsrkovno-drzhavnite odnosi i megukonfesionalnata koexistentsia vo Makedonia" 1998.

Rešid, Hafizović, "Myslimani u dijalogu s drugima i sa sobom", el-Kalem, Sarajevë, 2002.

Swidler, Leonard "Journal of Ecumenical Studies" Skopje, 2008.

Webliografia

https://www.state.gov/j/drl/rls/irf/religiousfreedom/index.htm#wrapper 02/2017/

http://www.almakos.com/manastir-fillon-konferenca-boterore-per-dialog-nderfetar-bfi-e-bojkoton.

https://www.google.al/search?q=Mojzes%2C+Paul+%E2%80%9DTensions+within+Religious+Communities+in+the+Balkans%E2%80%9D+2007%3A4.&oq=Mojzes%2C+Paul+%E2%80%9DTensions+within+Religious+Communities+in+the+Balkans%E2%80%9D+2007%3A4.&aqs=chrome..69i57.1276j0j7&sourceid=chrome&ie=UTF-8

http://afalc.org/al/shqip/lajme/3134-DIALOGU-sht-rrnj-feje.html

http://www.almakos.com/manastir-fillon-konferenca-boterore-per-dialog-nderfetar-bfi-e-bojkoton. //06/2017/

http://jusufzimeri.com/?p=2179/

Pikëpamjet filozofike të Vexhi Demirajt

Msc. Ana Gjeci, Zvicër

Abstrakt

Tema e kërkimit synon të zbulojë ndihmesën e studiuesit të teologjisë dhe filozofisë Vexhi Demiraj, duke hulumtuar jetën, veprën dhe pikëpamjet e tij filozofike. Duke qenë se ky autor ka shkruar gjerësisht rreth filozofisë, punimi synon thellimin më shumë në pikëpamjet e tij rreth filozofisë së fesë dhe asaj islame në veçanti, duke qenë se këto dy filozofi nuk janë parë shumë të lidhura në Shqipëri.

Fjalët kyçe: *metafizika, materializmi, filozofia e fesë, filozofia Islame, filozofia pozitive*

Jeta e Vexhi Demirajt
a. Jeta familjare

Vexhi Demiraj lindi në Vlorë, më 21.06.1910, në Mëhallën e Re. Babai i tij, Sulejmani, shërbente si imam në ish-xhaminë e Tabakëve, e cila u shkatërrua gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kështu ai u rrit në një mjedis fetar mysliman dhe u edukua me kulturë fetare që në fëmijëri. Mbasi mbaroi shkollën fillore me rezultate të larta, ai i vazhdoi studimet e tij në Medresenë e Tiranës dhe më pas në Universitetin e Ez'herit në Egjipt. Pasi mbaroi studimet atje kthehet në Shqipëri, ku fillimisht punon si mësues në Medresenë e Tiranës e më pas bëhet drejtor i saj.[1]

Viti 1939 solli ndryshime në rrjedhën e jetës familjare të Vexhi Demirajt. Ai tashmë do të krijonte familjen e tij pas martesës me një

1. Jetëshkrimi bazohet në studimet dhe librat e studiuesit Xhemal Balla, "Vexhi Demiraj, Mësues e Studiues i Teologjisë dhe i Filozofisë", Shtypshkronja "West Print", Tiranë 2015 dhe Balla, Xhemal, "Vexhi Demiraj, mësues dhe studiues i diturisë Islame", Revista "Drita Islame", nr. 2, 2012.

vajzë fisnike, zonjushën Paqize, të bijën e Abdulla Hatibit që vinte nga Dibra e Madhe. Vexhi Demiraj la tre fëmijë: Ferialin, Vedatin dhe Gëzimin.

Profesor Vexhiu ndërroi jetë më 26 shkurt 1985. Ai nuk pati fatin të shijojë çlirimin e ndërgjegjes, të besimit të tij te Zoti, që e kujtonte dhe e adhuronte në vetminë e errët, burgosur nga regjimi komunist. Lirinë që solli demokracia, me ringjalljen e ringritjen e institucioneve fetare, për të cilat ai kontribuoi shumë, për të cilat edhe u arsimua, nuk arriti t'i shohë me sy. Por profesor Vexhiu do të mbetet shembull i gjallë frymëzimi për ata që e kanë njohur atë dhe që kanë njohur veprën e tij.

Njohja, respektimi dhe nderimi i punës së profesor Vexhiut, jo vetëm nga fëmijët e tij e rrethi më i gjerë familjar, por edhe më gjerë, në shtresat intelektuale e fetare është detyrim moral dhe krijon premisat që figura të tilla si ai të nderohen dhe vlerësohen nga brezat pasardhës.

b. Vitet e studimeve

Pas shkollës fillore, Vexhi Demiraj vazhdon studimet e tij në Medresenë e Tiranës, asokohe e sapo hapur. Ai e konsideroi këtë shkollë si një mundësi të mirë të motivimit të tij për t'u arsimuar. Kësisoj, përkushtimi i tij në përvetësimin e programeve mësimore, do ta nxirrte ndër nxënësit më të dalluar të shkollës. Përkrahja dhe mbështetja që iu dha në jetën e konviktit, e bënë atë shumë të përgjegjshëm përpara familjes dhe shkollës. Kjo ishte arsyeja, që ai, nga viti në vit, po formohej më shumë, duke përcaktuar edhe metodën e punës së tij për të ecur përpara dhe motivimin për të ardhmen e tij. Bashkë me rezultatet shumë të mira që arrinte nga viti në vit, ai u bë i vetëdijshëm se çfarë do të arrinte me arsimimin e plotë në këtë fushë. Dhe shumë shpejt ai iu fut punës studimore shkencore. Duke qenë se dallohej nga të tjerët, stafi pedagogjik i shkollës e përzgjodhi që të përshëndeste e të uronte në një ceremoni të veçantë, organizuar me 15 mars 1930, për të përcjellë për në haxh, grupin e parë të pelegrinëve shqiptarë. Fjala e tij do të botohej në revistën "Zani i Naltë", Mars 1930.[2] Botimi i fjalës së tij në këtë revistë prestigjioze, i vlejti mjaft dhe e nxiti për t'u angazhuar më tej në aktivitete shkollore e jashtëshkollore me tematikë fetare.

Në vitin e fundit të shkollës ai do të angazhohej me një seri shkrimesh po në revistën *Zani i Naltë*.[3] Viti 1932, viti i diplomimit të tij, e afirmoi Vexhiun një student të pjekur e të formuar, tashmë me një kulturë të spikatur, duke u renditur

2. Kolana "Zani i Naltë", vëll. III, botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Tiranë 2015, 977-979.
3. Shih. Kolana, vëll. III-IV.

në rubrikat e revistës në fjalë, bashkë me pedagogët e tij. Këtu mund të përmendim një eveniment të rëndësishëm për Medresenë e Tiranës. Më 5 janar të vitit 1932, bëhet inaugurimi i ndërtesës së re, dhe, me këtë rast, përzgjidhet përsëri për të përshëndetur studenti Vexhi Demiraj, fjala e të cilit do të botohej në revistën "Zani i Naltë".[4]

Nga gjithë ky aktivitet i gjerë botues dhe përfaqësim dinjitoz, shihet se studenti nga Vlora i kishte arritur objektivat e tij e të familjes. Ai u diplomua në Medresenë e Përgjithshme në vitin shkollor 1931-1932 me gradën "Lavdërueshëm".

Rezultatet e larta në përfundim të studimeve dhe formimi i përgjithshëm kulturor, bënë që Komuniteti Mysliman ta përzgjedhë atë të vazhdojë studimet e larta, me bursë të akorduar prej tij, në Universitetin e Ez'herit në Kajro të Egjiptit. Më pas, si student i shkëlqyer, Vexhiun e kalojnë në Universitetin Shtetëror, në fakultetin e Letërsisë, në seksionin e Filozofisë. Edhe këtu ai do të dallohej si një student kërkues, studiues dhe ambicioz në përvetësimin e disiplinave shkollore. Është për këtë shkak që një ndër gazetat më në zë të Egjiptit, *Jeta e Re*, korrik 1937, nën titullin: "Një nxënës shqiptar n'Egjipt", bashkë me fotografinë e Vexhiut, do të shkruante:

"Zoti Vexhi Sulejman Demiraj, student shqiptar në letërsi, doli i dyti në provimet dhe hyri në klasën e fundit të degës së filozofisë. Ai është i pari i huaj q'arrin në këtë shkallë të lartë".

Gjatë jetës studentore Vexhi Demiraj është dalluar edhe si aktivist shoqëror. Ai ka marrë pjesë aktive në procesin e bashkimit të shqiptarëve në Egjipt, të cilët ishin ndarë në tri shoqëri të ndryshme për arsye fetare. Këto tri shoqëri u bashkuan në qendrën e kolonisë shqiptare që ishte në Aleksandri dhe që quhej "Bashkësia Shqiptare", e cila vazhdon edhe sot.

Në qershor të vitit 1938 studenti Vexhi Demiraj do të përfundojë studimet e larta në Universitetin Egjiptian në Letërsi.

c. Vitet e punës

Kryerja me sukses e studimeve të larta dhe diplomimi i tij me rezultate shumë të mira, do të gëzonin jo vetëm profesor Vexhiun, por tërë familjen e tij, e cila priste me padurim kontributin e tij në drejtim të kulturës e të arsimit fetar. Me kënaqësi do të pritej edhe paraqitja e diplomës në Komunitetin Mysliman Shqiptar, i cili do t'i rekomandonte drejtorisë së Medresesë që Vexhi Demiraj të bëhej pjesë e stafit pedagogjik të saj. Mbas një viti, Komuniteti Mysliman Shqiptar do ta dekretonte si profesor të filozofisë në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës.

4. Kolana, vëll. IV, 120-138.

Profesor Vexhiu që në hapat e para të detyrës së tij si pedagog në Medrese u prit shumë mirë nga ish-profesorët e tij. Ai ndau me ta interesin e shqetësimin e vazhdueshëm për të përgatitur nxënës me dije të sakta shkencore e fetare. Profesor Vexhiu bëri përpjekje të vazhdueshme për të kryer sa më mirë misionin e tij si mësimdhënës dhe edukator. Për këtë shkak, personaliteti i tij në Medrese sa vinte dhe rritej më shumë, duke u dalluar për ngritjen e tij teologjike, filozofike dhe pedagogjike. Ky formim e bëri profesor Vexhiun që të njohë më mirë dhe më thellë programet mësimore dhe t'i realizojë ato me nivel dhe me cilësi të lartë. Ai dallohej në njohjen e thellë të koncepteve filozofike e teorike dhe konkluzioneve në drejtim të Islamit.

Por, për fat të keq, ai do të shkëputej nga Medreseja, kur ajo do të mbyllet për një kohë, me çlirimin e vendit me 29 nëntor 1944.

Për vitin shkollor 1944–1945 ai do të emërohej nga Ministria e Arsimit si profesor i frëngjishtes në shkollën Pedagogjike "17 Nëntori". Kështu profesor Vexhiu kalon në arsimin shtetëror për të vazhduar më tej si pedagog i letërsisë dhe më vonë i gjeografisë në shkollën e Mesme Ekonomike deri në vitin 1965 kur del në pension.

Mësuesi i apasionuar i gjeografisë, siç mbahet mend ai kohët e fundit, me autoritetin, karakterin, ndërgjegjen, urtësinë e pjekurinë e tij, ishte njeri me personalitet të lartë dhe, për këtë, gjithmonë nderohej dhe respektohej me titullin "profesor", duke lënë gjurmë mbresëlënëse tek ish-nxënësit e tij, kolegët dhe shoqëria që e rrethonte.

d. Titujt e marrë dhe shkrimet rreth jetës dhe veprës së tij

Gjatë periudhës si mësimdhënës dhe edukator ai ka kryer disa kurse kualifikimi në Universitetin e Tiranës dhe falë pasionit dhe përkushtimit profesional, u afirmua si një mësues me personalitet të lartë pedagogjik. Për këtë ai do të vlerësohej me certifikata e tituj, si: "Për aktivitet të dalluar në fushën e arsimit e të kulturës" nga Presidiumi i Bashkimit Qendror të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë; "Urdhri i Punës" Klasi i Parë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me motivacionin "Për punë të ndërgjegjshme dhe të palodhur gjatë 20 viteve në sektorin e arsimit", etj.

Puna e tij mbresëlënëse ka tërhequr vëmendjen e disa studiuesve, të cilët kanë shkruar rreth jetës dhe veprës së tij. Mund të përmendim artikullin e Ahmet Kondos "Vexhi Demiraj, profesor i filozofisë Islame" në gazetën "Drita Islame";[5] artikullin në gazetën "Gjylistani" "Profesor Vexhi S. Demiraj orientalist (Me rastin e 90-vjetorit të lindjes)"[6]; artikullin e gazetës egjiptiane "Jeta e Re"

5. Gazeta "Drita Islame", nr. 14, gusht 1995.
6. Gazeta "Gjylistani", 7 korrik 1997.

"Një nxënës shqiptar në Egjipt";[7] përmbledhjen e artikujve të tij rreth filozofëve të mëdhenj myslimanë nga Nexhat Ibrahimi me titull "Filozofët Myslimanë";[8] librin e artikujt e Xhemal Ballës rreth jetës dhe veprës së tij;[9] interesimin e studiueses franceze Nathalie Clayer për veprën e tij dhe të bashkëkohësve të tij si Ferit Vokopola, Sherif Putra,[10] etj.

2. Veprimtaria e Vexhi Demirajt
a. Shkrimet teologjike
Revista Zani i Naltë

Profesor Vexhiut, me futjen në Medresenë e Tiranës iu hapën horizonte të reja dhe do të fillonte të angazhohej edhe në fushën e shkrimit. Është autor i shumë artikujve në revistat më në zë të kohës, njëkohësisht edhe organe të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Në vitin e fundit të shkollës ai do të angazhohej me një seri shkrimesh në revistën *Zani i Naltë*. Viti 1932, viti i diplomimit të tij, e afirmoi Vexhiun, si një student të pjekur e të formuar, tashmë me një kulturë të spikatur, duke u renditur në rubrikat e revistës në fjalë, bashkë me pedagogët e tij. Kështu, dallohen artikujt: "Myzhde për myslimanët"; "Pse duhet të jemi fetar"; "Ç`urdhëron Kurani"; "Islamizmi mbas një shekulli" – përkthim nga George Bernard Shaw, dhe më pas do të vinte me temën e mbrojtjes së diplomës "Agjërimi" me të cilën do të vlerësohej "Lavdërueshëm". Këtu mund të përmendim një eveniment të rëndësishëm për Medresenë e Tiranës. Më 5 janar të vitit 1932, bëhet inaugurimi i ndërtesës së re, dhe, me këtë rast, përzgjidhet përsëri për të përshëndetur studenti Vexhi Demiraj, fjala e të cilit do të botohej në revistën *Zani i Naltë*.

b. Shkrimet filozofike
Revista Kultura Islame

Interesi dhe pasioni për dijen bëri që profesor Vexhiu të merret edhe me probleme studimore e shkencore, veçanërisht në fushën e filozofisë. I admirueshëm është fakti se studiuesve të sotëm ju kanë tërhequr vëmendjen punimet origjinale të tij mbi katër nga filozofët myslimanë të botuar në revistën "Kultura Islame", si: El-Kindiu, El-Farabiu, Ibni-Sina dhe El-Gazaliu. Ai i konsideron ata si pionierë të ringjalljes së filozofisë në botën islame dhe shprehet kështu për ta:

"Duke i studiuar një e nga një këta filozofë myslimanë, do të formojmë bindjen se sa i vlefshëm ka qenë fryti i tyre, se sa e çmueshme ka qenë përpjekja e tyre e se sa toleruese kanë qenë mësimet e Islamit."[11]

7. Gazeta "Jeta e Re", Egjipt, korrik 1937.
8. Demiraj, Vexhi, "Filozofët Muslimanë", përgatiti Nexhat Ibrahimi, Prizren 1990.
9. Shih. kreu i kapitullit II.
10. Xhemal Balla, 237.
11. Po aty, 65.

Sipas Vexhi Demirajt, teologjia përbën pikënisjen e filozofëve myslimanë, duke shtruar para tyre çështje shumë të rëndësishme si ekzistenca e Zotit, dijet rreth botës ku jetojmë, njësimi apo format e tjera të ekzistencës së Zotit, përputhjen e shpalljes me arsyen, etj.

c. Shkrimet filozofike Revista Njeriu

Në numra të ndryshëm të revistës "Njeriu" Vexhi Demiraj ka analizuar probleme të ndryshme të filozofisë, si metafizika, materializmi, filozofia pozitive, revolucioni shkencor, çështje të ndryshme rreth moralit.

Në analizën e tij mbi metafizikën ai përpiqet të hedhë dritë mbi çështje të ndryshme në lidhje me ekzistencën, si realiteti i ekzistencës, mënyra dhe zanafilla si ajo ekziston, etj.

Një rëndësi të veçantë i kushtohet edhe analizës së pozitivizmit dhe përfaqësuesit të tij August Comte. Sipas profesor Vexhiut pozitivizmi nuk njeh diçka përtej kufirit të diturisë pozitive, ajo e pohon ekzistencën e një fuqie dominuese në natyrë, por ajo shkencë që ka si subjekt këtë fuqi përtej kufijve të shkencës (pra metafizika), është një dituri që nuk mund të kuptohet.[12] Këtu kuptojmë se pozitivizmi e mohon metafizikën dhe e quan të pakuptueshme nga ndonjë shkencë a dituri fuqinë e mbinatyrshme të panjohur.

12. Po aty, 103.

Në artikullin mbi revolucionin që ndodhi me parimet e reja te matematikës dhe fizikës, Demiraj thotë se ligjet e tyre u konsideruan si një revolucion i idesë për kozmosin dhe se ky revolucion e kapërcen aspektin shkencor. Filozofia e këtij shekulli e konsideron matematikën si modelin e mendimit të vërtetë, duke i dhënë përparësi arsyes për të arritur tek e vërteta.[13]

Përsa i përket aspektit moral, Vexhi Demiraj analizon dekadencën morale në Evropë pas revolucionit shkencor dhe zhvillimeve të njëpasnjëshme. Ai shprehet se Evropa nuk njihet për krijimtari, por për zhvillim të krijimeve të të tjerëve. Por ky zhvillim krahas aspekteve pozitive, mbart edhe anët e tij negative, ku më i rëndi është dekadenca morale tek individi, familja e shoqëria, gjë që çon në shkatërrim të njerëzores brenda njeriut duke e kthyer atë në një qenie të ftohtë.[14]

d. Përkthime

Vexhi Demiraj ishte njohës shumë i mirë i tre gjuhëve të huaja: arabisht, anglisht, frëngjisht. Krahas mësimdhënies, hartimit të teksteve mësimore dhe shkrimit të artikujve të ndryshëm në revistat më në zë të asaj kohe, ai ka përkthyer edhe disa vepra në gjuhën shqipe nën Komunitetin

13. Po aty, 106.
14. Po aty, 111-112.

Mysliman të atëhershëm. Ndër to janë: "Islamizmi dhe reforma n'Egjypt" nga Dr. Charles Adams, ku parathënien e librit të përkthyer e ka shkruar kryetari i Komunitetit Mysliman të asaj kohe Dr. Behxhet Shapati, i cili flet për pikëpamjet teologjike dhe filozofike të Xhemaluddin Afganit dhe Muhamed Abdos[15]; "Natyra-Dialog ne mes të filozofit e të natyrës", ku trajtohet një dialog i supozuar mes natyrës dhe filozofit rreth vetë natyrës, ekzistencës së saj[16]; "Islamizmi mbas një shekulli" i George Bernard Shaw, një ateist i cili bën një analizë të principeve të Islamit dhe në bazë të tyre guxon të bëjë një parashikim:

"Anglia, veçanërisht, dhe pjesa tjetër e botës përgjithësisht, janë të destinuar të përqafojnë islamizmin."[17]

3. Pikëpamjet filozofike të Vexhi Demirajt

3.1 Filozofia e fesë

Në shkrimet e tij filozofike, Vexhi Demiraj ka trajtuar më shumë çështje e problematika të filozofisë së fesë. Shkrimet e tij rreth kësaj filozofie janë botuar në revistën *Kultura Islame* dhe *Njeriu*.

Në shkrimet e tij mbi filozofinë e fesë ka trajtuar tema të ndryshme si marrëdhënia fe-arsye, fe-shkencë, pozotivizmin, metafizikën, etj. Edhe në këtë çështje, qasjet e tij ndaj filozofisë së fesë do t'i trajtojmë në bazë të shkrimeve të tij, duke filluar me revistën *Kultura Islame*, më pas me revistën *Njeriu*.

3.2. Kultura Islame

a. Problemi fetar dhe filozofija

Në këtë shkrim[18] Vexhi Demiraj përpiqet t'i japë përgjigje pyetjes bazë të metafizikës dhe filozofisë: "Kush e krijoi gjithçka?" dhe përpiqet të argumentojë ekzistencën e kahershme dhe të domosdoshme të fesë. Fillimisht bën një përmbledhje të pikëpamjeve të filozofëve që nga lashtësia, por thotë se këto pikëpamje as që i afroheshin të vërtetës së krijimit. Një shpjegim i tillë, i cekët dhe i sipërfaqshëm, nuk e kënaq njeriun për shumë kohë, pasi ai vazhdon dhe kërkon rreth kësaj të vërtete. Shkakun e ekzistencës janë munduar ta shpjegojnë edhe doktrina të tjera, si: atomizmi, teizmi, racionalizmi, panteizmi, etj., por teorinë më të plotë mbi krijimin e gjithësisë na e sjell teizmi, thotë Vexhi Demiraj. Të gjitha ndjesitë njerëzore kanë nevojë të besojnë në ekzistencën e një Fuqie Supreme, por të padukshme.

Ai sjell si argument shkrimet e filozofit anglez Herbert Spencer, i cili thotë se gjatë gjithë historisë së

15. Po aty, 152.
16. Po aty, 209.
17. Po aty, 213.

18. Demiraj, Vexhi, "Problemi fetar dhe Filozofija I", *Kultura Islame*, viti I, nr. 3, nëntor ٩٧-٩٢ ,١٩٣٩.

njerëzimit, nuk ka epokë ose popull, ku të mos kenë ekzistuar besimet fetare. Ky është një argument se ata nuk kanë ekzistuar rastësisht. Sipas tij dhe shumë të tjerëve, tendenca e për të gjetur krijuesin dhe ndjesitë fetare kanë ekzistuar që kur njeriu filloi të orientohej në natyrë.

Ka disa kritikë që mendojnë se feja ka filluar të ekzistojë kur mendja e njeriut kishte arritur një shkallë të konsiderueshme të mendimit, duke u nisur nga fakti se ekzistojnë fise njerëzish të egër që tek të cilët nuk ekziston mendimi mbi Krijuesin e gjithësisë. Vexhi Demiraj thotë se pjesa e dytë e mendimit të tyre, e hedh poshtë atë mendim. Nëse pranohet se feja lind prej zhvillimit mendor, atëherë duhet të pranojmë se ajo ka ekzistuar që kur mendja ka ekzistuar.

Ekzistenca e feve të ndryshme, thotë Demiraj, të cilat kanë lindur të pavarura nga ato të mëparshmet ose krijimi i mendimeve të njëjta të popujve në rrethana të njëjta, është argument i lidhjes së fesë me mendjen dhe ekzistencën e tyre paralele.

Më pas vazhdon të argumentojë se feja nuk është një institucion pa baza të shëndosha, përndryshe shkenca do ta kishte rrëzuar me kohë themelin e besimit të saj dhe ndjenjat fetare, që mund të shfuqizohen në një popull të caktuar, nuk do të kishin dalë sërish në një formë tjetër.

Janë pikërisht këto ndjenja fetare ato që e lindin nevojën për fe dhe na çojnë automatikisht te pyetja: "Nga erdhën këto ndjenja fetare?" Në vazhdim të shkrimit[19], Demiraj thotë se cilado të jetë përgjigjja, nuk mund të mohohet se këto ndjenja fetare kanë qenë shkak i lumturisë, qetësisë dhe shpresës së njerëzve gjatë gjithë historisë njerëzore. Ai arrin në përfundimin se:

"…Ekzistenca e ndjesivet fetare, sido që të jetë burimi i tyre, si edhe tendenca e fuqisë mendore për me kuptue sende jashta botës landore, të gjitha këto janë fakte që vërtetojnë më së miri se në fetë, përgjithësisht, eksistojnë baza të shëndosha, që e drejtojnë njerinë kah realizimet e vlefshme për dinjitetin e tij njerzuer. Të gjitha këto janë fakte që lejojnë me kuptue realitetin themeluer, mbi të cilin janë bazue të gjitha fetë dhe që asht: udhëheqja e njerzisë kah fusha e lumtërisë së përhershme."

Më pas vazhdon me shpjegimin e katër doktrinave filozofike që merren me shqyrtimin e problemit filozofik: atomizmin, për të cilin shprehet se është një doktrinë e gabuar dhe se prej saj ka lindur materializmi; teizmin, për të cilin thotë se është baza e të gjitha feve dhe në shkrimet e tij kuptohet së është doktrina që ai ndjek; racionalizmin, i cili ngulmon në kotësinë e idesë së ateistëve,

19. Demiraj, Vexhi, "Problemi fetar dhe Filozofija II", *Kultura Islame*, viti I, nr. 4, dhjetor 1939, 139-143.

të cilin e gjen në pajtueshmëri me teizmin, përveç idesë së mendja mund ta gjejë ekzistencën hyjnore pa ndihmën e shpalljes; panteizmin, i cili e shikon Zotin në çdo krijesë.

Në fund, Demiraj cek një problem: distancën mes njerëzve dhe realitetit fetar. Ai thotë se një pjesë e njerëzve dhe pseudo-intelektualëve, siç i quan ai, kanë nxjerrë prej realitetit të fesë vetëm konkluzionet që përfaqësohen në shërbimet fetare, duke mos iu afruar thelbit të fesë, i cili përmbledh sintezën e të gjithë virtyteve. Ata e konsiderojë fenë si një fantazmë që tmerron dhe pengon aspiratat njerëzore për të përfituar nga begatitë dhe dhuratat e natyrës. Kështu ata synojnë ta largojnë fenë nga njeriu.

b. Realiteti i fesë

Në këtë shkrim[20], Vexhi Demiraj përpiqet të analizojë realitetin e fesë dhe domosdoshmërinë e saj. Ai fillimisht thotë se baza e fesë ka një ndikim në thellësinë e shpirtit të njeriut. Vetë njeriu përbëhet nga lënda dhe shpirti dhe se ky shpirt vihet në kontakt me Shpirtin e universit. Ky kontakt është baza e fesë. Duke qenë se ky kontakt është i natyrshëm, sado që të përpiqemi nuk mund të zhduket. Për ta argumentuar këtë ai paraqet disa ide të filozofëve. Njëra prej tyre është ideja e filozofit Ernest Renan:

"Ka mundësi të zhduket çdo gjë që e duam dhe çdo gjë që e konsiderojmë prej kënaqësive dhe prej të mirave të kësaj jete. Mundet që t'a humbasim lirinë e veprimit të tyre, si fuqitë mendore, ashtu edhe fuqitë industriale, por asht e pamundur që të zhduket feja; ajo do të mbetet përgjithmonë, një argument i fortë për zhvleftësimin e Doktrinës së Materializmit, e cila dëshiron t'a kufizojë mendimin e njeriut në ngushticat e jetës tokësore."

Ai thotë se të tilla argumente shkencore dhe filozofike janë të panumërta. Të gjithë ata që gjykojnë drejt dhe pa gabim nuk shohin te feja, veçse një udhëheqëse të drejtë të njerëzimit. Por gjithsesi, ekzistojnë njerëz me prirje të ndryshme, të cilëve nuk ju pëlqen frenimi dhe lufta që feja i ka shpallur imoralitetit.

c. Revelacjoni dhe shkenca

Në këtë shkrim[21], Vexhi Demiraj përpiqet të argumentojë përputhshmërinë mes shpalljes hyjnore dhe shkencës. Ai thotë se ka shumë skeptikë në lidhje me këtë çështje dhe se ka shumë persona që iu duket si një problem shumë i vështirë për t'u zgjidhur e kuptuar. Ky është një problem i të gjitha feve hyjnore, por për ata që duan të kuptojnë, drita e pashterur e dashurisë ndaj Zotit e

20. Demiraj, Vexhi, "Realiteti i fesë", *Kultura Islame*, viti I, nr. 5, janar 1940, 172-176.

21. Demiraj, Vexhi, "Revelacjoni dhe shkenca", *Kultura Islame*, viti I, nr. 10-11, qershor-korrik 1940, 389-393.

vërteton më së miri këtë mister. Janë disa mendje që janë zhytur thellë në oqeanin shurdhues të materializmit, të cilët nuk kuptojnë jo vetëm shpirtin e gjithësisë, por edhe vetë lëndën, së cilës ia atribuojnë përjetësinë.

Për të treguar lidhjen e shpirtit të krijesave me Shpirtin e gjithësisë, Demiraj na sjell shembuj nga bimësia, kafshët e njerëzit. Ai thotë se po t'ia tregojmë një personi, që ka jetuar gjithë jetën i veçuar, një farë të mollës dhe t'i themi që nga kjo mbin një pemë që jep fruta, ai nuk do ta besonte. Dhe ka plot të drejtë të mos e besojë se si një farë e vogël, përzgjedh lëndët në tokë për të formuar drurin, degët, gjethet, frutat.

Më pas ai jep shembuj nga kafshët, të cilët nuk kanë arsye dhe veprojnë përmes frymëzimit, duke thënë se kush i orienton të veprojnë në mënyrën e duhur për jetesën e tyre. Pastaj kalon te njeriu, duke theksuar se kur lind është i zhveshur nga dijet e njohuritë dhe se ato i mëson gjatë jetës. Prandaj shpallja hyjnore mori një trajtë më të përshtatur me dinjitetin e njeriut, ndryshe nga inspirimi që iu vjen kafshëve.

Fakti se në secilin prej nesh ndodhet një fuqi më e lartë se mendja njerëzore, është i pranuar gjerësisht nga studiuesit seriozë dhe shkencëtarët. Ajo është një fuqi mendore që e drejton njeriun nga e mira, e largon nga e keqja dhe drejton trupin e organet e tij.

3.3. Njeriu
a. Filozofija positive

Në shkrimin mbi filozofinë pozitive[22], Vexhi Demiraj na flet rreth themeluesit të pozitivizmit, francezit August Comte dhe qasjeve të tij filozofike. Sipas tij pozitivizmi nuk njeh diçka përtej kufirit të diturisë pozitive; ajo e pohon ekzistencën e një fuqie dominuese në natyrë, por ajo shkencë që ka si subjekt këtë fuqi përtej kufijve të shkencës (pra metafizika), është një dituri që nuk mund të kuptohet. Këtu kuptojmë se pozitivizmi e mohon metafizikën dhe e quan të pakuptueshme nga ndonjë shkencë a dituri fuqinë e mbinatyrshme të panjohur. Demiraj thotë se qëllimi i Comte ishte të shpëtonte shkencën nga idetë metafizike.

Sipas Comte, filozofia ishte një logjikë e shkencave dhe kishte si objekt të ndërtonte të vërtetën mbi bazën e përvojës shqisore nëpërmjet vëzhgimeve. Pozitivizmi, si filozofi, bazohet në vëzhgime dhe eksperimente në interpretimin dhe shpjegimin e ekzistencës. Ai merr parasysh vetëm dijet pozitive, që vijnë nga perceptimet shqisore, dhe nuk njeh rrugë tjetër në kërkimin e dijes përveç asaj empirike. Pozitivistët pretendojnë se ekzistenca përcaktohet nga ligjet e natyrës dhe se, në vetvete, nuk ka fuqi metafizike apo shpirtërore.

22. Demiraj, Vexhi, "Filozofija positive", *Njeriu*, viti I, nr. 6, dhjetor 1942, 11-13.

Vexhi Demiraj nuk pajtohet me idetë e pretendimet e pozitivizmit, pasi ato bien ndesh me shpalljen hyjnore. Madje ai thotë se pozitivizmi është në kundërshtim me historinë e filozofisë dhe shpjegimet e saj, madje shkon më tej duke thënë se është në kundërshtim me zhvillimin mendor të njeriut. Sipas tij Comte meritat i ka në sociologji, duke qenë se konsiderohet si themeluesi i sociologjisë.

b. Probleme të metafizikës-Materializmi

Në shkrimin e tij rreth materializmit[23], Vexhi Demiraj shpjegon se koncepti materializëm ka ardhur nga studimi i botës fizike e materiale. Siç u cek edhe më lart, një ndikim mjaft të madh mbi materializmin ka pasur edhe atomizmi. Për materialistët, lënda është gjithçka që ekziston. Çdo gjë në gjithësi është material dhe nuk ka të bëjë aspak me ndonjë ekzistencë shpirtërore ose metafizike. Ekzistenca shpjegohet vetëm duke marrë si bazë materien dhe duke mos e llogaritur shpirtin dhe ndërgjegjen. Materializmi i mohon të gjitha konceptet e krijimit të pranuar nga feja e metafizika dhe pretendon se gjithçka funksionon sipas ligjeve të natyrës. Kështu materializmi mbështetet mbi teorinë e evolucionit.

Siç e pamë edhe më lart, Vexhi Demiraj është krejtësisht kundër ideve materialiste, madje thotë se me anë të shkrimeve të tij do të përpiqet ta kundërshtojë atë. Ai analizon idetë materialiste të cilat vënë në qendër materien, por thekson se këto ide janë doktrina imagjinative (imagjinare) dhe çdo doktrinë që do të ngrihet mbi këto themele të kalbura nuk ka vërtetësi dhe jetëgjatësi, pasi edhe vetë dijetarët materialistë nuk e dinë me saktësi se cila është substanca e materies.

Në pjesën e tretë të shkrimit, Demiraj sjell prova nga shkencëtarë evropianë të kimisë, të cilët kanë studiuar molekulën, e cila përbëhet prej atomeve. Deri para disa shekujsh atomi mendohej të ishte njësia më e vogël dhe se ishte i pandashëm, ashtu siç mendonin edhe atomistët e lashtë, doktrinë prej të cilës thamë se është ndikuar materializmi. Më vonë u zbulua se atomi përbëhej prej elektroneve, protoneve dhe neutroneve. Kështu themeli i kalbur, siç e quan Vexhi Demiraj, i materializmit u shemb.

Nga këto studime u zbulua se lënda nuk është e paraqenë dhe e as e përhershme. Në fund, Demiraj shprehet se pas reformimit të filozofisë, ajo dhe feja u afruan. I vetmi pengim, që e ndalonte bashkimin e të dyjave, ishte doktrina materialiste mbi origjinën e ekzistencës.

23. Demiraj, Vexhi, "Probleme të metafizikës I", *Njeriu*, viti I, nr. 8, shkurt 1943, 8-9; "Probleme të metafizikës II", *Njeriu*, viti I, nr. 10, prill 1943, 4-5; "Probleme të metafizikës I", *Njeriu*, viti II, nr. 1, korrik 1943, 11-12.

3.4 Filozofia Islame

Vexhi Demiraj, në shkrimet e tij filozofike, ka trajtuar edhe filozofinë islame. Shkrimet e tij rreth kësaj filozofie janë botuar në revistën *Kultura Islame*. Nuk mund të themi se ka shumë shkrime rreth filozofisë islame, (mendoj më së shumti prej kushteve historike në të cilat ka jetuar), sepse aftësitë e tij në këtë fushë ishin mjaft të mëdha. Në shkrimet e tij mbi filozofinë islame ka trajtuar historinë e filozofisë islame dhe jetën e katër filozofëve të mëdhenj myslimanë: El-Kindi, El-Farabi, Ibn Sina, El-Gazali.

Studimi ndaj pikëpamjeve të tij ndaj filozofisë islame është ndarë ndarë sipas titujve të artikujve të tij.

a. Filozofija Islame

Në këtë shkrim[24], Vexhi Demiraj bën një përshkrim të përgjithshëm të historisë së filozofisë islame. Fillimisht përshkruan mjedisin kulturor e fetar të Gadishullit Arabik para ardhjes së Islamit. Më pas përshkruan zhvillimin e kulturës, shkencës dhe filozofisë në periudha të ndryshme të sundimit të dinastive myslimane. Ku thekson se deri në kohën e sundimit Abasid, myslimanët u thelluan më së shumti në çështjet e fesë. Ai rendit tre arsye se përse i kushtuan më shumë rëndësi çështjeve fetare:

1. Myslimanët e dinin se suksesi i tyre i kushtohej energjisë dhe gjallërisë së fesë së re.

2. Me zgjerimin e kufijve të Islamit lindën probleme të reja, të cilat nuk kishin qenë në kohën e Profetit a.s., që kërkonin zgjidhje.

3. Kur'ani i inspironte që të studionin me qëllim që t'u lehtësonin vuajtjet dhe vështirësitë të tjerëve.

Nga fundi i epokës së Emevitëve, myslimanët u morëm më shumë me çështje metafizike dhe teologjike. Mirëpo bisedime të tilla akademike dhe polemika shkencore shkaktuan ndasi mes myslimanëve, ku secila palë përpiqej të mbronte tezën e saj me argumente fetare e logjike.

Si shkak kryesor të interesimit të myslimanëve ndaj kulturës dhe filozofisë, Demiraj, citon Kur'anin. Ai thotë se Kur'ani me versetet e tij, që nxisin rreth mendimit dhe arsyetimit, ishte faktori më me rëndësi, që nxiti në afrimin e myslimanëve me filozofinë. Kur'ani është i vetmi libër hyjnor, që ia ka vënë detyrim ndjekësve të tij të jepen pas filozofisë e kulturës, duke i nxitur të mendojnë rreth sekreteve të rruzullit dhe ekzistencës, mbi pavdekshmërinë e shpirtit, ekzistencën e një jete tjetër, etj.

"Ç'ndryshim mund të gjejmë në mes të filozofisë, q'i fton besnikët e saj me u mendue dhe me arsyetue mbi krijimin e botës, mbi pafundësinë dhe madhërinë e rruzullit dhe mbi rregullin e harmoninë e tij dhe në

24. Demiraj, Vexhi, "Filozofija Islame", *Kultura Islame*, viti IV, nr. 3, Nëntor-mars 1942, 58-60.

mes të thirrjes, që na banë Kurani i shenjtë në sa e sa vërsete të ndryshëm, me anë të të cilëvet na fton me vrejtë krijesat dhe me arsyetue mbi ligjët e pandryshueshme, që rregullojnë mbarëvajtjen e tyne?"

Ai vazhdon duke thënë se i gjithë ky interesim ndaj filozofisë ka qenë inspirim i Kur'anit, i cili i detyroi dhe i la të lirë myslimanët në veprën e tyre të kulturës. Feja Islame nuk e kufizoi mendimin e lirë të myslimanëve.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që nxiti myslimanët të merrem me filozofi është edhe përkthimi i veprave të kulturave greke, persiane dhe indiane në gjuhën arabe. Këto vepra jo vetëm që u përkthyen nga myslimanët, por edhe u studiuan dhe komentuan prej tyre, duke dhënë kështu një kontribut shumë të madh në zbërthimin e plotësimin e tyre.

Ndër rrymat që ndikoi më së shumti filozofët myslimanë ishte neo-platonizmi. Pavarësisht ndikimit të Aristotelit dhe Platonit, neo-platonizmi kishte ndikim më të gjerë mbi myslimanët, sepse ishte më i përhapur në vendet ku ata jetonin, sidomos në Aleksandri ku kishte edhe qendrën, dhe se kishte ngjyra fetare. Pas studimit të neo-platonizmit, myslimanët filluan të studiojnë Aristotelin dhe Platonin.

Merita e myslimanëve në fushën e kulturës dhe filozofisë është shumë e madhe, jo vetëm për përkthimin dhe ruajtjen e kulturës dhe dijes së popujve të qytetëruar të asaj kohe nga vorbulla e shkatërrimit dhe harresës, por edhe për veprën e tyre personale, për shpikjet dhe kontributin e tyre të paçmueshëm. Shumë prej veprave dhe studimeve greke nuk do të kishin arritur dot deri te evropianët, pa u përpunuar më parë prej myslimanëve. Shumë shpikje, që njihen si themeli i qytetërimit evropian, janë shpikur nga myslimanët.

b. El-Kindiu

Në shkrimin e tij rreth Kindiut[25], Demiraj flet rreth jetës dhe veprës së tij kryesisht. Duke qenë se përgjithësisht informacionet rreth Kindiut nuk janë të shumta, ky shkrim nuk është shumë i gjatë.

Kindiu konsiderohet si ndër të parët filozofë myslimanë që ka ndjekur rrugën e Aristotelit. Kontributi i tij kulturor dhe filozofik nuk njihet vetëm prej myslimanëve, por edhe prej perëndimorëve. Madje disa dijetarë perëndimorë e konsiderojnë si njërin prej njerëzve më të zgjuar të botës.

Kindiu, përveç shkrimit të veprave të tij, ka përkthyer shumë vepra filozofike në gjuhën arabe, veçanërisht të Aristotelit, të cilat aty ku e shihte të arsyeshme iu bënte edhe komente.

25. Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Myslimane", *Kultura Islame*, viti IV, nr. 8, prill 1943, 106-107.

Ai ishte i pari që ju doli kundër alkimistëve[26], duke e konsideruar këtë si një angazhim të kotë, si shpenzim kohe dhe pasurie. Vexhi Demiraj duket se e mbështet këtë qëndrim të Kindiut, duke e quajtur atë "më të logjikshëm" në shprehjet e tij kundër alkimisë dhe më të rreptë se Ibn Sina.

Gjatë jetës së tij, Kindiu ra viktimë e shumë kurtheve e intrigave, por ai nuk ua ktheu me të njëjtën monedhë atyre që i thurën. Përkundrazi, ai vazhdoi të studionte e të thellohej në dije, aq sa, më vonë, njëri prej kundërshtarëve të tij më të mëdhenj u bë nxënësi i tij. Vexhi Demiraj e vlerëson këtë qëndrim të tij duke thënë:

"Asht nje prej virtytevet ma të nalta me i ba mirë atij, që mundohet me të ba keq, por janë të rrallë ata, q'e ushtrojnë një virtyt të tillë."

26. Alkimia është një disiplinë shkencore e cila merret me kthimin e metaleve në ar dhe shërimin e të sëmurëve. Njëkohësisht është edhe një disiplinë shpirtërore filozofike e cila me anë të metaleve dhe lëndëve të tjera natyrore synon të zbulojë eliksirin e përjetësisë (pancea). Ka ekzistuar që në lashtësi dhe me kalimin e kohës është përhapur në botën islame e më pas në Evropë. Kjo disiplinë ka pasur mjaft kritika, përsa i përket pretendimit të tyre për të gjetur eliksirin e përjetësisë, por ka gëzuar edhe respekt për shkak të kontributit që ka dhënë në shkencën e kimisë.

c. Farabi

Në shkrimin e tij për Farabin[27], Vexhi Demiraj flet për jetën, veprën dhe pikëpamjet e tij filozofike. Meritat e tij në fushën e filozofisë janë të mëdha, sepse ai i mblodhi dhe i sistemoi veprat e Aristotelit dhe i përktheu ato në gjuhën arabe. Ai kishte një mprehtësi mjaft të madhe logjike, saqë ia kalonte të gjithë filozofëve të tjerë me shpjegimet e tij të qarta dhe të sakta. Ka shkruar shumë vepra, por shumica prej tyre kanë humbur. Më e famshmja është "Esh-Shifa", e cila mësohej nëpër universitetet evropiane të para disa shekujve.

Vexhi Demiraj na thotë se në kohën e Farabit, filozofia islame kishte marrë dy drejtime: filozofët teologë dhe filozofët natyralistë. Farabi ishte kryetari i grupit të parë, i cili kishte si bazë metodën logjike në argumentim. Duke përdorur këtë metodë Farabi përpiqet të argumentojë ekzistencën e Zotit. Ai thotë se të gjitha njohuritë tona formohen prej të përfytyruarit dhe gjykimit, sepse çdo qenie e njohur, abstrakte apo konkrete, nuk mund të përfitohet në mendje, veçse nëpërmjet përfytyrimit dhe gjykimit. Qenia e të gjithë objekteve, mbi të cilën do të japim gjykim, mund të jetë ose e domosdoshme, ose e mundshme.

27. Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Farabi I", *Kultura Islame*, viti IV, nr. 9-10, maj-qershor 1943, 138-142.

Qenie e mundshme quhet ajo, ekzistenca e mosekzistenca e së cilës është e barabartë. Të tilla janë njerëzit dhe krijesat e tjera. Qenie e domosdoshme është mosekzistenca e së cilës është vetvetiu e pamundur. I tillë është vetëm Zoti.

Në vazhdim të shkrimit të tij mbi Farabiun[28], Vexhi Demiraj na tregon për qasjet e tij ndaj Zotit dhe krijimit. Farabi njihet si themeluesi i teorisë së emanacionit (dhjetë intelekteve) në Islam. Pas tij e kanë përqafuar shumë filozofë myslimanë të ndikuar nga Aristoteli dhe neo-platonizmi.

Sipas Farabit, Zoti ka krijuar intelektin e parë ose qenien e dytë. Kjo qenie është një substancë e thjeshtë, jolëndore, që ka fuqi të kuptojë veten dhe Zotin dhe të vihet në kontakt me Të e t'i kërkojë ndihmë Atij. Prej kontaktit të intelektit të parë me Zotin lind intelekti i dytë ose qenia e tretë, prej të kuptuarit të vetës së të cilit lind qielli i parë ose sfera qiellore. E kështu me radhë, në kontakt me Zotin lindin të dhjetë intelektet.

Demiraj thotë se Farabi, duke shpjeguar teorinë e tij të emanacionit, ka rënë padashje në gabim. Megjithëse Farabi e pranon se këto intelekte kanë ardhur prej Zotit, ai thotë se këto kanë ardhur nga Zoti ashtu siç vjen pasoja nga shkaku. Nëse krijimi është i tillë, atëherë duhet t'i heqim Zotit atributin e vullnetit (irade) për të bërë ose mosbërë diçka dhe duke e detyruar aftësinë e krijimit të Zotit me lidhjen shkak-pasojë, atëherë i kemi hequr lirinë e krijimit Zotit, duke e detyruar të veprojë në mënyrë të caktuar.

Vexhi Demiraj thotë se teoria e emanacionit të Farabit nuk është gjë tjetër veçse një përpjekje për pajtim mes parimeve të Aristotelit dhe parimeve të fesë. Në këtë mënyrë janë përpjekur të veprojnë të gjithë filozofët myslimanë që kanë përqafuar doktrinën e Aristotelit.

Parimet e Aristotelit mbi krijimin janë:

1. Prej të përsosurit mund të burojë vetëm e përsosura.
2. Prej njëjësit mund të burojë vetëm një send i vetëm.
3. Asgjëja nuk mund të prodhojë ekzistencë.

Ndërkohë e dimë se në librat fetarë, në këtë rast në Kur'an, Zoti përshkruhet si Krijuesi i gjithësisë dhe i shumë krijesave njëherësh. Sipas parimit të Aristotelit, që nga njëshi të dali shumësi, duhet të shumëzohet njëshi, ose të njësohet shumësi, gjë që është e pamundur. Prandaj, sipas këtij parimi, krijuesi i gjithësisë nuk mund të jetë Zoti. Ndërsa feja thotë të kundërtën.

I mbetur mes të dyjave, Farabiu krijon teorinë e emanacionit, e cila e përputh në fenë me parimet aristoteliane, duke thënë se nga Zoti lind intelekti i parë, i cili ka këto cilësi:

28. Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Farabi II", *Kultura Islame*, viti IV, nr. 12, gusht 1943, 213-215.

1. Është i vetëm, pasi ka buruar nga Zoti i Vetëm.

2. Është i përsosur, pasi ka buruar nga Zoti i përsosur.

3. Është efekt i Qenies së Paraqenë, prandaj nuk është krijuar nga asgjëja.

Sipas Vexhi Demirajt, një qëndrim i tillë jo vetëm që është në kundërshtim me fenë dhe filozofinë teiste, por edhe me logjikën, sepse e kufizon fuqinë krijuese të Zotit vetëm në krijimin e intelektit të parë.

Në pjesën e tretë të shkrimit mbi Farabiun[29], Vexhi Demiraj na flet rreth moralit sipas Farabiut. Farabiu thotë se morali ose etika është ajo shkencë e cila merret me bazat sjelljes. Ai shprehet se Zoti i ka dhënë mendjes së njeriut një fuqi të mjaftueshme për të dalluar të mirën nga e keqja. Nëse nuk do t'ia njihnim mendjes këtë aftësi, atëherë ajo nuk mund të jetë përgjegjëse para Zotit dhe as të meritojë dënimin ose shpërblimin e tij. Atëherë përse kjo mendje e caktuar prej Zotit mos ta caktojë sjelljen që duhet të ndjekim gjatë gjithë jetës, duke pasur parasysh se njohuria është virtyti më i lartë. Për ta vërtetuar këtë na sjell si shembull dy njerëz: njëri i njeh parimet e Aristotelit, por nuk sillet sipas tyre; tjetri nuk i njeh parimet e Aristotelit, por sillet sipas tyre. Sipas Farabit, i pari qëndron më lart se i dyti, sepse njohuria është më e vlefshme, me e mirë. Ai e konsideron vepër të mirë, atë të cilën mendja e pëlqen, e kundërta është vepër e keqe.

Vexhi Demiraj thotë se kjo teori e Farabit është në kundërshtim me parimet e dijetarëve të *Ehl-i Sunnet*-it, të cilët thonë se mendja nuk mund t'ia dalë e vetme të gjitha çështjeve, pa pasur ndihmën e shpalljes hyjnore. Në të vërtetë, njohuritë tona e kanë burimin në ndihmën që i japin mendjes shqisat tona. Por mund të ndodhë që shqisat të gabojnë, në këtë rast gjykimi i dhënë prej mendjes nuk mund të jetë i saktë, pasi është mbështetur në themel të kalbur.

d. Ibn Sina

Në shkrimin e tij rreth Ibn Sina-s[30], Demiraj na tregon për jetën, veprën dhe pikëpamjet e tij. Ai flet rreth tij me superlative duke thënë:

"Ay ka qenë një zheni e rrallë e krijueme për filozofi. Filozofët ndër popujt e tjerë i kanë arrijt realitetit mbas lodhjesh e përpjekjesh të pareshtuna studimi, por zgjuarësija dhe zhenija e Ibni Sinait lejuan që ky t'i jepte fund edukatës dhe kulturës së tij, kur ende nuk i kishte mbushur të njëzetë prandverat e jetës së tij."

Përsa i përket besimit të Ibn Sina-s, janë bërë shumë spekulime, por Vexhi Demiraj mendon se

29. Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Farabi III", *Kultura Islame*, viti V, nr. 1, shtator 1943, 11-13.

30. Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Ibn Sina-i I", *Kultura Islame*, viti V, nr. 4, dhjetor 1943, 107-110.

fjalët e dijetarit Xhurxhanij janë të vërtetat. Xhurxhanij thotë se kur Ibn Sina ishte në pamundësi të zgjidhjes së një problemi filozofik-shkencor, atëherë ai merrte abdes, shkonte në xhami dhe i falej e i lutej Zotit t'ia lehtësonte vështirësinë e zgjidhjes së asaj çështjeje. Vexhi Demiraj, në lidhje me këtë thotë:

"Mund të themi se besimi i tij ishte një pjesë e zhenisë së tij dhe se besimi në Zotin e Plotfuqishëm ishte një prej shkaqevet ma të forta të çfaqjes së kësaj zhenije."

Në pjesën e dytë të shkrimit të tij[31], Vexhi Demiraj na flet për filozofinë e Ibn Sina-s. Ibn Sina, si shumë filozofë të tjerë myslimanë, ka ndjekur filozofinë e Aristotelit dhe ka qenë i frymëzuar nga Farabi. Megjithëse në disa pika ka qenë i një mendimi me teologët, në lidhje me ngahershmërinë e botës ai është bashkuar me mendimin e filozofëve, të cilët mendojnë se bota është e ngahershme (e paraqenë/ezeli), me një ngahershmëri ndryshe nga ajo e Zotit. Gjithashtu bashkohet me tezën e Farabit mbi dhjetë intelektet, si mënyrë për të shpjeguar se si Zoti, i cili është Një, ka krijuar një shumëllojshmëri krijesash.

Siç e pamë edhe te Farabi dhe do ta shohim edhe më pas te Gazali, Vexhi Demiraj nuk i përkrah mendimet e filozofëve mbi ngahershmërinë e gjithësisë, dhjetë intelektet dhe qasje të tjera të ngjashme. Pavarësisht superlativave për zgjuarsinë, intelektin dhe veprën madhështore të Ibn Sina-s, ai përqafon mendimin e *Ehl-i Sunnet*-it në çështjet e metafizikës dhe teologjisë.

e. Gazali

Në shkrimin e tij mbi Gazalin[32], Demiraj na flet rreth jetës, veprës, përpjekjeve për të gjetur të vërtetën dhe kontributin e Gazalit në filozofinë dhe teologjinë Islame. Gazali, në librin e tij "El-Munkidhu min ed-Dalal", tregon se ka që në moshën 20 vjeçare që kërkon për të gjetur të vërtetën. Ai tregon përpjekjet dhe vështirësitë që hasi për të dalluar parimet dhe mësimet e filozofisë, të vërtetën dhe gënjeshtrën. Ai pati një periudhë dyshimi, që e çoi në mohim. Ai dyshonte për gjithçka dhe vetë mendja nuk arrinte ta bindte, sepse asgjë nuk e vërteton saktësinë e parimeve të saja dhe se ajo që na duket e vërtetë ose e drejtë me anë të mendjes ose ndjenjës është e tillë vetëm në lidhje me gjendjen ku ndodhemi. Por a jemi të sigurt, se pas kësaj gjendjeje nuk do të vijë një gjendje e dytë, e cila të na vërtetojë se gjendja e parë, të cilën e dinim të drejtë, është thjesht një ëndërr.

31. Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Ibn Sina-i II", *Kultura Islame*, viti V, nr. 5-6, janar-shkurt 1944, 132-134.

32. Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Gazali I", *Kultura Islame*, viti V, nr. 7-8, mars-prill 1944, 183-185.

Në fakt, Gazali doli nga kjo gjendje dyshimi, por jo duke përdorur mendjen. Ai u thellua në parimet e teologjisë, filozofisë dhe misticizmit, por prehjen dhe udhën e drejtë e gjeti vetëm te kjo e fundit.

Ai ka pasur një ndikim të madh në historinë e filozofisë islame, sepse braktisja e të gjitha ideve të fituara dhe dyshimi i shërbyen mjaft për të kritikuar ashpër parimet filozofike. Vexhi Demiraj thotë se një metodë të tillë, duke vënë në dyshim të gjitha idetë e fituara, me qëllim që më vonë t'i marrë një nga një e t'i kontrollojë për të gjetur idetë e gabuara dhe ato të sakta, Gazali e ka përdorur gjashtë shekuj para Dekartit (Descartes), cili konsiderohet si themeluesi i metodës së *dyshimit kartezian*, një metodë e skepticizmit metodologjik.

Vexhi Demiraj na tregon se qëllimi i shkrimit të veprës "Mekasid el-Felasife" nga Gazali është studimi dhe kuptimi i parimeve të filozofëve, përpara së të bënte kritikën e tij ndaj tyre, në mënyrë që t'i kuptonte idetë e tyre të gabuara dhe ato të drejta.

Më pas, në pjesën e dytë të shkrimit mbi Gazalin[33], Demiraj na tregon për kritikat e Gazalit ndaj filozofëve, metodën e tij dhe pjesën e fundit të jetës së tij.

Mesa kuptohet nga më lart, vepra tjetër e Gazalit "Tehafut el-Felasife" ka si qëllim kritikën ndaj filozofëve në rreth njëzet pika, të cilat i kemi përmendur në kapitullin e dytë të punimit. Metoda e tij e njohjes, fillimisht të ideve që do të kritikojë, analizimi i tyre në bazë të vërtetësisë dhe më pas kritika ndaj tyre, sjell një metodë të re filozofiko-shkencore, siç u tha më lart, gjashtë shekuj para Dekartit (Descartes). Prandaj, thotë Vexhi Demiraj, merita për zbulimin e kësaj metode duhet t'i jepet Gazalit dhe jo Dekartit (Descartes).

Gjithashtu, kur vërejmë metodën e tij të përdorur po në veprat e tij, shton Demiraj, kuptojmë se ai e ka përdorur rrugën e filozofisë gati shtatë shekuj para Dejvid Hjumit (David Hume). Po të marrim parasysh se Hjum (Hume) ka qenë frymëzuesi i Kantit, thotë ai, atëherë do ta kuptojmë më së miri vlerën filozofike të mendjes së Gazalit dhe influencën e tij te dijetarët evropianë. Ndonëse bota islame ka dhënë kontributin e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë mendore, vlera e këtij kontributi i është njohur të tjerëve dhe jo atyre që iu përket.

Në epokën e fundit të jetës së tij, Gazali ndoqi rrugën e misticimit. Vexhi Demiraj shprehet për atë rrugë si "rruga për të cilën ishte krijuar" Gazali. Ai u tërhoq dhe u dha pas studimit të veprave të mistikëve, duke u bindur se ajo ishte rruga e sigurt, e ndihmuar nga obligimet fetare, që shpie në njohjen e Zotit.

33. Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Gazali II", *Kultura Islame*, viti V, nr. 9, maj 1944, 251-253.

Vërejmë se Vexhi Demiraj ka një konsideratë të lartë për Gazalin dhe veprën e tij dhe duket se pikëpamjet e tij përputhen me të Gazalit, përsa i përket çështjeve të teologjisë, metafizikës dhe filozofisë. Madje edhe zgjedhjen e tij të fundit, duke zgjidhur rrugën e misticizmit, e quan si të duhur dhe rrugë të drejtë.

Përfundim

Ky studim është një përpjekje për të hedhur dritë mbi pikëpamjet filozofike të Vexhi Demirajt, përkatësisht filozofisë fetare dhe asaj islame.

Meritat dhe kontributi i Vexhi Demirajt në jetën intelektuale të Shqipërisë së para komunizmit janë të qarta dhe të pamohueshme për këdo që e ka njohur ose ka lexuar shkrimet e tij. Dilet në konkluzionin se në jetën e tij ka pasur dy fatkeqësi: njëra është periudha historike në të cilën ka jetuar dhe tjetra lënia në harresë e kontributit të tij. Të parën e them, sepse në kulmin e karrierës dhe krijimtarisë së tij, bota dhe përkatësisht Shqipëria, u përball me luftën e parë botërore dhe më pas me regjimin komunist. Kjo bëri që Demiraj të ndërpriste mësimdhënien në Medresenë e Tiranës dhe shkrimet e tij në revistat islame të kohës. Guxoj të imagjinoj se çfarë kontributi të madh do të kishte dhënë ai në fushën e filozofisë nëse kushtet historike do të kishin qenë të ndryshme.

Përsa i përket pikëpamjeve të tij rreth filozofisë së fesë, si teolog dhe mësues i filozofisë ai ishte totalisht kundër materializmit dhe teorive pozitiviste, e atomiste, të cilat mohonin krijimin e gjithësisë nga Zoti dhe vinin në qendër të gjithçkaje lëndën. Demiraj e quan themelin e tyre të kalbur dhe thotë se pretendimet e tyre rrëzohen shumë lehtë, madje këtë e ka vërtetuar edhe shkenca.

Vexhi Demiraj mendon se feja është një realitet i domosdoshëm për njeriun dhe është në natyrën e tij. Ai thotë se feja pajtohet me natyrën, logjikën dhe shkencën. Ajo ka qenë historikisht shkaku i lumturisë dhe ruajtjes së virtyteve më të mëdha njerëzore. Qëllimet për ta paraqitur fenë si diçka që pengon përparimin njerëzor dhe të papërputhshme me shkencën dhe logjikën, janë qëllime dashakeqe të bëra nga njerëz të zhytur në shurdhërinë e materializmit.

Pikëpamjet e tij në filozofinë islame shihet mjaft qartë në komentet e tij se përputhen me doktrinën e *Ehl-i Sunnet*-it. Ai ka një vlerësim dhe konsideratë mjaft të madhe për filozofët e mëdhenj myslimanë, të cilët kanë kontribuar në formimin dhe përparimin e mendimit filozofik, shkencor e teologjik, jo vetëm të botës islame, por edhe të Evropës, e cila i ka ngritur themelet e saj mbi këtë kontribut.

Pavarësisht kësaj konsiderate, ai nuk i kursen kritikat e tij ndaj pikëpamjeve të filozofëve mbi krijimin e gjithësisë, siç ishte teoria e emanacionit, mbi njohuritë, mbi ngahershmërinë e botës, etj. Ai ka një vlerësim mjaft të madh për dijetarin e shquar islam Imam Gazali dhe duket se pajtohet me pikëpamjet e tij, meqenëse edhe Gazali përkrah parimet e *Ehl-i Sunnet*-it. Madje e gjen me vend dhe të drejtë zgjedhjen e tij për t'iu përkushtuar misticizmit.

Në fund, shpresohet që ky kontribut sado i vogël e modest të ndihmojë në njohjen dhe kuptimin e veprës së Vexhi Demirajt. Gjithashtu uroj që punimet rreth jetës, veprës dhe pikëpamjeve të teologëve të para komunizmit të vazhdojnë edhe më tej. Mendoj se në këtë mënyrë mund ta shprehim sadopak mirënjohjen tonë ndaj tyre për kontributin e dhënë ndaj besimit, komunitetit mysliman dhe Shqipërisë.

Bibliografia

Balla, Xhemal, "Vexhi Demiraj, Mësues e Studiues i Teologjisë dhe i Filozofisë", Shtypshkronja "West Print", Tiranë 2015.

Balla, Xhemal, Vexhi Demiraj, mësues dhe studiues i diturisë Islame", Revista "Drita Islame", nr. 2, 2012.

Demiraj, Vexhi, "Filozofët Muslimanë", përgatiti Nexhat Ibrahimi, Prizren 1990.

Demiraj, Vexhi, "Filozofija Islame", *Kultura Islame*, viti IV, nr. 3, nëntor-mars 1942.

Demiraj, Vexhi, "Filozofija positive", *Njeriu*, viti I, nr. 6, dhjetor 1942.

Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Farabi I, II, III", *Kultura Islame*, viti IV, nr. 9-10-11-12, 1943.

Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Gazali I, II", *Kultura Islame*, viti V, nr. 7-8-9, 1944.

Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Islame-Ibn Sina-i I, II", *Kultura Islame*, viti V, nr. 4-5-6, 1943.

Demiraj, Vexhi, "Heronj të Filozofisë Myslimane", *Kultura Islame*, viti IV, nr. 8, prill 1943.

Demiraj, Vexhi, "Probleme të metafizikës I, II", *Njeriu*, viti I, nr. 8-10-11-12, shkurt 1943.

Demiraj, Vexhi, "Problemi fetar dhe Filozofija I, II", *Kultura Islame*, viti I, nr. 3-4, 1939.

Demiraj, Vexhi, "Realiteti i fesë", Kultura Islame, viti I, nr. 5, 1940.

Demiraj, Vexhi, "Revelacjoni dhe shkenca", *Kultura Islame*, viti I, nr. 10-11, 1940.

Gazeta "Drita Islame", nr. 14, gusht 1995.

Gazeta "Gjylistani", 7 korrik 1997.

Gazeta "Jeta e Re", Egjipt, korrik 1937.

Kolana "Zani i Naltë", vëll. III, botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Tiranë 2015.

Në kuadrin e dy përvjetorëve 160 vjetori i lindjes dhe 100 vjetori i ndërrimit jetë (1847—1917)

Hoxhë Voka i Tetovës, teolog, mësues, pedagog, mendimtar dhe atdhetar i shquar shqiptar

nga Prof. Dr. Musa Kraja*

Abstrakt

Ne përmendim hoxhallarë të hershëm, shehlerë, priftërinj, jezuit, fretër katolikë apo priftërinj të tjerë ortodoks, që kanë bërë emër, i kanë bërë nder popullit e vendeve të tyre, pa u zgjatur në emra, se janë nga më të njohurit në fushën tonë të edukimit, ku përfshihet edhe filozofia dhe shkencat e tjera, që u shkëputën prej saj në etapa të caktuara të zhvillimit të tyre.

Në interpretime të arsimit shqip Islam, ka pasur mendime të ndryshme, të krijuara në vende e zona të hapësirës shqiptare, ku nuk mungonin edhe qëndrime antishkencore, sepse disa plejada bijsh teologë të Shqipërisë dhe hapësirës shqiptare, që kanë shërbyer në vise të ndryshme të vendit e përtej, ndonëse kanë punuar me përkushtim të madh shpirtëror, si rrjedhojë e ndjenjave të fuqishme atdhetare dhe të besimit fetar, ju është mohuar kjo sakrificë dhe kjo ndihmesë e madhe atdhetare. Mohimi është bërë duke mbajtur qëndrime të heshtura, në shumicën e rasteve, sikur ata s'kanë jetuar e nuk kanë punuar gjë për Kombin, ose, duke i radhitur në kontingjentet e huaja joshqiptare, ndërsa në Shqipëri, edhe më egër, antishqiptare.

Pas proceseve demokratike, ndryshimeve të hartës politike, edhe në vendet e Ballkanit u intensifikuan lëvizjet, marrëdhëniet arsimore, kulturore, ekonomike, sociale mes qytetarëve të ndryshëm, përfshirë edhe marrëdhënie institucionale dhe nga shoqëria civile. Të njohur me kolegë, vëllezër tanë, në veprimtari studimore, na u krijuan mundësi të reja, tashmë pa kufizime në disa hapësira shqiptare edhe ne

*. Ky ishte artikulli i fundit, që Prof. Musa Kraja i dërgoi redaksisë së revistës Zani i Naltë, para se të ndërronte jetë në korrik 2017. Zoti e shpërbleftë për kontributin e dhënë në fushën e kulturës, pedagogjisë dhe publicistikës. Redaksia.

pedagogëve e studiuesve. Katedra e edukimit ku punoja, në emër të Universitetit tonë të Tiranës, më ngarkuan të drejtoja një grup shumë të vogël doktorantësh në Maqedoni, nga trevat shqiptare. Me atë rast, shkuarjet dhe pritjet u intensifikuan. Këto ndikuan në njohjen e drejtpërdrejtë të jetës sociale edhe të historisë së trevave të veçanta, e personaliteteve aktuale dhe të traditës. Unë kisha në punim e sipër një studim për zhvillimin historik të mësuesve shqiptarë, që nga mesjeta e deri në vitin 1944. Kisha qëndruar një kohë jo të të shkurtër në Arkivin e Shtetit, si dhe në burime të tjera arkivore, muzeale dhe bibliotekare. Mes tjerash, dëgjova dhe mësova më shumë për mësuesit tanë që kanë shërbyer në ato vise dhe për larminë e arsimit, përfshirë edhe atë të medreseve. Në Tetovë kisha dëgjuar e lexuar se ai institucion si shkollë fetare, me kulturë edhe të përgjithshme, përveç specifikave të arsimit të mesëm, kishte edhe ndonjë tipar të arsimit të lartë. Ky institucion lidhej edhe me personalitetin e Hoxhë Vokës së Tetovës (sepse është edhe një personalitet tjetër i rëndësishëm me të njëjtin emër në Dibrën e madhe: Hoxhë Voka i Dibrës, Said Najdeni). Në punimin tim, nuk kisha për objekt biografitë, por veprimtaritë e mësuesve të gjithë hapësirës shqiptare, madje edhe në diasporë.

Punën e mësuesit e të pedagogut, që në mesjetë, e më vonë e kanë ushtruar teologë të feve të ndryshme, që nga filloret e deri në universitete, madje disa prej tyre janë edhe personalitete në zona, vende apo kontinente të njohur e shumë të nderuar për veprimtarinë e tyre, përveçse si teologë, por edhe si mësues, pedagogë apo studiues.

Ne përmendim hoxhallarë të hershëm, shehlerë, priftërinj, jezuit, fretër katolikë apo priftërinj të tjerë ortodoks, që kanë bërë emër, i kanë bërë nder popullit e vendeve të tyre, pa u zgjatur në emra, se janë nga më të njohurit në fushën tonë të edukimit, ku përfshihet edhe filozofia dhe shkencat e tjera, që u shkëputën prej saj në etapa të caktuara të zhvillimit të tyre.

Nisur nga kjo klimë e re sociale, politike edhe te ne edhe në Maqedoni e më gjerë, plotësova studimin me njohuri jo vetëm arkivore, por edhe me teknika të tjera të studimit nga jeta e gjallë, apo nga memorialistika e moshave të ndryshme. Më ranë në duar edhe botime nga Rexhep Voka, duke më lënë mbresa libri "Mendime". Në studimin tim kisha shkruar edhe një kapitull, pikërisht të XII "Rexhep Voka - Tetova, Hoxhë Voka - mësues, hoxhë, iluminist atdhetar". Kuptohet, siç u tha në promovimin e librit me mbi 700 faqe të daktilografuara, sepse kompjuterët erdhën më vonë tek ne, ne Fakultetin e Shkencave Sociale të UT, në një auditor të gjerë profesorati, rastisën edhe dy-tre pedagogë të huaj, të cilët bënë edhe pyetje. U thanë "fjalë miradije", siç shprehet miku im i nderuar, Profesor Shkurtaj. Atje kisha trajtuar edhe idetë iluministe të Hoxhë Vokës. Libri u përfshi në kurrikulën universitare, si dhe u tërhoqën shumë ekzemplare edhe në hapësirën shqiptare, duke i bërë jehone në shtyp këtej e andej kufirit, përfshirë edhe Kosovën.

Në interpretime të arsimit shqip Islam, ka pasur mendime të ndryshme, të krijuara në vende e zona të hapësirës shqiptare, ku nuk mungonin edhe qëndrime antishkencore, sepse disa plejada bijsh teologë të Shqipërisë dhe hapësirës shqiptare, që kanë shërbyer në vise të ndryshme të vendit e përtej, ndonëse kanë punuar me përkushtim të madh shpirtëror, si rrjedhojë e ndjenjave të fuqishme atdhetare dhe të besimit fetar, ju është mohuar kjo sakrificë dhe kjo ndihmesë e madhe atdhetare. Mohimi është bërë duke mbajtur qëndrime të heshtura, në shumicën e rasteve, sikur ata s'kanë jetuar e nuk kanë punuar gjë për Kombin, ose, duke i radhitur në kontingjentet e huaja joshqiptare, ndërsa në Shqipëri, edhe më egër, antishqiptare.

Rexhep Voka, nga Shipkovica e Tetovës, një personalitet i shquar shqiptar, ka mbajtur një qëndrim të qartë e aktiv për shkollën e gjuhën amtare shqipe dhe për mbarë çështjen kombëtare. Si student i shkëlqyer që ishte, në shkollën e lartë teologjike në Stamboll, pas diplomimit e mbajtën atje si pedagog, praktikë e njohur kjo për universitetet kudo në botë, duke vazhduar veprimtarinë pedagogjike në fushën teologjike dhe më gjerë.

Që në Stamboll fillon veprimtarinë e tij arsimore e atdhetare, në kontakt me studentët shqiptare, me atdhetarë të tjerë, me interesimin e veçante që tregon për gjuhen amtare e zhvillimin e saj e të shkollës shqipe.

Në vitin 1895 ndodhet në Tetovë, i sinkronizuar me veprimtari me atdhetarët e shquar të Rilindjes sonë Kombëtare, të cilët pas zbatimit të tërheqjes me humbjen që pësoi Lidhja Shqiptare e Prizrenit, duke vazhduar një rruge tjetër lufte, me anë të dijes, rrugën iluministe, që theksuan rilindësit, si vazhdimësi, në

rrugën për zgjimin kombëtar. Filluan me intensitet veprimtarinë arsimore, si drejtim tepër i rëndësishëm për ruajtjen e zhvillimin e ndjenjave me idenë "fe dhe atdhe", duke ruajtur e konsoliduar harmoninë fetare e ndërfetare, për zhvillimin dhe emancipimin politiko-shoqëror të popullit. Rexhep Voka shkruante: "Për ne duhet të kemi shumë të qartë e të kujtohemi se për këtë komb do të vijë një ditë e do të pyetemi. Mos ta qesim prej zemre gjallënin e të kapim mirësinë e mbarësinë, të mos themi ky mysliman e një tjetër i krishterë, jo toskë, jo gegë, se të gjithë nji xhins jemi shqiptarë, jemi një fis e nji farë…"

"Duhet të merremi vesht ku ta kena nji anë çelë e ta zhvillojmë, çfarë të gjejmë e çfarë të bëjmë, se rrojtjen një e kemi, jo se humbet emni shqiptar, fiket edhe shqiptari në krye të tanë farave (fiseve e kombeve) e për jetë koritet. Prandaj të bashkohemi me nji prej nesh, veç, i ndamë të mos mbesë asnjë, se kemi një besë e kemi një shpresë."[1]

Ligjëratat që mban kanë në brendinë e tyre edhe këshillat që bashkëkombësit të arsimohen, prandaj lipset edhe kalem edhe dije. (Rexhep Voka "Mendime" f. 3, Tetove, 1991.)

Rexhep Voka ishte Myfti i Manastirit, pikërisht në ngjarjen e Madhe të Kongresit të Gjuhës Shqipe. Ai fillimisht ishte për gjuhën shqipe me alfabet turko-arab, me ndryshimet që i kishte bërë vet, i bindur se kishte bërë diçka origjinale. Siç shkruan Profesor Vehbi Bexheti, njohësi më i thelluar i këtij personaliteti "Kuptohet qëndrimi i tij tepër i vonuar në këtë fushë, por ai, siç shprehet edhe Profesor Koliqi, ndoqi programin politik të xhonturqve dhe nuk ishte i vetëm, madje, duke i parë me syrin e atyre viteve, shumë forca i mbështeten, ndonëse ai qëndrim, siç e vërtetoi koha, për arsyet që dihen, nuk ishte i drejtë. Pra, le të zbresim në bazën historike kur jetoi Voka, te faktorët kur u formua dhe më pas të shohim edhe evoluimin e mendimit të tij në këtë fushë. Mendime të tilla kishin edhe atdhetarë të tjerë, si Daut Boriçi në Shkodër apo Abdylhaqim Dogani në Gostivar, që botuan abetare shqipe me atë alfabet, edhe pse ishin atdhetarë të flaktë. Më vonë, ata që jetuan, si Abdylhaqim Dogani, botuan abetare shqipe me alfabet latin, me të cilin mësuan gjenerata të tëra e në vazhdim.

Edhe Hoxhë Voka, që fillimisht mbështeste politikën xhonturke, mbrojti qëndrimin e tyre për alfabetin e gjuhës shqipe me shkronja arabe. Kishte hartuar një alfabet të gjuhës shqipe me shkronja arabe, të plotësuar me shkronja të tjera që nuk i kishte arabishtja. Prandaj në vitin 1910 botoi "Abeja shkip" në dhjetëmijë kopje, si dhe "Elifbeja

1. Ndonjë fjalë tepër nëndialektale, është zëvendësuar M. K.

shqip". Në vitin 1911 botoi edhe librin tjetër "Gramatike elementare shqipe", si dhe librin "Mendime", me përmbajtje atdhetare, iluministe. Ka dëshmi që ishte penduar për mbrojtjen e alfabetit shqip me shkronja arabe, të siguruara nga Prof. dr. Nexhat Abazi, që shpjegohet edhe me përfundimin e tij nga Myfti i Manastirit si shitës lulesh e perimesh, në tregun e Stambollit. Pra, pas një përpunimi në vitet e fundit të jetës ka shprehur një progres të idesë së tij për alfabetin, sepse për gjuhën amtare shqipe ka qenë gjithnjë i patundur. "..të këndojmë edhe në gjuhën tonë.. nuk asht pa në tarihe e në jetë një popull që ka përparue e asht naltësu pa këndue në gjuhë të vet", është shprehur Hoxhë Voka.

Njeriu nuk është as nuk mund të jetë shabllon, o bardh, o zi. Dy qenie biosociale nuk mund të jenë njëlloj në personalitetin e tyre, por, vepra e shkruar dhe veprimtaria e aplikuar e tij, tregojnë që ai ka punuar aq shumë për të kultivuar unitetin mes shqiptareve, dëshirën për te mësuar dituri, pa të cilën nuk mund të kishte progres, zhvillim, për dinjitetin fetar dhe atdhetar, të cilat ishin "armët" kryesore kundër asimilimit kombëtar.

Ekzistojnë dokumente që Rexhep Voka ishte në krah të forcave reformatore, progresive për kohën, por evoluimi i ideve, rrjedhojë e qëndrimeve të tija ndaj kulturës dhe arsimit kombëtar, e çuan në shpërfilljen e autoriteteve të xhonturqve. Botimi i veprës së Hoxhë Vokës "Mendime" ka synime të veçanta për vlerësimin e arsimit e të kulturës, probleme, që ruajnë vlera aktuale për aspektet shkencore, filologjike, pedagogjike e fetare. Ai shkruan me dashuri për popullin shqiptar, e shqetëson gjendja e tij ekonomike dhe arsimore e kulturore tepër e ulët, krahasuar me fqinjët.

Le të ndalemi pak në veprimtarinë pedagogjike të Rexhep Vokës:

Së pari, si mësues që punoi me nxënësit e vet në medresenë e Tetovës, në ruzhdijen e Stambollit dhe si mesimdhënës në fakultetin teologjik u mor me procesin e gjallë mësimor edukativ për disa vite, duke u shquar si mësimdhënës që pasuroi dhe aktualizoi me mjeshtri brendinë e të mësuarit, përdori metoda bashkëkohore në komunikimin e ngrohtë me nxënësit. Veprimtaria e tij pedagogjike rrezatoi në disa breza pasardhës.

Së dyti, si veprimtari në fushën pedagogjike nëpërmjet punës studimore e me botimet e bëra për shkollat, si abetare, dhe me idetë pedagogjike që shprehu në veprën e tij "Mendime".

Së treti, nëpërmjet ligjëratave dhe bisedave që zhvilloi me njerëzit, në xhami me xhematin apo në kuvende burrash, në dhoma të miqve, dasma, morte a mbledhje shoqërore, ku mundohet për të ngritur kulturën

elementare pedagogjike familjare të prindërve. Edukatën morale tek të mëdhenjtë e të vegjlit e mbështeti te parimet e moralit islam dhe në mbarë traditën e pasur shqiptare në këto fusha. Profesor Vehbi Bexheti, autor i veprës "Rexhep Voka dhe vepra e tij, 1847—1917" shkruan se "Hoxhë Voka ka qenë ndër më të shquarit e trevës së Tetovës e më gjerë, si intelektual dhe iluminist, që ka shfaqur interes dhe ka zhvilluar aktivitet mendor e atdhetar për emancipimin e vetëdijes kombëtare, ngritjen arsimore të popullit shqiptar të asaj anë, ai luftoi për ta shpëtuar e nxjerrë nga procesi i asimilimit dhe i zhdukjes popullin e vet, të cilit i kanosej zhdukja prej qarqeve qeveritare, institucioneve të ndryshme shtetërore, kulturore e fetare të huaja, si dhe prej disa faktorëve të karakterit pansllavist dhe greko-ortodoks, që, në mënyrë konsekuente, vepronin për të penguar çdo veprimtari arsimore, kulturore apo politike, që ka qenë e natyrës shqiptare."

Rexhep Voka, si bartës i idealeve të Rilindjes sonë Kombëtare, si përfaqësues i iluminizmit Islam dhe Perëndimor, e shikon rrugën e shpëtimit të Kombit përmes zhvillimit në maksimum të institucioneve arsimore në te gjitha nivelet e mundshme, pa mbajtur qëndrim pritës, pa "pritur pallate të mëdha, por të bëhet e mundur që brezi ri e të tjerët të mësojnë, qe çdo komb të kultivojë fenë dhe gjuhën e vet… Njeriu e ka të pamundun të gëzoje qoftë edhe një ditë pa pasur mësime, këndime e fitim".

Hoxhë Voka, krahas detyres si teolog, ka lëvruar edhe në fushën e publicistikes, edhe si poet, etj. Të gjitha këto kanë si kolonë Atdheun e mbarësinë e tij. Në një poezi, mes tjerash shfaq edhe mallin e thellë për Atdhe:

" Nji nate ndeja ne kopesht aret
Cilli ishte fije aret
Edhe gjithesija ranun ne gjum
Deg e gjeth nuk levizte
Vec nje zog ja therriste
Kendim te bukur fort
Pri mallgjimit mu cuen lot
Zog i shkrete tue kenduar
Un ma teper tue mejtuar
Mendja vot e fluturoj
Posi shkendia me vrap shkoj
Ke memdheu ke Shqiperija
Ku ka vendin trimeria
Thash Zot o Zot i gjthsijs
Fal lirin edhe Shqiprijs
S'te vjen keq o Perendi
Se ka xhem e bijra e bi.."

Si rilindës i denjë, në shkrimet e tij, Voka është përpjekur t'u ndriçojë mendjen bashkatdhetarëve që të shohin djathtas e majtas nga fqinjët, që me dëshirë të madhe po punojnë me vrap e me dëshirë të madh për përparim e gëzim të popullit, duke i përmendur grekët e bullgarët e shumë të tjerë, që janë "bashkue me dashuri ndaj njeni tjetrit". "Po

përpiqen si t'ja bëjnë ta kthejnë dijen për nevojat e njeni tjetrit, të ndigjojnë mendimtarët e dijetarët, që u kane pri përpara në rrugën e përparimit e të fitimit, duke u bë ndihmues të fortit e të pasurit ndaj te varfërve, duke ndihmue vllazninë e forcojnë edhe farën (popullin e vet) e nderojnë, me punë e dituni, gazmojnë të gjithë njerëzit-botës njerëzinë i tregojnë", shkruante Hoxha në "Mësim". Më tej vazhdon: "Të gjithë jemi fara shqiptare në këtë vend ma të fortë e ma të par, ma të mençëm e ma të venijçim e me huje të mira... sot mo Zot ma keq me pa këndim e pa mësim, e kemi mbetë pranë të tanëve me mbrapa. Nuk po duen me na njoftë e me na dijtë as farat që kemi mbrenda as Evropa. Kësaj asgjë nuk mund t'i themi mbasi na ka lanë ditunija... Nuk asht tue na ba dobi fuqia e trimnia, një njeri mësim, këndim e fitim të mos ketë, s'ka si e sjellë në dorë as ket jetë, as atë jetë... A s'po na shohin sytë që të tan bota hijnë në kadife e në kumash, e na nuk jemi tue vu në shtat brekë e këmishë... kena me mbetë rob në dorë të botve qera kot.

Turp i madh si për ne, trima burra, bujarë të mbesim sot ma të poshtër se farat (popujt) tjerë. Akuzon qeverinë "Krerët e Shqipërisë"... E fikët vehten dhe i koritët varret e emrat e prindërve tanë. Për të gjitha këto të zeza, si vëllavrasjen, djallëzinë, armiqësinë, etj., prishjen e vetive të mira të popullit shqiptar, akuzon sidomos Qeverinë e Sulltan Abdyl Hamitit, kur çdo fjalë për mëmëdhenë trajtohej si tradhti kundër qeverisë. Hoxhë Voka flet edhe për reprezaljet e mëdha e të egra që bëhen ndaj njerëzve që mendonin për Atdheun, për popullin, duke i shuar me familje e oxhaqe, pa asnjë mbështetje, vetëm në dore të Zotit.

Rexhep Voka, personalitet i shquar i popullit shqiptar, i cili u përpoq për zhvillimin e përparimin e vendit, për edukimin e brezit të ri me moral të shëndoshë, edukatë fetare, dashuri dhe vendosmëri për interesat e popullit shqiptar e të Atdheut, është nderuar nga Presidenti i Shqipërisë, Sali Berisha, me dekret nr. 435, datë 26.1.1993 me Urdhrin për veprimtari Patriotike të Klasit të Parë me motivacion:

"Udhëheqës, propagandues e luftëtar për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit e ripushtuesit, duke qenë shembull për pasuesit në luftën për pavarësi e çlirim".

Literatura e konsultuar:

- Rexhep Voka: "Elifbeja shqip", Stamboll, 2010.
- Rexhep Voka: "Mendime", botuar pas vdekjes, Tetovë, 1991.
- Jashar Rexhepagiq: "Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territoret e Jugosllavisë së sotme", Prishtinë, 1970.
- Musa Kraja: "Mësuesit për Kombin Shqiptar", Toena, Tiranë, 1993, kreu XII me titull: Rexhep Voka-Tetova, "Hoxhë Voka-mësues, hoxhë, iluminist atdhetar"
- Musa Kraja: Tetova në ditën e një ngjarje të shënuar, Rilindja, 25 gusht, 1995.
- Ramiz Zekaj: "Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët, gjatë shekullit XX", Tiranë, 1997
- Ramiz Zekaj "Aspekte të zhvillimit të Islamit në Shqipëri," në Revistën shkencore kulturore "Univers", nr 17, 2016 ff. 66-80.
- Vehbi Bexheti: "Rexhep Voka dhe Vepra e Tij 1847—1917", Tetovë, Çabej, 2001.
- Nexhat Abazi: "Zhvillimi i arsimit shkollor dhe i mendimit pedagogjik shqip në Maqedoni, (1830-1912).
- Hajrullah Koliqi: "Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar", Prishtinë, 2003, ribotim i tretë, Prishtinë, 2013, ff. 306-309.
- Hajrullah Koliqi: "Kur Perëndia Identifikohej me Diturinë", Shtëpia botuese e Librit Shkollor, Prishtinë, 2011, f. 213.
- Musa Kraja - Sejfedin Haruni: "Gostivari vend i shenjtëruar i Abdylhaqim Doganit", Tetovë, mars, 1995.
- Nexhip Alpan - Nesip Kaci: "Shqiptarët në Perandorinë Osmane", Tiranë, 1997.

Në 95 vjetorin e Kongresit të I-rë Mysliman Shqiptar*

(Ali M. Basha)

Abstrakt

Kongresi i Parë i Myslimanëve përfaqëson një ngjarje shumë të rëndësishme jo vetëm për jetën fetare, shoqërore të Shqipërisë, por dhe për jetën politike kombëtare të mbarë popullit tonë. E, megjithatë, Kongresi ka qenë lënë në harresë. Mosvlerësimi shpjegohet vetëm me qëndrimin e njohur të shtetit monist ndaj besimeve fetare dhe organizmave të tyre.

Paragjykimet ndaj bashkësisë islame shqiptare, të konsideruar tejet të prapambetur, dhe, madje, dhe ndaj vetë besimit islam, të konsideruar thjesht si trashëgimi e sundimit disashekullor osman, kanë penguar vlerësimin e rëndësisë historike të Kongresit Mysliman Shqiptar të vitit 1923. Ato nuk kanë mundësuar që t'u kushtohet vëmendja e duhur dokumenteve të miratuara prej tij, të njohura deri më tani. Edhe një shikim i shpejtë i tyre, lejon të vërehet karakteri thellësisht kombëtar dhe përparimtar i vendimeve të marra në këtë tubim.

Kongresi i Parë Musliman Shqiptar përfaqëson organizimin fetar mbi baza kombëtare të shumicës mbizotëruese të popullsisë shqiptare. Vlen të theksohet dhe të kihet mirë parasysh se një organizim i këtij lloji është i pari në të gjithë botën islame. Për shkak të ngjarjeve që e pasuan, konkretisht, pas fitores së Revolucionit Kombëtar Turk, ai përfaqëson, gjithashtu, dhe një rast unik në të gjithë historinë e Islamit në kohët moderne.

Hyrje

Famuri i diturisë islame do të bartet nga njëri brez në tjetrin nga të moderuarit, të cilët e mbrojnë atë nga shtrembërimet e fanatikëve, pretendimet e falsifikuesve dhe keqinterpretimet e injorantëve.[1]

Drejtimi i organizmave fetare nga kleri i huaj apo atij shqiptar, dhe, jo rrallë, në varësi e në shërbim të qendrave fetaro-politike të huaja dhe madje, armiqësore ndaj çështjes shqiptare, ka shqetësuar Lëvizjen

*. Titulli nga redaksia.

1. Muhamedi (a.s.), sipas Jusuf Kardavit, Rizgjimi islam ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit. Logos-A, Shkup 1417/1997:10.

Foto e Kongresit të I-rë Mysliman Shqiptar

Kombëtare Shqiptare qysh në fillimet e saj dhe më pas edhe shtetin e pavarur shqiptar, që me krijimin e tij. Çështja e mëvetësimit të organeve dhe të organizmave fetare në Shqipëri për pjesën më të madhe të tyre është zgjidhur vetëm pas stabilizimit të shtetit të ri shqiptar.

Kongresi i Parë i Myslimanëve përfaqëson një ngjarje shumë të rëndësishme jo vetëm për jetën fetare, shoqërore të Shqipërisë, por dhe për jetën politike kombëtare të mbarë popullit tonë. E, megjithatë, Kongresi ka qenë lënë në harresë. Mosvlerësimi shpjegohet vetëm me qëndrimin e njohur të shtetit monist ndaj besimeve fetare dhe organizmave të tyre.

Paragjykimet ndaj bashkësisë islame shqiptare, të konsideruar tejet të prapambetur dhe madje dhe ndaj vetë besimit islam, të konsideruar thjesht si trashëgimi e sundimit disashekullor osman, kanë penguar vlerësimin e rëndësisë historike të Kongresit Mysliman Shqiptar të vitit 1923. Ato nuk kanë mundësuar që t'u kushtohet vëmendja e duhur dokumenteve të miratuara prej tij, të njohura deri më tani. Edhe një shikim i shpejtë i tyre, lejon të vërehet karakteri thellësisht kombëtar dhe përparimtar i vendimeve të marra në këtë tubim.[2]

2 Ky artikull është marrë nga libri "Rrugëtimi i fesë Islame në Shqipëri" (1912-1967) të autorit të ndierë z. Ali Musa Basha, botim i vitit 2011.

KONGRESI MYSLIMAN SHQIPËTARË

Tirane me 11-III-923.

Nr. 4.

Te Shkelqyeshmes

Kryeministries

ne

T i r a n e

Shkurtim:

Me ane te kesaje shkrese kemi nderin me u lajmerue se Kongresi Mysliman Shqipetar sot morri fund me sukse te plota tue ba zgjedhjet e antarve te Keshillit te Nalt te Sheriatit si mbas neneve 6-7 te Statutit.

Zgjedhja u perfundue si vijon:

Z. Vehbi Dibra	Vota	30	Dijetar.
" Hafiz Ali Korca	"	29	"
" Vejsel Nailiu	"	27	"
Nga Tarikatet			
Z. Haxhi Adem Bab	"	28	Tarikat
" Sheh Ibrahim Karabunari		26	"
Nga Civilet.			
Z. Çamil Bala	Vota	28	Civil
" Reshat Kokalari	"	20	"
Drejtor i Pergj. i Vakfevet Z. Salih Vugeterrni.	"	22	

Pra u lutem shkelqesies Sjuej qi te bahen Veprimet e duhura per preferimin e dekretimin e Kryesies si mbas nenit 7 (shtat) te statutit.

Kryetar i Kongresit Mys. Shqip

Vendimi i Kongresit të I-rë Mysliman Shqiptar për zgjedhjen e Kryetarit të parë të KMSH-së pas themelimit, më 1923, ku me shumicë votash u zgjodh kryemyftiu i Shqipërisë (1912-1923), H. Vehbi Dibra (1867-1937), detyrë të cilën e mbajti deri më 1929.

1. Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar

Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar përfaqëson organizimin fetar mbi baza kombëtare të shumicës mbizotëruese të popullsisë shqiptare. Vlen të theksohet dhe të kihet mirë parasysh se një organizim i këtij lloji është i pari në të gjithë botën islame. Për shkak të ngjarjeve që e pasuan, konkretisht, pas fitores së Revolucionit Kombëtar Turk, ai përfaqëson, gjithashtu dhe një rast unikal në të gjithë historinë e islamit në kohët moderne.

Ky ishte Kongresi i një popullsie myslimane, e cila kishte dale nga një sundim i gjatë i një perandorie ku mbizotëronte sistemi osman i mileteve. Edhe pse tepër liberal, ky sistem qe shumë i rrezikshëm për mbijetesën e njësuar kombëtare të shqiptarëve plurifetarë për shkak të njëjtësimit, sipas politikës perandorake, të fesë me kombësinë. Porse myslimanët në trojet shqiptare nuk e identifikuan veten si turq, por shqiptarë. Mbi bazën e kësaj ndjenje të njësisë etnike, ata nuk i tëhuajësuan bashkatdhetarët e tyre të krishterë. Ata edhe pse në shumicën dërrmuese ishin myslimanë, nuk dëshmuan shenja intolerance, prirje mbizotërimi dhe ca më pak prepotence ndaj bashkëkombësve të vet të besimeve të tjera, pavarësisht se këta ishin në pakicë. Përkundrazi është kjo shumicë myslimane, e cila tolerancën dhe harmoninë fetare midis të krishterëve ortodoksë dhe atyre katolikë, të trashëguar, e ngritën në një shkallë më të lartë, duke e shndërruar në bashkëjetesë fetare dhe kjo pavarësisht se ishte koha kur grindjet në gjirin e krishterimit ishin në modë.

Nga gjiri i përfaqësuesve të kësaj popullsie dolën më 1923 kërkesat për thirrjen e Kongresit Mysliman. Qeveria lejoi mbledhjen e tij për formimin e Këshillit të Myslimanëve.

Shtypi shqiptar i kohës duke vlerësuar lart nismën e marrë, jo vetëm si një ngjarje thjesht fetare apo shpirtërore, theksonte se mbledhja e Kongresit i kapërcente së tepërmi interesat e fushës përkatëse. Për vetë kushtet në të cilat ndodhej vendi ynë dhe vetë organizimi i besimeve fetare në Shqipëri, nisma të tilla, edhe pse në rrafsh fetar, merrnin ngjyresa të theksuara politike kombëtare me rëndësi të veçantë për të ardhmen jo vetëm të myslimanizmës në Shqipëri, por dhe për konsolidimin e shtetit shqiptar dhe për ardhmërinë e mbarë kombit shqiptar. Me këtë bindje rrethet e besimtarëve myslimanë i hynë punës për organizimin e Kongresit, synimi i të cilit ishte mëvetësimi i Xhamisë shqiptare.

Jehona e mbledhjes së këtij Kongresi në shtyp ishte shprehje e shqetësimeve të rretheve fetare islame, si dhe midis masës së besimtarëve, mbi të ardhmen e

bashkësisë islame në Shqipëri, madje dhe të mbijetesës së saj në Europë. Bashkësia islame shqiptare ishte e vetëdijshme se domosdoshmëria e marrjes së masave për organizimin e saj mbi baza kombëtare dhe sa më përparimtare, kushtëzohej, veç të tjerash dhe nga pozita gjeopolitike e vendit tonë.

Pikërisht sepse iu kundërvunë politikës antishqiptare, këta klerikë u ndoqën dhe u persekutuan nga ekspeditat ndëshkimore. Me dhjetëra qenë hoxhallarët që u arrestuan, u rrahën publikisht, u burgosën dhe u internuan, çka nuk kishte ndodhur me klerikët e besimeve të tjera.

Klerikët myslimanë, jo rastësisht u rreshtuan në radhët e para të Lëvizjes Kombëtare. Në këto pozicione ata u gjendën jo vetëm në saje të atdhetarizmit, por dhe në saje të formimit të tyre intelektual, duke dëshmuar një shkallë të lartë vetëdijesimi kombëtar. Këta intelektualë, të arsimuar jo vetëm nga ana teologjike, përfaqësonin në të njëjtën kohë, personalitete të shquara të kulturës islame. Shumë prej tyre qenë njohës të thelluar të kësaj kulture: të gjuhëve të Lindjes, të filozofisë, të moralit, të së drejtës e në mënyrë të veçantë të letërsisë.

Edhe pse nuk qenë shkolluar në Perëndim shumë prej tyre në sajë të kulturës islame, njohjes së gjuhëve arabisht, persisht e turqisht patën mundësinë të njihnin thellësisht, siç thotë Fan Noli, rrënjët e Qytetërimit Evropian: Përlindjen e shkëlqyer të Persisë, që buronte drejtpërdrejt nga qytetaria greko-romane prej së cilës lindi Përlindja arabe, e cila nga ana e saj përmes Spanjës influencoi Evropën medievale dhe gatiti Përlindjen e madhe italiane, nënën e qytetarisë moderne.[3]

Pra, jo rastësisht, dijetarë si ato që u përmenden më sipër, u vunë dhe në ballë të përpjekjeve për organizimin e bashkësisë islame mbi baza, siç e shpallnin dhe vetë kombëtare dhe moderne.

Nën udhëheqjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në të cilën këta dijetarë atdhetarë luajtën një rol parësor, popullsia myslimane shqiptare, sikurse mbarë populli ynë, doli nga sundimi i Perandorisë Osmane me identitetin e vet kombëtar të njësuar, të përcaktuar dhe të shprehur pa kurrfarë mëdyshjeje.

Ky identitet, i përcaktuar qartë kombëtarisht, kërkonte dhe imponoute dhe një organizim të bashkësisë islame në Shqipëri mbi baza kombëtare. Ky qe një proces, i cili kishte filluar dhjetë vjet më parë nga qeveria e Vlorës e Ismail Qemalit me caktimin e H. Vehbi Agollit, si kryemyfti dhe i Vejsel Nailit si kryekadi të Shqipërisë pa pyetur dhe pa marrë miratimin e Stambollit. Për ta çuar deri në fund këtë proces të nisur që në ditët e para të Pavarësisë shqiptare, u mblodh Kongresi Mysliman Shqiptar.

3. F. S. Noli, f. 206.

Vehbi efendi Agolli në fjalën e hapjes të Kongresit theksoi, më 24 shkurt 1923, me të drejtë, karakterin liberal e demokratik të fesë myslimane. Ajo i kishte të hapura portat për diskutimin e lirë të të gjitha problemeve, që i interesonin botës myslimane, sepse siç u shpreh ai fjalë për fjalë, "me ndërrimin e kohës ndërrojnë edhe gjykimet".

Nismëtarët, organizatorët dhe drejtuesit e këtij kongresi vinin në kuvend me një koncept të qartë dhe të gjerë bashkëkohor përsa u takonte masave dhe vendimeve që do të merrnin.

Kryemyftiu i Shqipërisë, duke marrë parasysh gjendjen fetare të vendit, shtronte para besimtarëve myslimanë detyrën për të vënë mbi gjithçka bashkimin dhe vëllazërimin kombëtar të mbarë shqiptarëve, pa dallim besimi. Porosia e kryemyftiut të parë të Shqipërisë u bë ideja themelore që përshkoi të gjithë punimet e Kongresit, çka u pasqyrua dhe në Statutin e miratuar. Kështu, sipas Statutit, "Detyrat e Këshillit të Sheriatit (Divanit) janë: a)Të sigurojë njisin ndërmjet muhamedanëve, duke respektuar doket, dogmat e tarikateve dhe të shfaqë shpirtin liberal dhe njerzuer të muhamedanizmës, me një zhvillim modern e kombëtar, duke bërë reforma"; b) të ngrejë institute fetare për me nxjerrë imamë, hatiba, vaiza, myftij, myderrizë, shejhë e teologë dhe të përmirësojë medresetë mbas reformave të reja..." Këto ide e kanë udhëhequr gjatë gjithë veprimtarisë së tij Komunitetin Mysliman Shqiptar.

Si pikë referimi të analizës, që bëri në Kongres rreth gjendjes politike, shoqërore dhe fetare të shqiptarëve në kohët më të reja, atdhetari i mirënjohur Vehbi Agolli në fjalën e tij nënvizonte fitoren e madhe historike të shqiptarëve në Kuvendin e Vlorës me Shpalljen e Pavarësisë, të ripohuar, të përforcuar dhe të kurorëzuar dhe një herë me Kongresin e Lushnjës.

Në Statutin e vitit 1923 nuk bëhet fjalë për kurrfarë lidhjeje fetare organizative me Stambollin, as me Kalifatin dhe as me Shejh'u Islamin. Gjithë organizimi dhe funksionimi i kësaj Bashkësie ishte menduar dhe ligjësuar i pavarur prej ndonjë qendre tjetër fetare të huaj, kushdo qoftë ajo.

Synimi i përfaqësuesve të bashkësisë së myslimanëve shqiptarë ishte dhe mbetej sigurimi i "një zhvillimi modern e kombëtar" të fesë islame në Shqipëri. Për vënien në jetë të kësaj detyre jepej direktiva për zbatimin e disa risive, reformave, të cilat nuk do të preknin themelet e besimit islam. Kështu, në dokumentet e miratuar nga Kongresi Mysliman, si detyrë kryesore u përcaktua: "Të siguroj njisjen (bashkimin) ndërmjet muhamedanvet dhe të çfaqi shpirtin liberall Hyr dhe ndërnjerzuer të muhamedanizmës me nji zhvillim modern (aser) e kombtar tuej bamë reforma pa i prekë themelet fetare".

Hartuesit e Statutit të Komunitetit Mysliman përcaktuan qartë drejtimet për zhvillimin modern, bashkëkohor të Komunitetit Mysliman. Ata qenë të vetëdijshëm, që sendërtimi i kësaj detyre lidhej ngushtë me përparimin e atdheut. Pra, pa u ngatërruar në parcelizimin dhe pronësimin mbi bazën e kritereve gjeografi ke të kulturave universale të Perëndimit dhe të Lindjes, ata u orientuan drejtë në zgjidhjen e detyrave themelore të bashkësisë islame në funksion të përparimit të atdheut të tyre. Duke pasur parasysh kuptimin shqip të fjalës orient, mund të themi, se ata u orientuan pa vështirësi në horizontet e paanë të qytetërimeve e të kulturave në përputhje me gjendjen gjeopolitike dhe gjeofetare të atdheut, duke iu përgjigjur me përgjegjësi dhe në lartësinë e duhur detyrave që qëndronin para tyre.

Me fjalë të tjera, si detyrë kryesore shtrohej që përmes reformave, të cilat nuk preknin themelet e besimit Islam, të sigurohej zhvillimi modern dhe kombëtar i bashkësisë islame. Me këtë rrugë, nënvizohej në dokumentet e Kongresit, do të dëshmohej karakteri liberal dhe njerëzor, human i këtij besimi.

Detyrë parësore e Këshillit të Lartë të Sheriatit shtrohej, gjithashtu, përmirësimi i arsimit fetar mbi baza kombëtare shqiptare dhe moderne, siç thuhej shprehimisht, "mbas reformave të reja", "simbas shekullit të sotshëm".

Një vend i veçantë iu dha masave, që do të merreshin për zhvillimin e mësimit të fesë, duke përgatitur libra e tekste për predikime fetare në gjuhën amtare, të hartuara dhe të përgatitura në përputhje me kërkesat e kohës. Zhvillimi i arsimit fetar do të bëhej sipas kërkesave bashkëkohore, siç thuhej në Statut, "simbas shekullit të sotshëm".

Nga jehona, që pati në shtyp dhe nga vendimet e marra në Kongres del plotësisht e qartë, se gjithë shqetësimi i delegatëve, që morën pjesë në të, ka qenë vënia e organizimit dhe e funksionimit të Bashkësisë Islame Shqiptare mbi baza kombëtare dhe sa më bashkëkohore. Kongresi sanksionoi me statut karakterin etnik shqiptar të përbërjes së Këshillit të Lartë të zgjedhur prej tij.

Lajmi për vendimin kryesor të Kongresit - për shkëputjen e xhamisë shqiptare nga Shejh'ul Islami, u prit kudo me miratim dhe entuziazëm të theksuar nga gjithë opinioni publik shqiptar, pavarësisht nga besimi. U përshëndet nga të gjithë banorët e vendit tonë, duke u shndërruar në një festë të vërtetë. Në to u bënë lutje fetare në gjuhën shqipe, duke zbatuar aty për aty vendimin e Kongresit. Ky lajm i rëndësishëm u përshëndet dhe me të shtëna artilerie.

Me vendimet e Kongresit bashkësia islame shqiptare u shkëput, tashmë edhe juridikisht, nga qendra e saj botërore në Stamboll, plot një vit më parë se ajo të abrogohej nga Mustafa Qemali.

Në faqet e revistës "Zani i Naltë", duke e vlerësuar Kongresin si "Një hap (drejt) përparimit", arsimtari veteran Sheuqet Muka uronte, që këto vendime të çoheshin më tej në kongresin e ardhshëm të myslimanëve shqiptarë. Ky urim mbetet një porosi edhe për të sotmen dhe të ardhmen e bashkësisë islame në Shqipëri.

Si përfundim, mund të thuhet, se Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar sanksionoi pavarësinë e bashkësisë islame në Shqipëri. Ai hapi, siç del nga jehona e tij, dritën jeshile për emancipimin e myslimanëve shqiptarë. Këtë dëshmoi në vijim qëndrimi miratues i kësaj bashkësie ndaj legjislacionit të ri civil të Mbretërisë Shqiptare.

Kongresi programoi shqipërimin e veprave fetare islame, duke mos përjashtuar edhe vetë Librin e Shenjtë "Kur'anin". Një masë e tillë shënonte aso kohe një hap të madh përpara për të gjithë botën myslimane. Në realizimin e kësaj detyre u angazhuan teologë të mirënjohur, fetarë dhe laikë. Midis tyre shquhet mbi të gjithë kleriku atdhetar Hafiz Ibrahim Dalliu.

Përballë përpjekjeve, që u vërejtën në ato vite për organizimin e një komiteti panislamik në Shqipëri, krijimi i Bashkësisë Islame Shqiptare mbi baza kombëtare dhe i organit të saj të pavarur nga një qendër e huaj e jashtme, shënon një sukses shumë të madh jo vetëm për atë kohë, por dhe për të ardhmen, për vetë fatet e kësaj Bashkësie dhe të bashkëjetesës me vëllezërit e krishterë.

Vendimet e Kongresit të Parë Mysliman Shqiptar dhe masat e përpjekjet për vënien e tyre në jetë bënë që abrogimi i Kalifatit një vit më vonë në Turqi, të kalonte pa ndonjë reagim negativ, siç mund të mendohej, apo dhe siç ndodhi në vende të tjera islame, qoftë dhe në Ballkan.

Vendimet e Kongresit Mysliman në mars 1923, ashtu sikurse dhe vendimet e Kongresit Bektashian të Prishtës në janar 1922 dhe të Kongresit të Kishës Ortodokse në Berat në shtator 1922 i vunë organizmat fetare të masës dërmuese të popullsisë shqiptare në vendin tonë, organizativisht dhe administrativisht, mbi baza kombëtare jashtë ndikimeve politike të huaja të dëmshme, apo dhe të rrezikshme. Me këto vendime viheshin në jetë idealet e rilindësve tanë, në radhët e të cilëve militonin aktivisht dhe klerikë të këtyre besimeve, për sigurimin e bashkimit dhe vëllazërimit kombëtar të mbarë shqiptarëve pa dallim besimi.

Qëndrimet pozitive të mbajtura nga organet klerikale myslimane dhe nga shtypi shqiptar i kohës, janë shprehje të një mendësie moderne mbarëpopullore, që kishte përfshirë të gjitha masat myslimane të vendit dhjetëra vjet më parë. Pavarësisht nga zikzaket e pashmangshme dhe pavarësisht nga ritmet që i imponuan, bashkësia islame prirej dhe priret drejt qytetërimit dhe përparimit dhe ka ecur dhe vijon të ecë pa u ndalur në këtë rrugë.

Në Kongresin e Parë Mysliman Shqiptar u dëshmua katërcipërisht tubimi i një bashkësie me identitet kombëtar të përcaktuar dhe të shprehur prej kohësh, me një përfytyrim të qartë bashkëkohor për zhvillimin e saj dhe të Atdheut. Rëndësia e mëvetësimit të xhamisë, për vetë përmasat e këtij akti historik, i kapërcen caqet e historisë sonë kombëtare.

Të ndriçuar nga idetë e Përlindjes Myslimane dhe të epokës së sotme, Bashkësia Islame Shqiptare do të vijojë të dëshmojë karakterin liberal e demokratik të fesë islame. Edhe sot e kësaj dite mbetet e qartë për të gjithë se ajo i mban të hapura portat e ixhtihadit, për diskutimin e lirë të të gjitha problemeve, që i interesojnë botës myslimane. Nisur nga porosia e Haxhi Vehbi Dibrës, që "me ndërrimin e kohës ndërrojnë edhe gjykimet" mbetet detyrë e pasardhësve të tij për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të konceptit kombëtar dhe modern të organizimit dhe të zhvillimit të Komunitetit Mysliman.

Detyra që shtroi Kongresi i pare Mysliman Shqiptar para organeve të tij dhe të gjithë besimtarëve të bashkësisë islame shqiptare për sigurimin e "një zhvillimi modern e kombëtar" të fesë islame në Shqipëri mbetet në rend të ditës. Në radhë të parë, shtrohet detyra për ruajtjen dhe përforcimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve. Të vetëdijshëm se qytetërimi i sotëm është fryt i gjithë zhvillimit historik të njerëzimit, në të cilin qytetërimi islam ka dhënë një ndihmesë të veçantë, nuk kemi pse i frikësohemi rrjedhave integruese evropiane.

Vetëm mbi bazën e një zhvillimi kombëtar dhe modern, Komuniteti Mysliman do të vijojë të dëshmojë, siç kërkonte Statuti i pare i tij, karakterin liberal dhe njerëzor, human të Islamit. Nisur nga kjo, detyrë parësore e tij mbetet zhvillimi i arsimit fetar mbi baza kombëtare shqiptare dhe moderne, "simbas shekullit të sotshëm", sipas kërkesave të shekullit XXI.

Mbetet detyrë e dorës së pare edhe në ditët tona shqetësimi i delegatëve të Kongresit për organizimin dhe funksionimin e bashkësisë islame shqiptare mbi baza kombëtare, sa më bashkëkohore. Vijimi konsekuent i rrugës së hapur nga Kongresi për emancipimin dhe organizimin përparimtar të bashkësisë islame shqiptare, nuk do ta pengojnë teorizimet gjoja shkencore rreth të ashtuquajturit identitet evropian të shqiptarëve, të cilat shpërfillin identitetin tonë kombëtar. Qëndrime të tilla nuk mund ta ç'orientojnë Komunitetin Mysliman, aq sa të pengojnë angazhimin e tij në përpjekjet e popullit tonë për t'u integruar në Evropë.[4]

4. Shpjegime të tjera mbi dinamikën e punimeve të Kongresit, vendimet e marra nga Kongresi dhe jehonën e tyre etj. Shiko: Ali M. Basha. Islami në Shqipëri gjatë shekujve. Tiranë, 2000:119-139.

2. Ideja për mbledhjen e Kongresit I-rë të myslimanëve të Shqipërisë

"... fetë e përhapura në Shqipëri nuk mund të ushtronin ndonjë ndikim të madh në orientimet e opinionit publik dhe të kulturës mbisunduese. Cilatdo që të ishin opsionet personale të eksponentëve të tyre në zë, bashkësitë fetare shqiptare në periudhën midis dy luftërave i ndihmuan (ose iu nënshtruan) në forma të ndryshme patriotizmit prepotent dhe hegjemon nga pikëpamja ideologjike. Nuk kishte vend për të mbajtur qëndrim pro ose kundër - zgjedhja në njëfarë mënyre ishte e detyruar, po të mos doje të cilësoheshe si heretik i besimit nacionalist. Nacionalizmi i përshkonte bashkësitë fetare, duke ndeshur vetëm në kundërshtimin e ndonjë pakice, madhësia e së cilës nuk duhet mbivlerësuar".[5]

Mbledhja e një Kongresi të myslimanëve të Shqipërisë ka qenë dëshirë konsensuale e shprehur vazhdimisht nëpër qarqet islame. Për mënyrën e organizimit të këtij kongresi ka pasur mendime të ndryshme dhe është bërë edhe një lloj përgatitje nga vetë prijësit myslimanë. Por çështja u shty për shumë shkaqe - vendi ishte i okupuar, nuk gjendej zgjidhje ekonomike për zhvillimin e punimeve të Kongresit dhe për probleme të tjera si: zgjedhja e delegatëve, koha, vendi etj.

Që në vitin 1917 Myftiu i Shkodrës, H. Xhemal Naipi i dërgon H. Hafiz Isuf efendi Kelmendit "Rregulloren mbi zgjedhjen e delegatëve për Kongresin e Xhema'ati Islamijes". Votimi do të bëhej me zgjedhës të dytë. Do të kishin të drejtë vote të gjithë myslimanët, që do të ishin në moshën 21 vjeçare[6].

Kryeministri i kohës, Ahmet Zogu, me 7 dhjetor 1922, nis dy shkresa në Gjyqin e Naltë të Sheriatit. Nëpërmjet shkresës së parë kërkon mendimin e Gjyqit të Naltë, si edhe për dikasteret e tjera të vendit që, "për t'u dhënë të gjitha zyrave të shtetit një formë moderne, duke siguruar shpejtësinë e mirëvajtjen e veprimeve zyrtare në mënyrën e dëshiruar, veprim që do të jetë i pari hap i përparimit të Atdheut, të njoftohemi me anë të një raporti studimor se ç'masa mendon ai gjyq mbi organizimin e përgjithshëm e mbi përparimin e asaj ministrie e të degëve a të direksioneve të varura prej saj, duke pasur në kujdes gjithnjë ekonominë"[7], kurse nëpërmjet shkresës tjetër, kërkon që "për të pasur mundësi, që të merren pastaj masat e duhura për t'i dhënë asaj dege një gjallëri e një përmirësim në mënyrën e dëshiruar, jeni të lutur që, nëpërmjet një raporti e të një projekti të posaçëm, të na jepni mendimet dhe mënyrën mbi formimin e Xhemijeti Islamijes"[8].

5. Roberto Morozzo Della Rocca. 1994:13.

6. AQSH, Fondi 482; viti 1917; dosja 4.
7. Po aty, viti 1922, dosja 8, fleta 45.
8. Po aty, fleta 47.

Gjyqi i Naltë i Sheriatit me 16 dhjetor 1922 njofton Kryeministrinë se "Zyra e Ilmijes ndjen gëzimin më të madh dhe paraqit falenderimet e Kryesisë për formimin e Xhema'ati Islamijes. Formimi e aplikimi i rregullës së xhema'ateve në atdheun tonë, është një punë me rëndësi, sepse forma kombëtare e shtetit është një pengim për qeverinë që merret me çështje fetare në Shqipëri, ku ndodhen elementë të ndryshëm. Prandaj, për të siguruar mirëvajtjen dhe përparimin e parimeve të larta myslimane, është një gjë e domosdoshme organizimi i xhema'atit, të shtyrë prej nevojës, që po ndihet dhe në qarkun dijetar (Ilmijes). Për vërtetim ju paraqesim Statutin e Xhema'atit, duke u lutur që të keni mirësinë e të na urdhëroni përfundimin e tij"[9]. Me qarkoren e datës 16 dhjetor 1922 Gjyqi i Naltë i Sheriatit njofton rrethet për këtë porosi. Bashkëngjitur me shkresën që shpreh gëzimin e Degës së Ilmijes për këtë iniciativë të qeverisë, pranon se në një vend ku aplikohen disa besime fetare, organizimi i tyre është më i drejtë me *xhema'ate*.[10]

9. Po aty, fleta 48.

10. Statuti i Xhema'atit Mysliman të Shqipërisë: 1) Në kryeqytet ekziston një *Kadi el Kyda* (kryegjykatës) si përfaqësues *(Mymes'sil)* i xhema'atit mysliman e i gjyqeve sheri. 2) Nën kryesinë e *Kadi el Kydat-it* do të jetë edhe një këshillë diktues për të shqyrtuar gjykimet e duhura prej gjyqeve sheri. 3)Nën kryesinë e *Kadi el Kydat-it* do të jetë edhe një këshillë e shehelerëve. 4) Në qendrat e prefekturave dhe të nënprefekturave me rëndësi, me titull *naib (prokuror)*, do të ndodhet
një kryetar me kompetencë gjykatësie *(Ifta)* pranë të cilit do të gjenden shkrues e sherbetorë, sa ta lypë nevoja. Në qendra të mëdha, ku mjaftojnë të ardhurat, ka për t'u emëruar nga një myfti për t'u marrë vetëm me çështje *fetfaje*. 5) Në gjyqet sheri vërehen proceset mbi testamentet (*vasijet)*, kurorëzimet, shkurorëzimet, *rida, nefeka (shpenzimet apo detyrimet materiale), mefkute (objektet e humbura), vakëf, miras (trashëgimi*), *tahriri terhaqate* të jetimëve. 6) Vendimet e gjyqeve sheri, që marrin formë të prerë, përmbarohen nga zyra e përmbarimit të drejtësisë. 7) Në çdo nënprefekturë do të formohet një trup xhema'ati, i zgjedhur sipas rregullores së posaçme, i cili ka për detyrë të shikojë çështjet përkatëse në fe. Ky trup konsiderohet një degë person moralit e mvaret në qendrën e Xhema'atit Mysliman, që kryesohet prej *Kadi el Kydatit*. 8) Në qendër do të jetë një drejtori e Përgjithshme e Vakfeve, e cila do të jetë e lidhur te *Kadi el Kydatin* dhe në nënprefektura do të emërohen nëpunësa të nevojshëm për të rregulluar të ardhurat e vakfit. Vakfet e teqeve e të zavijeve rregullohen si përpara, por Drejtoria e Përgjithshme ka të drejtë drejtimi mbi këto vakfe. 9) Shejhët, atët (dedetë), të tarikateve të shenjta, për respektim të hierarkisë e për dekretim secila degë varet te i pari i vet. Imamët, hatibët (kurrah) e katimet e tjera si këto, dekretohen prej *kadi el Kydat-it*. 10) Nuk do të mund të vishet askush me rrobat e hoxhallarëve, apo të shehelerëve pa marrë lejen e duhur. 11) Këshilli Qendror për hatibët e vaizët do të trajtojë në gjuhën zyrtare, hytbe e prediksione (predikime), sipas shekullit të sotëm e sipas nevojave kombëtare. 12) Përveç masave, që do të merren për përmirësimin e medreseve të para (*medresei talije),* që gjenden, do të themelohet edhe një universitet *(Medrese Alije),* ku do të mësohen

3. Dinamika e organizimit të Kongresit të I-rë

Këshilli i Naltë i Sheriatit relacionet e veta me shtetin shqiptar mbi varësinë e tij (merbutijet), i ka prerë dhe quhet një zyrë indipendente, e lirshme në veprim për mbrojtjen e të drejtave fetare të elementit të vet, si dhe për përparimin e lulëzimin në çdo pikëpamje, prandaj kjo kryesi ju njofton se dhe këshillat e xhema'atit janë të lidhura drejtpërsëdrejti me Këshillin e Naltë të Sheriatit dhe për çdo çështje e marrëveshje që të kenë nevojë, janë indipendente në qarkun e vet, duke mos pasë kërkush të drejtë kundërshtie e pengimi në detyrat përkatëse të tyre".[11]

Gjyqi i Naltë i Sheriatit i drejtohet Kryeministrisë dhe e njofton se, me që e shikon të nevojshme një këshill (kongres - A. B.) të myslimanizmës (Xhema'ati Islamije), për të cilin është folur e kërkuar herë pas here verbalisht edhe nga ana e popullit mysliman, ka caktuar që të bëhet një mbledhje për formimin e këshillit në fjalë me 20 shkurt 1923. "Me këtë rast e njoftojmë të lartën Kryeministri dhe kërkojmë prej saj të na ndihmojë, duke u dhënë urdhërat e duhura të gjithë prefekturave e nënprefekturave që të zgjedhin rregullisht nëpërmjet bashkive nga 1 person e ta dërgojnë në Tiranë", përfundon shkresa.[12]

Kryesia e Këshillit të Ministrave dërgon vendimin e vet të datës 29 janar 1923 për dhënien e lejes Gjyqit të Naltë të Sheriatit për të bërë mbledhjen e përgjithshme me 20.II.1923[13]. Ministri i Punëve të Brendshme, Ahmet Zogu, me një telegram sekret njofton Prefekturën Elbasan se i jepet leje Gjyqit të Naltë të Sheriatit për të bërë mbledhjen e përgjithshme me 20.II.1923 për fomimin e Këshillit të Naltë Mysliman, Xhemijeti Islamije, e lypur shumë herë prej popullit mysliman. Lajmëroni në këtë mënyrë të gjitha zyrat kompetente për këtë veprim. Nëse shihet e nevojshme për shkoqitje, merruni vesh me kryetarin e Gjyqit të Naltë të Sheriatit.[14]

---

gjuhëra të ndryshme, duke i dhënë rëndësi literaturës e historisë kombëtare. Mënyra e formimit të këtij universiteti, e pranimit të nxënësve të tij, caktohen me një rregullore të posaçme. 13) Mësimet fillore të nxënësve myslimanë do të jenë në kompetencë të çdo xhema'ati mysliman. 14) Rrogat e nëpunësve, të shërbëtorëve të gjyqeve sheri e të vakëfeve të qendrës së përgjithshme e të rretheve paguhen siç janë treguar në rregulloren e posaçme. 15) Një herë në dy vjet do të bëhet në kryeqytet një mbledhje e përgjithshme prej xhema'ateve myslimanë të qarqeve, ku do të bisedohet themelimi e forcimi vëllazëror i njësisë kombëtare. Mënyra dhe kompetenca e kësaj mbledhjeje dëftohet me një rregullore të posaçme. 16) Përderisa të bëhet mbledhja e përgjithshme vazhdon forma ditore *(sheqli ilm)* e tashme. 17) Pikat e këtij Statuti ndryshohen *(tadil)* në mbledhje të përgjithshme me 2/3 e votave të saj. Tiranë 13.XII.1922.
Vërtetohet: Myfti i Përgjithshëm: Vehbi d.v. (AQSH. Fondi 163, viti 1923, dosja 44). Projektstatut, i përgatitur si bocet për në kongres.

11. AQSH. Fondi 482, viti 1923, dosja 1, fleta 11.

12. Po aty, fleta 2.

13. Po aty, dosja 4, fleta 3.

14. AQSH. Fondi 125, viti 1923, dosja 125,

Edhe vetë Këshilli i Naltë i Sheriatit me qarkore njofton prefekturat e nënprefekturat se "me 20 shkurt 1923 do të bëhet në kryeqytet një mbledhje e përgjithshme prej delegatëve myslimanë për formimin e Xhema'ati Islamijes. Me këtë mbledhje çdo prefekturë do të dërgojë një përfaqësi, e cila do të zgjidhet nga përfaqësuesit e krahinave të lagjeve myslimane, të cilët do të jenë zgjedhë me anë të pleqësive të tyre dhe mandej do të votojnë nën kontrollin e bashkive. Delegatët, që do të dërgohen këtu do të jenë që të dinë me shkrue e me këndue mirë gjuhën zyrtare e të kenë dijeni të plota ashtu dhe besimtarë feje e me morale të mira. Zgjedhjet të bëhen me një shpejtësi të madhe që t'ia mbërrinë mbledhjes në kohën e caktueme. Çështja e shpenzimeve u njofohet më vonë."[15]

Me telegramin e datës 11 shkurt 1923, Myftiu i Përgjithshëm njofton prefekturat e nënprefekturat se "me që koha e mbledhjes së përgjithshme për formimin e Xhema'atit Mysliman u afrua tepër, zgjedhjet e përfaqësuesve që do të dërgohen këtu, të bëhen vetëm nga ana e bashkive me një shpejtësi të madhe me konditat që ju kemi treguar".[16]

Ministri i Punëve të Brendshme, Ahmet Zogu me datë 11 shkurt 1923 u dërgon një qarkore shifër zyrave vartëse me këtë përmbajtje: "Jeni të lutur të përpiqeni në mënyrë legale që delegatët, që do të zgjidhen për me marrë pjesë në mbledhjen e përgjithshme të myslimanizmës të jenë patriotë dhe pak a shumë liberalë"[17] dhe një ditë më pas shton: "Nuk është e domosdoshme, që delegatët të jenë hoxhallarë, vetëm duhet të jenë patriotë dhe pak a shumë liberalë"[18]. "Me qenë se shumica e delegatëve nuk mundën me u mbledh, mbledhja do të hapet me datë 24.II.1923"[19].

Pastaj vazhdojnë urdhrat e njëpasnjëshëm telegrafi kë në lidhje me emrat e personave që duhet të zgjidhen delegatë për në Kongresin Mysliman. Prefektura e Dibrës urdhërohet: "Si delegatë për në mbledhjen muhamedane, që do të bëhet këtu, zgjidhni zotërijtë Vehbi, Myfti i Përgjithshëm dhe Salih Vuçiternin".[20]

Po atë ditë Prefektura e Kosovës porositet: "Si delegat për në mbledhjen e përgjithshme muhamedane, që do të mbahet këtu, zgjidhni Qamil Balën, Halim Gostivarin dhe Osman Nikolicin".[21] Kjo është praktika e zgjedhjes së

fleta 1.
15. AQSH. Fondi 152, viti 1923, dosja 291.
16. AQSH. Fondi 125, viti 1923, dosja 125.
17. AQSH. Fondi 152, viti 1923, dosja 31.
18. Po aty, dosja 31.
19. AQSH. Fondi 482, viti 1923, dosja 4, fleta 10.
20. AQSH. Fondi 152, viti 1923, dosja 31.
21. Po aty.

delegatëve për këtë Kongres, pra me që supozohej se kryetari i bashkisë është zgjedhur nga populli edhe delegatët mund të zgjidheshin nga kryetari i Bashkisë. Në ato vende ku nuk ekzistonte ky institucion, zgjidheshin nga mbledhja e kryepleqve. Më në fund, mbasi listat ishin grumbulluar në Gjyqin e Naltë të Sheriatit, ky ia përcjell Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke i bërë edhe konfirmimin zyrtar, se cilët ishin zgjedhur: Xhemal Naipi – Pukë; Qerim Buzmadhi – Mallakastër; Sheh Xhemali – Lumë; Rasim Sulejmani – Has; Salim Luniku – Gramsh; Hafiz Musa Haxhi Aliu – Librazhd; Ali Koka – Kurvelesh. Këta janë zgjedhur në ato vende ku nuk ka bashki. Ndërsa delegatët e zgjedhur në vendet ku kishte bashki kanë qenë: Veli Kallapodhi – Delvinë; Abdurrahim Tepelena – Tepelenë; Reshat Kokalari – Gjirokatër; Salih Hamza – Përmet; Shaqir Hoxha – Korçë; Ali Galipi – Libohovë; Qerim Fuga – Berat; Abdurrahman Fehmiu – Fier; Sheh Ibrahim Karbunara – Lushnje; Muharrem Mullaj – Elbasan; Haxhi Jusuf – Kavajë; Hafiz Ali – Durrës; Ahmet Rustemi – Shijak; Banush Hamdiu[22] – Pogradec; Ibrahim Xhindi[23] – Vlorë; Halit Rroji[24] – Shkodër; Halim Gostivari[25] – Kolonjë; Ihsan Leskoviku – Leskovik; Mehmet Pengili[26] – Krujë; Qamil Bala[27] – Kosovë; Vehbi Dibra – Dibër; Salih Vuçiterni[28] – Zerqan; Muhtesin Këlliçi – Tiranë; Dervish Aliu – Skrapar; Major Emini – Bilisht.

I dërgohet Ministrisë së Punëve Brendshme lista e delegatëve të Kongresit për t'u paguar udhëtimi dhe kthimi, sipas dëftesave, si dhe dijetat nga 20 shkurti deri me 13 mars nga 10 fr. ari në ditë. Delegatëve që banojnë në Tiranë si dhe delegatëve që janë deputetë, nuk do t'u paguhet gjë.[29] Ministria e Punëve të Brendshme njofton telegrafisht zyrat e veta vartëse se "shpenzimet që do të bëhen prej delegatëve, që kanë me marrë pjesë në mbledhjen e përgjithshme të myslimanizmës duhet të paguhen prej bashkive të vendit, siç u paguan edhe delegatët e popullit ortodoks".[30]

Gjyqi i Naltë i Sheriatit njofton Dervish Himën, kryetar i shoqatës "Djelmënia Dibrane", se vendi i mbledhjes do të jetë ndërtesa e klubit në fjalë, e cila ndodhej në rrugën e Dibrës, prandaj lutet që "të merren masat e duhura për këtë rast-ndërtesa të stoliset e të rregullohet sikurse duhet, duke u shënuar posaçërisht vendi nga ku do të flasin delegatët,

22. Deputet i Pogradecit.
23. Deputet i Vlorës.
24. Deputet i Shkodrës.
25. Deputet i Kolonjës.
26. Deputet i Krujës.
27. Deputet i Kosovës.
28. Deputet i Zerqanit.
29. AQSH. Fondi 482, viti 1923, dosja 4, fleta 15.
30. Po aty, fleta 8.

vendet e dëgjuesve, të sekretarisë, të gazetarëve, që mund të jenë të pranishëm, si dhe të përfaqësuesit të Qeverisë. Mbledhja do të kryesohet nga Dervish Hima dhe do të vazhdojë sa ta lypë nevoja"[31].

Myftiu i Përgjithshëm njofton delegatët, që me datë 21.II.1923 do të bëhet një mbledhje private në ndërtesën "Djelmënia shqiptare" për Kongresin, firmosin marrjen e njoftimit 19 delegatë.[32]

Nga ana e Qeverisë, Ministri i Punëve të Brendshme, Ahmet Zogu, me datë 24. II.1923 cakton të deleguar z. Qerim Çelo, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme[33].

31. AQSH. Fondi 482, viti 1923, dosja 4, fleta 11.

32. Po aty, dosja 4.

33. Po aty, dosja 4, fleta 41.

Parathanë e qellim

Abstrakt

Xhemaati-Islamije'ja qi qe formuem pêr të parën herë në vendin t'onë, po nisë ç'më këtë muej botimin e të së Përkohëshmes së vet, botim, të cilin i a pat vuem vehtes me barrë qysh me çpallje të Statutit.

Na të Përkohshmes, pra, do t'a kemi për qëllim me u munduem me i a ndalun hovin këtij shkatrrimi e kësaj dekadance qi shihet n'elementin Mysliman shqiptar, tue i dhanun këtîj shkas për herë ma të kërthnesët kah përparimi e qytetnimi kohotár.

Gjithësejcili mysliman, nuk kemi dyshim, ka per të na përkrahë me mjete landore e morale, në këtë udhë të vështirë qi po fillojmë me ndjekun. Gjithsejcili Xhemaat shpresojmë se ka për t'u gëzue për këtë hap t'onin qi po hjedhim e kështu ka për të na e dhanë dorën me i dalun në krye kësaj udhe, qi ka per qellim me e naltsue myslimanizmin në atë kulm lumnije, qi pat qenun dikúr, për të cilen madhshtore na flet historija...

Xhemaati-Islamije'ja qi qe formuem pêr të parën herë në vendin t'onë, po nisë ç'më këtë muej botimin e të së Përkohëshmes së vet, botim, të cilin i a pat vuem vehtes me barrë qysh me çpallje të Statutit. Elementi mysliman shqiptár, mbetun deri më sot i ndamun e i pá bashkumun në mes të tij, ndjeu nevojën, t'a shkundi prej vehtës atë plozhtí qi kish randuem mbi tê edhe kështu, si elementat tjerë, bani organizatën themelore e shoqnore të veten.

Asht për t'u vajtue për të vërtetë gjendja e sotshme, në ç'do pikpamje, e komunitetit muhamedan në Shqipní. Por kjo gjendje e mjerueshme, per veç qi nuk do t'a dëshprojë fare myslimanizmin, për kundra do t'i japë atij vullnet e guzim për m'e shpëtuem vehten prej mjerimi, në të cilin ká rá,tue këndellë në shpirtë të tij nji dishirë përparimit e qytetnimit.

Na të Përkohshmes, pra, do t'a kemi për qëllim me u munduem me i a ndalun hovin këtij shkatrrimi e kësaj dekadance qi shihet n'elementin

Mysliman shqiptar, tue i dhanun këtîj shkas për herë ma të kërthnesët kah përparimi e qytetnimi kohotár.

Barra qi i kemi ngarkuem vehtes âsht përnjmend e randë. Duhet vullndet, energji, guzim e flije për me i a arrijtun qellimit të shejtnueshëm.

Mas luftës balkanike, nepër ndrrime e shndrrime qi u shkaktuene, elementit Mysliman shqiptár i tokoj me pësue mâ tepër e me rá në deshprim të njaj njeriu qi s'i mbeten ma shpresë shpëtimi. Por Zoti i math çoj në vend premtimin e madhnueshëm të vetin: Mbrojtësi i fesë së vërtetë, i asaj feje qi dishmon njinjín t Ême, do të Jemi Un.

Na, nuk do t'i dalim para popullit Mysliman shqiptár me nji program të hijeshuem me fjalë të bukra qi s'munden m'u realizuem. Qe pikat kryesore të programit t'onë:

1) M'e bashkuem në nji trup të fortë e të qindrueshëm popullin Mysliman shqiptár.

2) Me përmirsuem gjendjen e vakufevet, të Xhamijavet, te Mesxhitevet, të Medresevet, të Teqevet e të tjera insitutevet Mysliman kësi sojit.

3) Me i a zbluem popullit Mysliman shqiptár të vërtetat e kesimit në nji mënyrë të thjeshtë e të pa nerlikueme, tue i a ngrohun këtij zemren në dashtni për keto të vërteta.

4) Si mbas statutit me plotsue vllaznin ndermjet të gjith elementeve në Shqipëni.

5) Me këto mjete mandej me forcuem edhe themelet e nji politikës së shëndoshtë e fjesht kombëtare në Shtetin t'onë.

Gjithësejcili mysliman, nuk kemi dyshim, ka per të na përkrahë me mjete landore e morale, në këtë udhë të vështirë qi po fillojmë me ndjekun. Gjithsejcili Xhemaat shpresojmë se ka për t'u gëzue për këtë hap t'onin qi po hjedhim e kështu ka për të na e dhanë dorën me i dalun në krye kësaj udhe, qi ka per qellim me e naltsue myslimanizmin në atë kulm lumnije, qi pat qenun dikúr, për të cilen madhshtore na flet historija...

Ndihma qoftë prej Zotit.

DREJTIMI
Hytbeja e parë

(H.Vehbi Dibra)

Ora 12. Perpara oborrit të Xhamisë së vjetër shihesh nji livizje. N'atë kohë ushtoi prej Minares thirrja (Es-salati); e Myslimanët vrapojshin, nji pregatitje nji trazim, kjo kje e para Xhuma e Shema-ati Islamijes, këjo faltore, këjo mbështetje e besimtarve e të njatyne qi sigurojn jetën e tyne me djesë të ballit po hapte nji fletë të réë të fatit. Sot popullt me hapat ma të shpejtë e të besueshmë fugojte për anë t'asaje faltorje të mallngjushme.

Këshilli i Naltë; Këshilli Ministruer, shumë deputetën dhe vllazën Krishtenë trumë trumë, të përziem në mest të popullit e tue u mbështet në muerna e ndër parmaklleket e faltores zejshin vendet e tyne të caktueme. Zani i thirjes (ezan) plot shpresë shpëtimit e dishirë[1] mbushi faltoren. Nuk kaluen 10 minuta me thirrjen (ezani) e dytë zuen të drejtohen korrizet e perkulme. Myftiu i përgjithshëm me hapat e randa plot perunjtësi njitet në minder e po hudhte hapat e rriformímit, tue këndue duanat.

Sejcilli priste Zanin qi do të dilte prej kësajë ngjitnje të kadalshme; Hytbeja zakonisht filloj arabisht; por aj besim' i rreformavet qi gjindej nër zembra i kishte dhanë nji tingllim kësajë Hytbe. Mbas kësajë ndryshoj zani i Myftiut e gjuha amtare me gjith forcën e sajë filloj të përndaj shpresë prej minberit; populli përpara kësaj lirije qi e ka marrë prej vetsundimit të tij e të Qeverisë së vet me nji za të përbashkët e shpirtnuer ju falën Perëndiës. Myftiu i përgjithshëm ja filloj: Vllazën Mysliman Shqiptarë e zotni të ndershem: sod si përfaqsues i përgjithshëm (Mymes-sili sheri) i popullit Mysliman Shqiptarë due t'u ap do këshillat, do këshilla shpirtnore d. m. th. fetare (dini) qi këto këshilla ndahen ne 3 pjesë. 1. Vllazën ç'

1. përmirësimi të gjendjes.

esht (hiqmeti) qëllimi i ardhjes s'onë në këtë jetë asht vllazën me ditë Perëndiën e me zbatue urdhnat e Tij d. m. th. me veprue mbas urdhnit të Tij.

Vllazën ç' do Mysliman e ka për detyrë me u mundue me u naltsue sikurse urdhnon në Kur-an (vema halaktul-inse .....) unë me madhninë t' eme ndjerzimin, binsexhin, i kam krijue vetëm me më njoft mue e me zbatue urdhnat e mija.

Vllaznë këto urdhna të nalta ndahen në dy pika: Pika e parë janë urdhnat qi i përkasin ksajë jete; prej këtyne ma e para asht dashtunija e atdheut; qi me atdhen zbatohen të gjitha urdhnat, prandaj këjo dashtunie asht dega ma e nalt e besimit sikurse urdhno i zoti i dinit (Hub-bulvatani minel-imani) d. m. th. Dashtunija e atdheut asht dega e shenjt e besimit.

Mbassandaj vllazën asht ditunija qi me ditunie mrijhen shkallët ma të nalta të dy vjetve.

Mbassandaj asht sidomos për popullin t'onë bujqësija, e cila ka nji ditunie të posçme qi lypset të përfitohet prej saj e të përparohet ajo. Mbassandaj asht tregëtija e cilla siguron jetën e ndjerzisë e lulzon shtetin etj etj.

Mbassandaj këto qëllime të nalta sigurohen me goditje rrugash qi i zoti i dini na kështillon me këtë fjalë (Elimanu bidun vesebune) d. m. th. besimi asht 70 e ca sektione e para asht besimi i njinjis (tevhide) e mbramja asht t' i heqish të këqijat nga rrugat. Nji mysliman për nji vlla të vetin Mysliman asht si njana gjymtyre; t' i vinë nji dam nji gjymtyrës damtohen të gjitha gjymtyrët të tjera e me këto vllazën kuptonet çiltas se Myslimanët janë nji vllaznije të plotë e të pa daeme e kurdoherë këtë duhet me e naltsue e prandaj Xhama-ati Islamija u formue për me e plotsue këtë vllaznie, e cila asht nji vllazni fetare.

Kemi vllazën edhe nji vllazni kombtare të gjithë elementevet qi gjinden n' atdhenë të dashtun t' onën qi këjo vllazni jo se asht vetëm me fjalë, po i madhi zot në "Kur-ani Qerim" këtë vllazni e vërteton e thotë: (Nëllas' i tyne nuk u thotë) qi këto profet të naltë jo se ishin në kombin e vet me nji fé, po ishin vllazën atdheje, me gjith këtë Perëndija na tha vllazën d. m. th. këjo vllazni asht nji vllazni atdhetare e kështu edhe ne si tham sipri këtë vllazni lypset t' a forcojm e t' a sigurojm. Shkurtimi i fjalës vllazën këto të sipërthanme të kësajë jete e porosin si të mbahet e atdheja të sigurohet, atëhere edhe ata urdhnat shpirtnore t' asajë jete mund të zbatohen sikur lypse. P. SH. vllazën ju tham si nji Dibran e se para sundimeve të hueja në Dibër ata urdhna qi zbatoheshin sod me sudim të huej për fat të keq kanë s' mund u zbatojshin ata mbet shumë mbrapa.

Pra kështu me zbatimin e urdhnave të sipërpërmendun të kësajë jete edhe me këto vllaznina të plota mund të sigurohet atdheu i dashur dhe kështu do të jenë zbatuar edhe urdhnat shpirtnore t' asajë jete edhe me e madhja robnie qi i duhët bamun Zotit do të jetë këjo.[2]

2. *Marrë nga revista "Zani i Naltë"*, nr. 1, viti I, tetor 1923, f. 3-6 dhe 10-13.

Abstracts of "Zani i Naltë" 22

Studies

1. Body's attire – Soul's attire
Fatos Kopliku – Washington D.C.

Abstract

It is difficult to imagine people and angels in paradise dressed with jeans or with suit and tie; there is something amiss, something not right between such clothes and paradise. On the other hand, it is quite natural when they are shown wearing traditional clothes, regardless of the civilization or race. In the Persian, Ottoman, or Indian miniatures of the Night's Journey of the Prophet Muhammad, the prophets and the angels that he meets are all shown wearing traditional clothes, of course, quite diverse thanks to the genius of the artists and their ethnic origins, yet very much at home in the celestial spheres where they are depicted. Also, the Byzantine mosaics or paintings masterly illustrate scenes with Christ, the Virgin, or the prophets of the Old Testament, yet very naturally at home and not out of place with the theme and the background bet it on earth or heaven. Similar examples of traditional dress in congruence with the paradise, saints, or prophets, can be provided from Buddhism or Hinduism, or from religions that are no longer operative like those of the civilizations of Ancient Egypt, Mesopotamia, or Persia, but notably none from the modern dress. In this article we argue that the reasons behind this harmony are closely related to the role of man, how he sees himself, and how he dresses accordingly.

2. The scientific truth over the Islamophobic "truth"
Prof. dr. Fadil Maloku, Sociologist

Abstract

Lack of information or knowledge about each other that exists in today's religious communities is not an advantage, rather, it is a barrier which has produced, is producing and will produce in the future negative consequences both in human lives and material goods, and also a frustration at continental and global range. This is undoubtedly producing the other current phenomenon, of global dimension, known and identified as terrorism. "Terrorism has neither nation nor state or… religion! The world we are living in is regarded as a world of high level danger (Risikogesellschaft)!" (Ulrich Beck, Risk Society).

3. Ilo Mitko Qafëzezi and the First Partial Translation of the Qur'an in Albanian Language

Azmir Jusufi (PHDc) – Prizren

Abstract

The Qur'an is a fundamental basis of Islamic religion, culture and civilization, and as such, it is a fundamental factor that unites the Islamic world in all areas of life, so it is no coincidence that people from many nations were interested in translating it into their languages.

The Qur'an has so far been translated into over 100 different languages, and besides the Bible, the Qur'an is the most widely translated book in the world.

While in other European nations, the Qur'an was translated by Christians, most of whom were orientalists specialized in Oriental language and culture in general and the Arab one in particular, and furthermore, their translation of the Qur'an was undertaken for missionaries purposes and anti-Islamic agenda, Ilo Mitko Qafezezi translated the Qur'an only for offering it to his blood brothers, who belonged to the Islamic faith.

Keywords: *Quran Kerim, Translation of the Qur'an, First Partial Translation of the Qur'an in Albanian, Ilo M. Qafëzezi, Miqo Lubibratiq.*

Education

4. The importance of religious education

Dr. Adil Kutlu
Department of Islamic Sciences, Bedër University

Abstract

Education is an organization founded by humans in order to meet the needs of today and the future and it is also created to complement the development of society in addition to its continuity. Thus, religion also possesses a space of culture and knowledge that affects every person, regardless if he/she is a believer or not. Religion and education, which unite in the point of human education and formation in accordance with specific objectives, have many common aspects and it is impossible to think of religious education outside the framework of general education. In fact, even the actual discussions are not about whether religious education should be part of general education or not, but focus on "how much" and "how" to realize such a process.

Submission of this issue by addressing the subject in different dimensions such as the need for this space, its importance, theme and purpose, will be useful in respect to the religious education.

Sociology

5. The importance of interfaith dialogue for the interethnic relations in Macedonian society

Msc. Sadije Gafuri, Tetovo, Macedonia

Abstract

Nowadays, we are facing with many problems which threaten the balance of the society. Many issues such as science, trade and human have become global. Therefore dialogue today is really indispensable.

One of the reasons of this situation comes because of the fact that people are not aware enough about their values especially religious values that is "Man is fearful of what he knows not". Particularly, we have neglected many of these vital values such as: tolerance, mutual understanding, cooperative relations, interfaith and intercultural dialogue, which are very crucial to attain a remaining coexistence in society.

Therefore, in the first chapter we will make an attempt to explain the theological basis of tolerance and interfaith dialogue in Islam based on the religious scriptures. We also will try to explain the speculations about interfaith dialogue. In the second chapter we will analyze the coexistence in Macedonia and how did this process arise.

Lastly, we will try to mention the fact that despite the location of them coexistence is a characteristic of all the Albanians including here the diaspora as well and especially the Albanians of Macedonia. In addition to this fact there will be the result of a questionnaire which was applied to 350 people from Macedonia.

Keywords: *Society, dialogue, coexistence, interfaith dialogue, harmony.*

Philosophy

6. The philosophical views of Vexhi Demiraj (Philosophy of Religion and Islamic Philosophy)

Msc. Ana Gjeci, Switzerland

Abstract

The research topic that is being developed speaks for the professor of theology and philosophy Vexhi Demiraj, his life, work and philosophical views. Since he has written extensively about philosophy, i decided to go further in his views on the philosophy of religion and Islam, given that these two philosophies are not very lively in Albania.

Personality

7. In the eve of two anniversaries 160th anniversary of birth and 100th anniversary of passing away (1847-1917) Hoxha Voka of Tetova - theologian, teacher, pedagogue, thinker and a prominent Albanian patriot by Prof. Dr. Musa Kraja

Abstract

We can mention here early imams, sheikhs, Jesuit priests, Catholic friars or other Orthodox priests who have made their name, have honored the people of their countries (without mentioning names), who have been among the most well-known figures in the field of education, including philosophy and other sciences, that were separated from it in certain stages of their development.

In the interpretations of Albanian Islamic education, there have been different opinions, created in various places and areas of Albanian territories, where there also had been detected anti-scientific attitudes. This because some pleiads of theologists within Albanian territories, who have served in different parts of the country and beyond - though they have worked with great spiritual devotion, due to their powerful patriotic feelings and religious beliefs - they have been regarded on this sacrifice and this great patriotic patronage. This ban was carried out through indifferent attitudes in most cases, as if they did not live and work for the Nation or, including them in the list of foreign non-Albanian contingents, while living in Albania, and even more harshly, considering them as anti-Albanian.

Retrospective

8. 95 years since the First Albanian Muslim Congress (February 24-March 12, 1923) Ali M. Basha

Abstract

The First Muslim Congress represents a very important event not only for the religious and social life of Albania, but also for the national political life of our entire nation. And yet, this Congress has been left in oblivion. Such kind of non-appreciation is explained only through the known attitude of the monist state towards all religions and their organisms.

Prejudices against the Albanian Islamic community, considered to be backwarded, and even towards the Islamic faith, merely regarded as a legacy of Ottoman-centuries-old rulership, hampered the appreciation of the historic significance of the 1923 Muslim

Albanian Congress. These considerations did not allow people to pay due attention to the documents approved by it, known so far. Even a quick glimpse of them lets one see the profoundly national and progressive character of the decisions taken at this congress.

The First Muslim Albanian Congress represents a religious organization on the national basis of the predominant majority of the Albanian population. It is worth to note and be aware that such an organization is the first in the whole Islamic world. Because of the events that followed, (more precisely, after the victory of the Turkish National Revolution), it also represents a unique case throughout the history of Islam in modern times.

9. Foreword and Purpose – The First Hutba
Direction - General Mufti

Abstract

Islamiyya Jamaaat that we are founding for the first time in our country is starting from this month to publish an edition of its periodical magazine, a publication which we have pledged to do since the promulgation of the Statute.

We, authors of this periodical, will have as objective to stop the impetus to this destruction and decadence that is being observed into the Albanian Muslim people, leading it towards the modern advancement and civilization.

No doubt, every Muslim will help us both materially and spiritually in this difficult path we are starting to follow. We hope every jamaaat will joy with this step and will give us a hand to successfully complete this task, which has as objective to exalt Islam and to elevate it to the once peak of glory for whose majesty the history witnesses.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë "Hyrja", ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me "Bold" dhe shkrim "Italik", "Times New Roman 12" dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim "Times New Roman 10" dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë "Times New Roman" me "Spacio 1". Të mos mungojnë shkronjat "ç" dhe "ë". I gjithë teksti të jetë "Justified".